Adnan Abrashi

(R o m a n)

NË VORBULLAT E JETËS

Ose

(Kursi shpirtëror i filozofisë praktike nga mixha Dilë)

(Pjesa e I)

P r i z r e n

2003

BOTON: Shoqata e përpjekjeve për krijimin e njeriut të ri "VEGIMI MISTIK" – P r i z r e n
Rr. Anton Çeta 11 Prizren, tel. 044/200-890
E-mail:vegimimistik2000@yahoo.com

PËR BOTUESIN
Mr. Mehmet Sopaj

LEKTOR/KORREKTOR
Hasan Hamëzbalaj, prof

REALIZIMI KOMPJUTERIK
Artan Abrashi

KOPERTINA
Besnik Haskuka

SHTYPI:
Shtypshkronja "BAF: Prizren

TIRAZHI
1000 copë

PARATHËNIE BOTIMIT TË PARË

Librin **“ASHTU MËSONTE MIXHA DILË”** pata fatin që ta lexoj pa dyshim ndër të parët, si të thuash, në procesin e krijimit, meqë libri mu ofrua që ta rregulloja gjuhësisht para se të botohej. Dhe, të them të drejtën, materia që shtjellohet me pasion nga autori, shkakton gjithsesi një trandje intelektuale dhe nuk lë vend për indiference profesionale.

Njeriu i ndodhur në shtjellën e absurditetit agonik, të cilën e kanë krijuar, pa vullnetin e tij, rrethanat politiko-shoqërore, i cili është shtruar pijes dhe rebelimit intelektual, i pakënaqur dot me realitetin shoqëror, pa jetesë të vërtetë, takohet papritmas me plakun e urtë dhe të mbushur me dritë hyjnore, mixhën Dilë, i cili rrezaton me dashurinë e tij të madhe e të cilën e përmbushin urtësia dhe mëshira…

Ky do të ishte në vija të trasha syzheu i librit në fjalë. Por, pikërisht tani fillon përimtimi deri në skajshmëri i, si të thuash, farës së të vërtetës… Në dialogët interesante në mes të riut kurioz dhe njeriut që ka të akumuluar në vete një dituri të thellë filozofike dhe një përvojë të lartë bulojnë lulet aromëdehëse të urtësisë që adhuruesin e abstraksioneve intelektuale nuk e lënë dot indiferent. Libri mund të thuhet është një përpjekje e suksesshme e shpjegimit të abstraksioneve më të thella, më të ndërlikuara, thënë kushtimisht: është libër përshkrimi i asaj që vështirë shpjegohet:

i ligjshmërive të veprimit të materies dhe ener-gjisë, të shpirtit dhe trupit - libër i shpjegimit të ligjshmërive të jetës.

Mendimi, thonë, është çelësi me të cilin hapim dhe mbyllim dyert e jetës. Libri në fjalë është i përmbushur mendim ... Edhe pse, në ndonjë rast, lexuesit mund t'i ndodhë të ndjehet siç thotë Ajnshtajni: " sa më tepër dimë, gjithnjë e më pak kuptojmë" dhe kjo do të bëj ndoshta, në ndonjë rast, materien paksa të rëndë…megjithatë, sido që të hyjë njeriu në botën e këtij libri, gjithsesi do të dal më i begatur… Edhe pse njerëzit mund të jenë të pirur që gjërat t'i shohim ashtu siç dëshirojmë të jenë, e jo siç janë dhe të vërtetën ta shikojmë përmes syzave të dogmatizmit… Nuk thuhet kot se askush nuk është më i shurdhër sesa ai që nuk dëshiron të dëgjojë e më i verbër sesa ai që nuk dëshiron të shohë… megjithatë, është e drejtë e secilit të zgjedh rrugën për të cikën ai mendon se është e mire…

Romani si një lule e sapomugulluar përgatitet të shpaloset e të hapet para botës së lexuesve.

I urojmë jetë të gjatë letrare.

Shtator, 2003
Hasan HAMËZBALAJ

LETËR LEXUESVE TË MI

Të nderuar lexues,

Si djalë i vetëm, siç thuhet "hasreti" në familjen time, gjithnjë kam qenë i edukuar me mësimet e traditës patrijalkale. Babai, e posaçërisht nëna, përherë më kanë bombarduar me mësimet religjioze, duke ma imponuar bindjen, se njeriu është krijesë më madhështore e Perëndisë, i ndërtuar nga dheu si trup që vdes, dhe shpirti i pavdekshëm hyjnor. Gjer në kohën e pubertetit, posaçërisht të adoleshencës së vonshme, mësimet fetare nga prindërit e mi i pranoja ashtu sikurse ishin: shabllone standarde të prezantimit, të shprehura me nivelin e tyre të kuptuarit të gjërave. Nga tëra këto, kureshtjen time të njomë atëbotë më së tepërmi e sfidonte etika fetare, posaçërisht, ajo e parimeve të drejtësisë hyjnore, që në të ardhmen, gjatë formimit tim si personalitet i kompletuar, do të jenë bazë e pikënisjes për kërkimet dhe shtegtimet e mia në këtë rrugë të pakthyeshme të anës tjetër të krijesës sonë - SHPIRTIT.

Në tërësinë e qenies sime, përherë ndjeja bindjen se mësimet religjioze ishin të drejta dhe ne të fshihej urtësia e madhe intelektuale, por kurrsesi nuk mund të pajtohesha me mënyrën e sqarimit dhe të zbatimit të tyre praktik, veçanërisht për nivelet edhe më të larta të vetëdijesimit tonë shoqëror.

U sfidova nga ky realitet. Fillova të kërkoj më tej ... më tej, e më tej, duke gjurmuar varësisht nga mundësitë reale të qasjes në literaturën përkatëse, dhe aq sa më lejonte niveli modest i aftësive intelektuale. Në këtë rrugë që ishte e gjatë, shumë më vonë vërejta se, pikërisht në njohuritë e stërgjyshërve tanë të lashtë, fshihej visari më i çmueshëm i urtësisë së vërtetë, të cilën unë pandërprerë e kërkoja diku, dhe të jem i sinqertë, duke mos ditur as vetë tërësisht se çfarë në realitet kërkoja.

Në këtë rrugë të pakthyeshme, kam hasur në mjaft libra, literaturë të ndryshme, siç i quanin alternative, njerëz, bashkudhëtarë të shumtë kurioz si unë... Bredha gjatë i humbur tërësisht në jetë, përplot trauma dhe dëshpërime të njëpasnjëshme... por, sfida e përhershme dhe këmbëngulësia në gjetjen e përjetimit të ndjenjës adekuate se "mu kjo është ajo se çka unë kërkoj", nuk më është zhdukur kurrë. Nuk nguroj aspak të pranoj se tek pas dyzet viteve e zbulova formulën e parë të urtësisë që m'i hapte shtigjet e arritjes deri te caku i pagabueshëm që do të më shpjerë kah lumturia në jetë.

Brohorita "E U R E K A "!

Formula ishte e thjeshtë, por gjeniale :

"ZOTI EKZISTON DHE ËSHTË NË MUA. AI NUK ËSHTË SHUMË LARG DIKU NE QIELL, KU UNË ISHA MËSUAR GJITHMONË TA KËRKOJ"

Dhe vërtet! Zoti ishte në mua. Ishte fshehur në zemrën time dhe priste që unë vetëm t'i drejtohesha!

Fillova t'i lutem atij! Nga ai të kërkoj zgjidhje.

Dhe, ja, mrekullia!

Zoti në mua i pranoi lutjet e mia dhe m'i hapi shtigjet e reja të njohjes së vërtetë të qenies sime të përsosur.

Kush isha unë në të vërtetë?

Më në fund zbulova se unë isha një krijesë hyjnore. Realiteti i kësaj bote, shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë që ndizet pandërprerë dhe quhet jetë….

Autori

* * *

Një tufë rrezesh dielli, që kishin depërtuar përmes dritares në dhomën time, më zgjuan befas. Isha ende i përgjumur. Shikova orën në mur. Nëntë e tridhjetë minuta.

“Obobo, sigurisht jam vonuar për punë! Më paska dështuar alarmi në telefonin tim celular… Përsëri ajo bateri e cila qe amortizuar kaherë dhe nuk e mbante dot mbushjen gjatë”. - Brohorita i dëshpëruar me gjysmëzëri dhe qortova veten pse nuk e kisha ndërruar gjer më tani këtë mbushëse të mallkuar”

Me të shpejtë brofa nga shtrati dhe u drejtova kah banjoja, që gjendet pranë dhomës sime. Në korridor e takova nënën. Sapo e pashë, për një çast u drodha. Ajo zakonisht zgjohej herët dhe, pas “namazit të sabahut”, nuk flinte më.

Kishte vërejtur se nxitoja:

- “Dritën e ke pasë të ndezur mbrëmë deri vonë. Ma ka marrë mendja se ishe tuj lexue. Pse je zgju kaq herët? Asht ditë e shtunë. Nuk ke me shkue në punë. Kishte me t’ba mirë barem sot një pushim më i gjatë”.

U ndala në vend dhe fillova të buzëqesh me këtë veprim senil timin. Kisha harruar fare se është e shtunë - ditë vikendi. Në një gjendje të habisë dhe gëzimit, që më kapluan furishëm si ndjenja, shikimin e drejtova kah nëna. Ajo nuk e kishte ndjerë lajthimin, ndaj nuk i fola asgjë. Vetëm e përqafova si zakonisht, por këtë herë jo nga shprehia, veçse si shpërblim për lajmin e dhënë. Që ta kamufloja situatën, pa pasur etje fare, piva një gotë ujë në

banjo. Hyra në dhomë dhe sërish u futa në shtratin e fjetjes. Tentova të flejë, por nuk më zinte më gjumë. Ashtu kot rrotullova shikimin rreth e përqark dhomës. I kapluar nga kotësia, pa dashje zgjata dorën në komoden afër shtratit dhe mora librin të cilin mbrëmë e kisha lexuar me pasion deri para agut të mëngjesit. Ishte ende i hapur. Shikova faqet e mbetura të librit. Deri në përfundim më kishin mbetur përafërsisht dyzet faqe .

"Hëm… libër vërtetë interesant!… Ama … tani nuk jam disponuar të vazhdoja më së lexuari. Do ta përfundoj sonte në mbrëmje", – mendova. Faqen, ku kisha mbërritur, e shënjova dhe, duke e mbyllur, e vura sërish mbi komode. Shikimi m'u përqendrua tek notesi i shënimeve ditore. Ishte fletorja e DITARIT TIM PERSONAL. E hapa dhe me vëmendje fillova t'i shfletoj faqet e shkruara kronologjikisht sipas datave. I asociacionuar nga përmbajtja, vëmendjen e përqëndrova në idenë që më lindi aty për aty: " Do të ishte mirë që këto shënime nga ditari t'i përpiloja si një roman?!"

Nga ky synim, që më erdhi papritur, ndjeva një disponim. Shpejt u përmbajta, duke krijuar në vete gjendjen e një qetësie të plotë mentale. Kësisoji, në këtë gjendje, qëndrova rreth 10-15 minuta. Më pas, spontanisht, ktheva kokën kah tavolina ku ishte kompjuteri dhe ndjeva sikur edhe ai më foli: "Jam gati o mik, t'ia fillojmë…"

* * *

KAPITULLI I I

Nga shumë karakteristika, si risi, që kishte sjellë paslufta në Kosovë, ishte një dukuri mjaft e shprehur edhe në lagjen time. Kjo dukuri karakterizohej me ndryshimin e strukturës së banorëve, nga ajo që ishim mësuar ne para lufte. Shumica e fqinjëve joshqiptarë, sigurisht me ndërgjegje të papastër, por edhe nga frika për mëkatet e bëra, ishin largua nga qyteti ynë. Në vend të tyre, me të drejtë, nga fshatrat përreth, janë vendosur shumë familje shqiptare, viktima të pafajshme të një politike gjenocidale, të ekzekutuar ndoshta pikërisht edhe nga ata pronarë të dikurshëm të këtyre shtëpive të braktisura.

Vuajtja e tyre nuk ishte vetëm lufta, as egzodi dhe shkatërrimet e çdo gjëje të arritur gjatë punës së ndershme dhe të palodhshme shumëvjeçare në jetë, por mjaft nga ta, kishin humbur edhe më të dashurit. Për të qenë kjo dhembje edhe më tragjike, shumicës nuk i dihej as varri, mbi të cilin do të vinin së paku një lule nga pranvera e Kosovës që veç kishte lindur.

Kosova jonë e mjerë gëzonte, por edhe rënkonte. Lumturia e lirisë kaherë e pritur, sfidohej nga ndjenja e rëndë e zbrazëtisë shpirtërore për më të dashurit, që më nuk ishin në mesin e tyre, meqë ishin flijuar si risku më i shtrenjtë i kësaj lirie .

Fqinjët tanë të rinj, ishin individë dhe familje të thjeshta shqiptare. Çdo njëri prej tyre ruante një tregim më vete. Një pikë apo presje të kësaj histori nuk duhej zhvlerësuar, meqë ishte shkruar me gjak e lot, dhe kjo rridhte si vazhdimësi e pandërprerë për një shpresë - se e ardhmja e afërt do të jetë ndoshta më e mirë.

Nga banorët e vjetër, këta "ardhacakë" ishin pritur jo më së miri.

Jeta vazhdonte!

Pas një kohe të shkurtër, shumica prej nesh me këto familje vendosëm raporte shumë të afërta e miqësore. Ishte kjo një ndjenjë, si të thuash, e përqafimit vëllazëror e përzier edhe me dhembje.

Kurdoherë kur paraqitej nevoja, nuk kursehej asgjë. Ju dilej gjithnjë në ndihmë. Sado të mëdha që ishin hallet e tyre, ato ndaheshin edhe me kujdesin dhe ndjenjën e konsideratës sonë vëllazërore.

Për ta jeta, thjesht mund të definohej si përvuajtje dhe e kob. Fundja, ky ishte fati i Kosovës në përgjithësi. "Gajreti" dhe "durimi" ishin ndoshta fjalët më mrekulluese që mund t'u jepnin kuraje mbi qëndresën dhe shpresën për ngadhënjim.

Fqiu im i parë, nga Halimajt, kishte humbur tërë pasurinë, por mbahej krenar, dhe, siç thoshte plaku i tyre, mixha Dalip:

"- Shyqyr Zotit që jemi toptan! Malli vjen e shkon!"

Në anën tjetër, katër dyer mbi timen, ishte vendosur një grua e ve me katër fëmijë jetimë. Në mënyrën më barbare dhe në praninë e afërt të saj, serbët ia kishin masakruar burrin, vjehrrin dhe vjehrrën. Vetëm falë Zotit ajo kishte mbetur gjallë. Tregimi i saj, pa i përmbajtur kurrë lotët, ishte me të vërtetë rrëqethës.

Duke dëgjuar dhe përjetuar dhembjet e këtyre njerëzve, për një kohë sikur harrova ato të miat.

Jetën kaherë e kisha shndërruar në ferr dhe greminë së cilës nuk i vërehej askund fundi. Nga një djalosh i lumtur dhe me një edukate fisnike familjare, isha shndërruar në një degjenerik të paskrupull dhe neurotik kardinal.

Gjendja ime shpirtërore kishte arritur në udhëkryqin më kontraverz jetësor sfidues: *"Të jesh apo të mos jesh"*.

Në këtë situatë të pakapërcyeshme, që dita më ditë, thellë e më thellë, më zhyste në bindjen që sa vinte e forcohej : "Unë nuk jam askush", "jeta për mua nuk ka më vlerë"! Niveli i depresionit dhe shkalla e lartë e urrejtjes ndaj vetes, më kishin sjellë në atë paradoks ekzistencial, saqë mendja më shkonte edhe në atë më të keqen. Në atë, për të cilën përherë i kisha përqeshur të tjerët, e tani vetë dëshiroja të isha viktimë e saj.

Ndonjëherë, në disa momente të këtyre krizave të shpeshtuara, kisha ende ndonjë dromcë force që sadopak t'i thoja vetes: "JO! Nuk bën! "Sa e sa njerëz në këtë botë kanë probleme edhe më të mëdha dhe qëndrojnë të palëkundur në jetë." Kështu pëshpëritja në vete këtë bindje

optimiste dhe, si zakonisht, ajo nuk zgjaste shumë. Zbehej menjëherë me dështimin tim të parë, sado të vogël, në jetë.

Pastaj, si vazhdimësi, përsëri...!

Ah, kjo ndjenjë e padurueshme e vetëmarrisë! Kjo gjendje kronike depressive! Me të vërtetë nuk mund ta duroja më. Nuk mundesha dhe pikë!

Nuk kisha kurajë t'i kundërvihesha kësaj bindjeje. Edhe në qoftë se në mendimet e mia vinte ndonjë rreze e zbehtë optimiste, gjithnjë ngadhënjehej nga bindjet e rrënjosura: kudo në jetë vetëm dështime… dashuri të parealizuara… askund i pranuar… askush nuk më do…

Fatkeqësisht, të gjitha këto ishin të vërteta!

Në mua rrethi shihte vetëm një qyqar dhe marroq që me ndonjë kombinim të gabuar të rastësisë natyrore kisha lindur në këtë botë. Urrejtja permanente ndaj vetëqenies, vetmia dhe, në përgjithësi, kjo zbrazësi e papërshkruar e asgjësisë, ma sforconin gjithnjë e më shumë bindjen: "*Lamtumirë jetë gënjeshtare, lamtumirë vuajtje të mia…*"

Kështu çdo ditë në ankth dhe pritje të pandërprerë. Kështu, dalëngadalë dhe sigurt deri në çastin e afërt vendimtar, kur nga brendia e shpirtit tim, do të vjen urdhri i prerë: *"Tani është momenti, o Mik!"*

Në fillim, nga tundimi dhe kureshtja rinore, por viteve të fundit si shprehi e shpeshtuar në kërkim të kurajës për këtë gjendje, më kishte mbetur vetëm pasioni shfrenues dhe i pakontrolluar i hyrjes në botën satanike të"lartmadhërisë" së tij, a l k o o l i t. Vetëm si i dehur jeta kishte ngapak kuptim. Alkooli dhe pija, për mua ishin rruga

e vetme e njëfarë ikjeje nga realiteti i kësaj gjendjeje të pamposhtshme shpirtërore. Ajo më mbante në njëfarë ndjenje të arsyes euforike të lumturisë për vetë qëllimin e ekzistimit. Vetëm atëherë jetën e shihja ndryshe: më të mirë dhe më të bukur, edhe pse e dija se ky përjetim do të zgjaste shkurt, shumë shkurt, deri në esëlltin e mëngjesit të nesërm. E pastaj? Përsëri kënga e vjetër... e kështu me radhë.

Rrethi im, tek unë, kaherë kishte vërejtur këtë pasion, dhe nga "press qendra e thashethemeve" të qytetit, veç më kishte mbërritur haberi, se opinioni për mua fliste si për një "pijanec", "alkoolist", "degjenerik të shfrenuar"... e ku ta di si ndryshe. Në fillim, gjeja shokë të llojit të njëjtë, apo, si i thonë ndryshe, shokë të tavolinës, me të cilët së bashku i qanim hallet tona, por, më vonë, edhe këta u rralluan.

Shumë kafene që vizitoja, kaherë ishin mërzitur nga unë; ato filluan të mos më përfillnin dhe të largohen. Edhe ata me kohë vërenin se kishin të bënin me një alkoolist ordinar, i cili ishte shndërruar në inventarin më të pakëndshëm të lokalit të tyre. Me pretekste të ndryshme, disa here refuzonin të më jepnin pije, ndërsa më vonë, këto refuzime kulmuan gjer tek përzënia e drejtpërdrejtë nga kafenetë e tyre.

Të gjitha këto që ndodhnin me mua, unë, ose nuk i vëreja, ose nuk doja t'i vëreja fare. E vërteta ishte se isha bërë një alkoolist kronik, që tek disa, sadopak krijonte dhembshuri, kurse te shumica tjetër, urrejtje dhe përbuzje.

Në fillim, paratë më mjaftonin. Më vonë, fillova të pija me borxh dhe si përfundim ndodhi edhe shitja e sendeve të vlefshme personale, që i ruaja si kujtimet më të dashura. Për pak para, shita unazën e arit që ma kishte blerë nëna me rastin e kryerjes me sukses të gjimnazit. Shita orën, kujtimin më të dashur të trashëguar nga babai i ndjerë, biçikletën… etj.

Pas një kohe, nuk mbeti më asgjë për të shitur. Borxhlinjtë filluan të trokisnin në derë. Nuk dija kah t'ia mbaja. Si të dilja nga lëkura ime? Gjithmonë, sikurse ndodhë në jetë me një parazit, të tjerët ia kryejnë obligimet. Për mua, kush do të ishte tjetri, përpos nënës sime. Nëna e mjerë, me ato pak para që kishte kursye me kohë, siç thoshte, "për harxhet e dekës", i paguante borxhet e mia. Paguante e gjora nënë pa bërë zë, dhe, pastaj, fshehurazi shkonte në dhomën e vet, dhe qante me dënesë duke i fshehur gjithnjë lotët nga unë.

Çudi! Kurrë nuk qante afër meje. Pse ka vepruar kështu, shkakun e vërtetë unë do ta kuptoja shumë e shumë më vonë.

Përpos të gjitha peripecive, alkooli dhe pritja më kishin mbetur kurajë e vetme shpirtërore. E dija dhe isha i bindur se një ditë, patjetër, do të vinte edhe shkatërrimi im total fizik, sepse ai shpirtëror veç kishte ndodhur kaherë.

Dhe pritja! Pritja çastin më vendimtar, kur më në fund nga brendia e qenies sime do të vinte ai zë: *Tani është koha o MIK"!*

Në shtëpinë time jetoja vetëm me nënën plakë. Babai kaherë kishte vdekur. Thjesht, kur ai vdiq, unë isha tetëmuajsh dhe ai nuk më kujtohet fare. Nëna ishte e moshuar, por mbahej e fortë. Ajo, me një pension të babait, që pas lufte, nuk e realizonte as atë më, si dhe me disa punëdore që i bënte duke qëndisur dekorimet e nuseve në formë lulesh, mbante gjallë shtëpinë. Kështu pothuaj dhe më kishte rritur mua. Kamë dëgjuar nga të tjerët, se pas vdekjes së babait, ajo kishte pasur shumë oferta për martesë, por kategorikisht i kishte refuzuar ato.

-"Do ta rris djalin tim të vetëm dhe me të do të jem krenar" - thonë se e kishte pasur zakon të thoshte, kur kishte refuzuar ndonjë misit për martesë. Këtë informatë, kurrë nuk e kam marrë nga nëna vetë, sepse ajo ishte një grua krenare dhe e edukuar në mënyrë patriarkale. Besonte në Zot, dhe gjithmonë, edhe në momentet më të vështira të jetës, citonte lutjen nga KUR'AN-i : ***"Hajrihi ve shehrihi min Allahu tala"*** - (Hajri dhe sherri vijnë nga Zoti). Edhe pse thellësisht kam qenë i bindur se ajo vunte në shpirt, kurrë nuk e kishte zakon të ankohej, por në momentet më të vështira, gjithnjë gjente arsyen e saj të zakonshme:

"Kështu paska qenë kismeti"!

Nëna ime me të vërtetë ishte një krijesë hyjnore. Dashurinë e madhe dhe të sinqertë që kishte për mua gjatë tërë jetës së saj, unë e konsideroja vetëm si diçka të zakonshme. Si diçka normale me të cilën isha mësuar. Nuk e kuptoja unë atëbotë, se dashuria e saj ishte jo vetëm e zakonshme prindore, por edhe një vetëflijim. As për së

afërmi nuk e kuptoja se pikërisht durimi dhe vendosmëria e saj, përmes besimit të fortë, se “patjetër do të bëhet më mirë një ditë”, ishte vendimtare në evoluimin tim qenësor.

Nga e kishte marrë kjo grua këtë urtësi madhore? Nga e dinte ajo se besimi i fortë në çdo dëshirë, i sforcuar me lutje të pandërprera, do të realizohej me përpikëri një ditë. Ajo veç ishte lidhur me nivelet hyjnore, duke arritur aty ngadalë, por sigurt, përmes rrugës së trasuar të jetës, që e kishte ndërtuar nga edukata dhe besimi i saj Mysliman. Kohën e fundit, edhe kjo grua e madhërishme ishte shqetësuar me sjelljet e mia; posaçërisht me ardhjet e shpeshta i dehur, në orët e vona të mbrëmjes.

- Mos, biri i nënës! - më thoshte me zërin e saj të ëmbël dhe përplot dashuri. - Pse bën kështu me veten. Nëna të ka vetëm ty dhe kjo më mban në jetë. Nëse vazhdon kështu të dehesh, askush nuk do të të jep çikë. Mendon ti që nëna jote të vdes pa i pasur në gji nipat e saj?”

Jetë, o jetë!

Oh, Zot i pamëshirshëm!

Pse më krijove?!

Pse më bëre kështu të vuaj?!

Eeehhh… unë vuaj dhe, një ditë, me të vërtetë do ta ndërpres këtë vuajtje. Ah… jetë o jetë! Jetë gënjeshtare. Kur do të arrinte më në fund ai zë i brendshëm dhe kaherë i pritur: “*Tani është koha, o MIK “!* Fundja, pse e prisja këtë zë? Pse nuk ia shkurtoja vetes vuajtjet tani… tani dhe menjëherë… Jo, jo… nuk mundesha. Nuk dija pse, por nuk mundesha. Ende më mungonte forca dhe guximi i duhur!...

Banorët e lagjes sime, si ata të vjetër, po ashtu edhe miqtë tanë të rinj, kaherë kishin vërejtur vuajtjet dhe brengat e mia. Rregullisht më shihnin si çdo mbrëmje kthehesha vonë dhe i dehur në shtëpi. Disa prej tyre edhe i kisha takuar dhe biseduar gjatë me ta, pa ditur të nesërmen për këtë. Kurrë nuk më kanë folur asnjë fjalë në fytyrë, por gjithmonë e ndjeja se më përfolnin prapa shpine. Kjo shihej edhe në sytë e tyre gjatë përshëndetjes. Zakonisht, këtë konstatim mund ta bëja vetëm kur ndonjëherë i takoja esëll. Vëreja unë në sytë e tyre edhe njëfarë largimi dhe ikje, por edhe dhembshuri. Realisht, ata kishin të drejtë, edhe pse unë kot e brengosja veten për këtë distancim të rrethit.

Rruga e gabuar që unë kisha zgjedhur, ishte vetëm imja. Imja dhe e askujt tjetër. Çfarë mund të bënin ata? Asgjë! Mundeshin vetëm të më përqeshnin, ose, edhe më keq, të kishin dhembshuri. Vaj halli për mua pasi isha bërë që dikujt t'i dhimbsesha?

Historia e "vakive" të mia prej pijaneci ishte e gjatë. Gati e pamundur që të përmblidhej vetëm me një shkrim.

Një mëngjes u zgjova nga gjumi dhe vërejta se nuk isha në shtëpinë time, në dhomën dhe shtratin tim. Isha krejtësisht diku tjetër. I shtrirë në një dhomë të çuditshme, por disi e njohur për mua.

"Çka kërkoj unë këtu?" - qe pyetja që më së pari i bëra vetes posa i hapa sytë.

Dhoma ku isha i shtrirë qe e zbrazët dhe gjysmë e ndritur. Nga dritarja e vogël përdhese depërtonte një tufëz rrezesh të forta e drite, e cila më shkaktonte ndjenjën se

ishte vonë dhe unë kisha fjetur gjatë. Ktheva kokën dhe në dhomë nuk pashë askë. Isha plotësisht i vetëm dhe i shtrirë në shtrat. Nga shija e gojës dhe duhma që kundërmonte, menjëherë konkludova se mbrëmë kisha qenë shumë i dehur, por kurrsesi nuk më kujtohej si kisha mbërritur në këtë dhomë dhe në këtë shtrat. Filluan të më silleshin ndërmend mendimet nga më të ndryshmet:"Jam koritur!", "sigurisht kam bërë ndonjë të zezë!", "jam futur i dehur në dhomën e huaj!", "prite tani belanë"... etj.

U mundova që të ngrihesha ngadalë nga shtrati, por papritmas ndjeva dhembje të fortë dhe kam lëshuar një britmë të madhe. Shpalosa si mbulesë leckën e improvizuar nga vetja, dhe në atë moment përjetova lagështi në tërë trupin. Këmba e djathtë më ishte mbështjellë me fashë, ndërsa tërë teshat e trupit ishin të lagura dhe të ndyra nga balta. Kisha dhembje edhe në kokë. Preka fytyrën me dorë dhe vërejta se ishte e gërvishtur dhe e mbuluar me gjak.

"Vaj halli për mua!" Edhe pse e thashë në mendje, më doli nga goja me gjysmë zëri.

Nuk dija fare se çka kishte ndodhur me mua. Ankthi, përzier me brejtjen e ndërgjegjes dhe frikën, më shkaktonin presion të padurueshëm psikik. Edhe dhembjet e këmbës filluan të më bëheshin më të forta. Ktheva kujtesën deri në momentin kur ajo më shërbente, dhe erdha në përfundim se dje kisha pirë tërë ditën në një lokal të periferisë së qytetit. Nuk më kujtohej se isha rrahur me dikë. Po! Kisha qenë vetëm…

“Mos, vallë, kamerierja jevge…? Oh jo, jo… sigurisht!” - më sillej ndërmend edhe kjo mundësi gjatë rekapitullimit të ngjarjes. Ama… nuk më kujtohej kurrsesi, si isha kthyer në shtëpi, gjegjësisht pse isha këtu, dhe pse isha i lënduar dhe i përlloçur në tërë trupin.

“Ah, pije e mallkuar!” - brohorita me zë gjysmë të lartë, duke e mbuluar instinktivisht me duar fytyrën ende të fëlliqur nga balta. Me këtë gjest sikur doja ta mbuloja edhe korinë time, e cila më kishte ndodhur, dhe, tek tani e tutje do t’ia ndija krismën.

Duke u marrë në mendime me budallallëkun dhe pendimin tim, ngadalë u hap dera e dhomës dhe nga ajo u paraqit figura e njohur e fqinjit tonë - mixha Dilë.

Mixha Dilë ishte një fqinjë yni i ri, i cili, sikurse edhe shumë të tjerë, menjëherë pas lufte, qe vendosur në lagjen tonë. Vinte nga një fshat që më së shumti kishte pësuar nga shkatërrimet dhe masakrat barbare serbe. Si njëri ndër ardhacakët e shpërngulur ndër të parët në shtëpinë e vjetër të një serbi, ishte vendosur aty me pëlqimin dhe lejen e forcave paqeruajtëse të NATO-s. Jetonte vetëm dhe në heshtje të skajshme. Asnjeri prej nesh nuk dinte pothuaj asgjë me rëndësi për jetën e tij. Ishte një plak i pashëm, në moshë diku rreth gjashtëdhjetëvjeçare. Dukej se jetonte një jetë të qetë dhe të vetmuar. Pikërisht pse për të dihej pak, nga thashethemet e njerëzve tanë, thureshin shumë supozime për biografinë e tij, që nga ato se ai ishte me një prejardhje të dyshimtë, e gjer tek ato se ai ishte një hero dhe luftëtar i pashoq i radhëve të UÇK-së.

Kuptohet, përmbajtja e thashethemeve kishte natyrën e nivelit inteligjent të kuzhinës ku ato gatuheshin. Kishte mendime se ai ishte një njeri i marrë dhe natën komunikonte me “XHINA” duke bërë “sehire”. Pastaj, thuhej se ishte njeri i “knueshëm” dhe shkruante libra. Disa ia mveshnin titullin e hoxhës, por asnjeri prej nesh nuk e kishte parë ndonjëherë në xhami. Sidoqoftë, mixha Dilë ishte një njeri tejet i qetë. Përkundrazi, prezenca e tij kudo dhe përherë rrezatonte butësi dhe mirësi. Nuk fliste shumë me të tjerët dhe gjithnjë dukej se ishte i gëzuar dhe i lumtur. Nga goja e tij kurrë nuk është dëgjuar ndonjë fjalë e keqe ose urrejtje ndaj dikujt. E vërteta e vetme që dihej saktësisht ishte se mixhës Dilë, para ca vitesh, i kishte vdekur bashkëshortja, me të cilën kishte kaluar një jetë të lumtur bashkëshortore, ashtu që, sikurse kishte pranuar një herë, ende vuante për mungesën e saj. Nga fëmijët, Zoti ia kishte falë dy djem dhe që të dytë ishin punësuar përkohësisht në botën e jashtme. Mixha Dilë nuk punonte dhe nuk kishte asnjë burim të ardhurash. Në ekzistencën materiale, babanë e mbanin djemtë, duke i dërguar çdo muaj para. Që të dytë ishin të martuar me gra joshqiptare. Askush nga fqinjët nuk i kishin parë, as takuar ndonjëherë djemtë e mixhës Dilë, sepse asnjëri prej tyre, që nga mbarimi i luftës, nuk kishte ardhur në Kosovë. Thuhej se, pikërisht pse djemtë e vet ishin martuar me gra joshqiptare, mixha Dilë ishte prekur shumë. Dihej edhe një e vërtetë tjetër, se mixha Dilë natën rrinte deri vonë, nga dritarja e të cilit kurrë nuk ndalej drita e ndezur.

Jeta e këtij plaku kishte ngacmuar edhe kureshtjen time. T'ju them sinqerisht, gjithnjë kur e shihja, më kaplonte një ndjenjë e ëmbël kënaqësie. Nuk di sesi ta shpjegoj atë ndjenjë, por di se ai gjithnjë reflektonte pozitivistet. Çuditesha pse për këtë njeri të mirë dhe për jetën e tij thureshin aq dyshime të këqija. Ne jemi një popull i tillë që, sa më pak dimë për dikë, aq më tepër kemi prirje të trillojmë kuriozitete, duke i zmadhuar të qenët, apo të paqenat kot.

- Pushove mjaft? - u dëgjua zëri joshës i mixhës Dilë.

- Pse jam këtu? Kush më bëri në këtë gjendje? - pyeta si i liruar nga ndonjë magji. Ai vetëm më shikoi qetësisht, duke më buzëqeshur lehtë, dhe me zërin e tij të ëmbël, tha:

- Këtu je sepse mbrëmë, duke u kthyer në shtëpi, të pashë të shtrirë përtokë në baltë. Vërejta se ishe i dehur tepër. U mundova të të ngris ngadalë, por pashë se e kishe fytyrën të lënduar dhe të përgjakur. Të vura me vështirësi në shpinë dhe ti në atë moment lëshove një britmë të dhembshme. Britma ishte nga dhembjet, të cilën gjë e konstatova pas dyshimit se e kishe të thyer ose të lënduar rëndë edhe këmbën. Të mora ngadalë dhe të solla në shtëpinë time. Kjo është e tëra pse gjendesh këtu…

- Jo, Jo! - klitha si i çmendur - nuk më kujtohet gjë!

- Pusho edhe pak e pastaj duhet të shkojmë te mjeku. Sigurisht e ke të thyer këmbën. Tani provo të ngrihesh ngadalë dhe fillo të pastrohesh. Pastaj, veshi këto rroba. Janë të miat. Shpresoj se të vijnë taman.

Pasi tha këto fjalë, ktheu kokën kah tavolina dhe sikur u kujtua:

- Merr pak ajran**,** të bën mirë në lukth pas dehjes.

- Oho… qenka ora 12-të e darkës…! Ah, nëna! Nëna sigurisht është mërzitur…

- Mos ke frikë! Pasi të solla këtu, menjëherë e njoftova edhe nënën tënde se do të qëndroje këtë mbrëmje tek unë. Nuk desha që ajo e gjora të të shihte në këtë gjendje - të leckosur dhe të sakatosur!

- Ah, sa i pafat jam unë! Nuk di pse më bëri Zoti kështu? Nuk dua të

jetojë më… me të vërtetë mixha Dilë nuk dua të jetoj më kështu dhe një ditë…

- Pëssssst! Hesht! Hesht, o biri im i dashur. Në rend të parë, duhet ta dish se fatin njeriu vetë e krijon, dhe, së dyti, ti nuk je rastësisht në këtë botë. Asgjë nuk është rastësisht në këtë botë. Kjo çka të ka ndodhur dhe ajo çka mund të të ndodh në të ardhmen, është fati të cilin e ke krijuar dhe zgjedhur vetë.

- Dokrra! Flet dokrra, mixha Dilë! Ku e kam kërkuar unë këtë fat të mbrapshtë përplot vuajte dhe amulli. Nuk di kush është ai budalla që e kërkon një gjë të tillë. Këtë sigurisht e di edhe ti.

Në këto fjalë të rrepta isha më se i bindur, por mixha Dilë vetëm më shikoi me ironi. Gjysmë i buzëqeshur, si zakonisht, më kurajoi lehtë. “Ma bëni rrafsh”- siç thotë populli:

- Do të vjen koha kur një ditë do ta kuptosh këtë. Do të vjen koha…

- Po kur do të vjen kjo kohë, dreqi e marrtë, kur unë një ditë të shkoj në botën tjetër , a? Atë kohë e mendon ti…?

- Ajo kohë do të vjen kur ti sinqerisht ta kërkosh atë… - përsëri mu përgjigj me atë ironinë e tij të zakonshme, e cila edhe pse e këndshme, filloi të më nevrikoste.

- Mirë, mirë - i thashë - po kush jam unë? Më thuaj, pra, kush jam unë? Dhe këtë e thashë me një ton të lartë sikur ende isha i dehur, dhe sikur tërë gabimin për mbrapshtinë time e kishte vetë mixha Dilë. Përsëri më shikoi me atë ironi karakteristike. Ma vuri lehtë dorën e tij të njomë mbi ballë, dhe sikur nuk donte të na dëgjojë askush, mu përgjigj qetë:

- Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë që digjet pandërprerë dhe quhet jetë… Tani nëse je çlodhur - ndërroi temë mixha Dilë - mund të vishesh ngadalë dhe përgatitu të shkojmë te mjeku, sepse sinqerisht dyshoj për frakturën në këmbë. E kam ftuar edhe automjetin e ndihmës së parë dhe ata veç sa s'kanë mbërritur.

“ ***Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë që ndizet pandërprerë dhe quhet jetë…”***

Sa e sa herë ky refren më tingëllonte si i gjallë në shqisat e mia, dhe çdo herë që e përjetoja tingëllimin e saj,

sikur fitoja një kuraje për jetën. Sado që ishte vetëm një pikë optimiste e ujit në det, kaherë nuk e kisha përjetuar këtë ndjenjë të këndshme për jetën. Me të vërtetë nuk di si ta përshkruaj. Ajo më vinte nga brendia e qenies sime dhe pandërprerë më tingëllonte në vesh. Tingëllonte ëmbël, me zërin e mixhës Dilë, si të ishte e incizuar në rekorder dhe dikush ta lëshonte përsëri:

“ ***Ti je realiteti i kësaj bote…*** “

Pas të gjitha analizave detaje që më bënë në spital, konstatuan se përveç disa hematomave në trup dhe gërvishtjeve në fytyrë, kisha të thyer edhe këmbën e djathtë. Këmbën, pas disa intervenimeve të dhembshme të ortopedit, ma vunë në gips duke më preferuar që të qëndroja edhe disa ditë në spital.

Sa isha i shtrirë në spital, askush nuk më vizitoi. Askush, përveç nënës sime të dashur, e cila vinte dhe nga dy herë në ditë, duke më sjellë ushqimin që gatuante vetë. Vinte dhe ulej në karrigen pranë shtratit tim duke qëndruar kështu gjatë së bashku.

Diçka ishte karakteristike, ndoshta edhe jo për t’u çuditur aq për karakterin e saj përherë dinjitoz: Kurrë nuk e përmendte shkakun e qëndrimit tim në spital dhe as që hapte bisedë për pijen që tani më edhe për mua ishte bërë e tepërt. Gjithmonë, më parë, kur ndonjëherë kishim kohë të qëndronim më gjatë së bashku në shtëpi, shfrytëzonte rastin t’i përmendte nipat dhe martesën time, por këtë herë nuk e bënte këtë. Vetëm më jepte kuraje dhe interesohej mos kam

dhembje. Kishte frikë, siç thoshte, pasi të ma hiqnin gipsin nga këmba “mos do të mbetesha sakat”.

Dita e parë në spital më kaloi me dhembje të pandërprera të këmbës së thyer. Mjekët më kurajonin se nuk do të kisha komplikime të mëvonshme, dhe kjo veçanërisht nënës i jepte një kënaqësi të veçantë. Ditën e dytë më pushuan dhembjet, dhe tek atëherë fillova të ndjeja mërzinë e spitalit. Shtrirja në shtrat më ishte bërë monotone. Gjatë kësaj kohe, përjetova shumë mungesa, për shokët që tanimë isha bindur se nuk i kam më, të afërmit e mi që nuk donin as të më llogaritnin fare se jam gjallë… Ah! Përsëri ajo ndjenjë e mjerë shpirtërore: “Unë jam kurkushi, unë jam askush, vetëm një pijanec ordinar në këtë jetë të mallkuar, në të cilën isha i dënuar të jetojë.” Por … mixha Dilë! Ku është miku im i dashur, mixha Dilë?! Së paku ai nuk kishte arsye të mos më vizitonte…

“Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë që digjet pandërprerë dhe quhet jetë…”

Posa mu kujtua mixha Dilë, në mua jehoi tingëllima e zërit të tij të ëmbël dhe kumbues, duke shkaktuar një ndjenë të një euforie të këndshme, që unë ndoshta mund ta quaja “vetëbesim”. Por, si është e mundur që ai, i cili bëri aq shumë për mua, tani të mos më vizitojë. Çfarë është në realitet ky njeri i çuditshëm?

Një mëngjes, duke qëndruar në shtrat, ashtu gjysmë i zgjuar, dëgjova si në ëndërr një zë që mu duk shumë i njohur.

- Mirëmëngjesi, njeri i mirë!
- Mixha Dilë! - brohorita nga gëzimi; - erdhe…?!
- Erdha, se më kërkove; - më ndërpreu.
- Nga e di ti se unë të kërkova? - e pyeta me habi.
- Ha, ha, ha! - buzëqeshi me zë; - ti më kërkove sinqerisht, nga zemra dhe kjo ishte shenjë për mua që të të vizitoj.
- E si? më thuaj, të lutem. Pse më nënçmon dhe bën shaka me mua, duke më quajtur njeri i mire, kur unë, e ti këtë e di fort mirë, nuk i kam bërë mirë askujt gjer më tani?
- Ha, ha, ha, ha… - përsëri qeshja e tij karakteristike përplot ironi, por këtë herë sikur më nervozoi pak.
- Asnjë krijesë e Perëndisë vetvetiu nuk mund të jetë e keqe. Mendimet… Mendimet tona të mira apo të këqija, miku im, janë ato që na bëjnë ashtu.
- A mund t'i ndryshoj mendimet e mia dhe si ta bëj këtë?
- Shumë lehtë! Ashtu sikurse në mendimet e tua më kërkove sinqerisht të vij dhe unë erdha, ashtu sinqerisht duhet të kërkosh që t'i ndërrosh ato.
- Unë do të kisha dashur ta bëj këtë. Të lutem, mixha Dilë, më ndihmo! - ia bëra këtë lutje si në vaj dhe e ndjeva veten tejet infantil përballë këtij personaliteti që tanimë më kishte përvetësuar në tërësi.
- Po, por, më së pari, duhet përfundimisht të abstenosh nga pija, e pastaj gjërat vijnë me rend. Jeta nuk

është kaos, siç mendon ti; ajo është një harmoni e përsosur ku ka rend dh disiplinë.

- Ma thuaj vetëm një hap më të voglin që duhet bërë dhe unë do ta bëj këtë.

- Po të them, pra: Pasi të dalësh nga spitali, merre një qiri dhe shko tek tyrbja e “DALLGËM BABAIT”. E di ku është kjo tyrbe?

- Po, e di mirë; - u përgjigja me gëzim, duke ndjerë njëfarë sigurie. Sikurse diçka, më në fund, lëvizi nga vendi.

- Pasi të shkosh në tyrbe, ndeze qiriun; pastaj, bjer në gjunjë përballë dhe poho, sinqerisht, kështu:”*Unë kurrë nuk pi alkool!”*. Përsërite këtë 40 herë pa ndërprerë. Ama… mbaje në mend mirë. Nëse e thyen këtë premtim, duhet ta dish se do të të zërë “mallkimi i madh”. Mos harro!… “Mallkimi i mall

E tërë kjo mu duk si një ëndërr, sepse tani më mixha Dilë nuk ishte aty, u zhduk aq shpejt saqë kisha përshtypjen sikur nuk kishte qenë fare. Fshiva sytë dhe e binda veten: “Jo, jo nuk është ëndërr! Mixha Dilë ishte aty dhe unë fola me të”. E tëra ishte realitet.

Mendoj se takimet e mia me mixhën Dilë, gjithmonë ishin befasi e këndshme dhe rrezatonin një optimizëm të pashoq tek unë. Pse ndodhte kështu, as vetë nuk e dija. Ai ishte një njeri i çuditshëm, aq i çuditshëm, saqë unë nuk kam shprehje si ta përshkruaj këtë. Sidoqoftë, në prani të mikut tim të ri, unë nuk isha më vetë, nuk isha pa shok dhe mik, ai sikur filloi të më bëhej hija ime, udhërrëfyesi im në jetë…

Pas një jave mjekim, më lëshuan në shtëpi si i shëruar, por edhe dy javë të tjera duhej ta mbaja gipsin e mobilizimit në këmbë. Fatlumësisht diagnoza ishte rehabilituese.

Kishte kaluar më tepër se një javë dhe unë fare s'e kisha kërkuar alkoolin. Ndjeva atë dëshirë të vjetër që ta provoja prapë. "Disa gota sigurisht kishin ngacmuar disponimin tim " - thash me vete. Isha me **"këmbëza"**, këto ndihmëse ortopedike që më dukeshin paksa të vështira, por, sipas preferimit të ortopedit, duhej t'i përdorja gjer në heqjen e gipsit. Me katër këmbë, ngadalë, dhe me pak vështirësi, u nisa në drejtim të lokalit më të afër të lagjes; por, për momentin … Sikur u ngurova!!! Stepa në vend dhe një fuqi latente më pengoi nga ky qëllim. Para meje u vizatua fytyra e mixhës Dilë. Dukej si zakonisht i qetë dhe me atë buzëqeshjen e ëmbël ironike. Menjëherë mu kujtua e tërë biseda në spital dhe me një guxim të patundshëm e qortova veten: "**N d a l**! **Më në fund duhet t'bësh diçka për vete**"!

Në vend të disa gotave me raki, bleva një qiri dhe ashtu siç më kishte preferuar mixha Dilë veprova në tyrben e "DALLGËM BABASË".

Pasi dola nga tyrbja, ndjeva një siguri në vete. Isha disi i gëzuar dhe i lumtur që më në fund diçka bëja për veten. Ky gëzim që buronte nga brendia e qenies sime, edhe më tepër ma sforconte bindjen se këshillat dhe vetë rituali me qirinj, funkciononinin. Sikur menjëherë më sollën një siguri, një vetëbesim dhe një ndjenjë që kaherë kisha

nevojë ta përjetoja. Me të vërtetë mixha Dilë ishte një njeri i urtë dhe një dijetar i madh. Duhej patjetër ta ndiqja atë. Duhej, patjetër…

Dy javët tjera të pritjes për heqjen e gipsit nga këmba dhe të kontrollit të fundit tek mjeku, më kaluan kryesisht në mendime dhe analiza për të gjitha gjërat që më kishin ndodhur që nga dita e dehjes dhe lëndimit tim, e gjer tek këshillat dhe kontaktet e drejtpërdrejta me mixhën Dilë. Në momentet e dyshimit të caktuar psikik, kur tendencat e rikthimit të mendimeve të këqija që kisha për veten ishin të fuqishme, ato i zëvendësoja me fjalët e mixhës Dilë, të cilat ngadalë filluan të rrënjoseshin thellë në mua :

"Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë i cili digjet pandërprerë dhe quhet jetë…"

Duhej pranuar se në momente të caktuara ndjeja nevojën e madhe për një gotë, por ushtima në vesh e fjalëve të mixhës Dilë: "Mbaje në mend mire, nëse e thyen këtë premtim, duhet ta dish se do të zë "mallkimi i madh". Mos harro, "mallkimi i mall"…"mallkimi i madh…", më zmbrapsnin nga ky qëllim.

Edhe pse ishim fqinjë dhe shumë afër me shtëpia, që nga ajo ditë kur më kishte vizituar në spital, nuk e kisha takuar mixhën Dilë. Në brendinë e qenies sime, ndjeva një dëshirë të flaktë që ta takoja sërish. Të bisedoja me të, sepse tani kisha edhe mjaft shkaqe për të cilat më duhej mendimi dhe këshillat e tij. Jo vetëm kaq! Dëshiroja që me krenari të lavdërohesha para tij se kisha vepruar plotësisht

ashtu siç më kishte këshilluar. Kishin kaluar më se tri javë, dhe unë as që e kisha shijuar alkoolin. Edhe pse isha në vitet e mia të tridhjeta, kurrë gjer më tani nuk kisha takuar një njeri të tillë, i cili do ta ngacmonte aq shumë kureshtjen time dhe dëshirën e flakët që të isha në praninë e tij. E di, kam qenë i dashuruar dhe ky përjetim mund të thuhet se ishte disi i njëjtë, po jo edhe plotësisht si me mixhën Dilë. Prezenca e tij bënte një rrezatim aq pozitiv saqë të vinte në një pozitë transi të papërshkruar. Ai të preokuponte si tërësi dhe çdo fjalë që fliste sikur mbushte zbrazëtirën e qenies sime të rrënuar. Ndryshe, do të mund të thuhej, se ai ishte një murator që muratonte gropat e mureve të rrënuara të kështjellës sime, duke kontribuar që ajo tërësi të mos asgjësohej nga një katastrofë e shkatërrimit total e cila më ishte kanosur pandërprerë deri para njohjes sime me këtë njeri.

Në këto momente të mendimeve, u hap dera dhe në dhomë hyri nëna duke më njoftuar se kishim mysafirë:

- Na ka ardhur fqinji ynë i ri, ai njeriu i cili të pati ndihmuar kur qe lëndur; - paralajmëroi nëna vizitorin.

Pa e përfunduar në tërësi fjalën e fundit, në hyrje veç u paraqit figura e njohur dhe tanimë tejet e dashur e mikut tim, mixhës Dilë.

- Mixha Dilë! - brohorita nga gëzimi i pamasë.

- Ti gjithnjë vjen kur unë për ty kam nevojë më së shumti.

- Të kam thënë: Sa herë të më kërkosh, dhe sinqerish të kesh nevojë për mua, unë do të jem aty.

- Mixha Dilë, bëhen gati tri javë e fare nuk e kam shijuar alkoolin - u nguta që sa më parë t'i tregoja këtë risi mikut tim, nga i cili prita një reagim më pozitiv. Por, ai vetëm më shikoi me njëfarë dyshimi latent, dhe këtë herë me një buzëqeshje diç më pak të shprehur se zakonisht.

- E di!- m'u përgjigj ai; - por, ende ke dyshim në vete, prandaj edhe erdha që ta tërheq vërejtjen për thyerjen eventuale të betimit të dhënë. Pasojat dihen: Të pret MALLKIMI I MADH! Mbaje në mend: MALLKIMI I MADH…

- Jo, jo mixha Dilë, unë kurrë nuk do të lejoj një gjë të tillë!

- E di, e di, o njeri i mirë, prandaj edhe kam besim në ty.

Në këtë moment hyri nëna me tabakanë, ku ishin dy filxhanë kafe të përgatitur mbi të. Njërin e servoi pranë mysafirit, kurse tjetrin ma ofroi mua duke e lënë mbi tavolinë pranë shtratit. Edhe pse më shërbente mua, shikimin dhe vëmendjen e kishte fiksuar tek mixha Dilë, i cili, duke ia lexuar mendimet, e vërejti qëllimin e saj.

- E di, nënë, se çka ke në zemër. Shpirti yt i pastër dhe dashuria e sinqertë regjistron çdo ndryshim tek biri juaj.

- Më duket se djali im ju do shumë. Një ditë ju përmendi edhe në gjumë; - tha nëna me kënaqësi dhe u largue nga dhoma, sikur nuk dëshëronte të përzihej në "muhabete burrash".

- Mixha Dilë, më thuaj të lutem, si është e mundur që, sa herë të kërkoj në mendje, ju paraqiteni menjëherë. Mos jeni ju mbinjeri, magjistar…?

- Unë jam njeri, krijesë jo e rastësishme në këtë botë. Jam plotësisht njëjtë si ti; dallimi në mes meje dhe teje qëndron në atë se unë shoh dhe regjistroj rreth vetes ato gjëra që ti nuk mund t'i shohësh.

- Pse unë nuk mund t'i shoh? - e pyeta me plot kurreshtje.

- Sepse një gjë të tillë ti nuk e dëshiron. Ti e sheh realitetin vetëm ashtu siç e ke krijuar në bindjet e tua të gabuara.

- A mund të bëhem edhe unë si ti?

- Mundesh nëse këtë e dëshiron sinqerisht dhe me tërë qenien tënde.

- Po, unë e dëshiroj sinqerisht këtë mixha Dilë. Jam i bindur që këtë dëshirë timen të flaktë edhe ti e ndjen; - i thashë me një siguri të plotë, sikur kaherë të kisha sjellë një vendim të tillë dhe, tani, të isha duke pritur vetëm relizimin e tij.

Për momentin mbretëroi një qetësi e madhe. Mixha Dilë ishte zhytur thellë në mendime. Pas disa çastesh heshtjeje, duke lëvizur kokën në shenjë pohimi, nga goja e tij, më në fund, dolën fjalët e pritura:

- Ashtu… Ashtu qoftë!

- T'ia nisim, pra?- pyeta unë me padurim dhe me një ndjenjë gëzimi që nuk munda ta fsheh.

- T'ia nisim!- pohoi mixha Dilë. - Lekcioni yt i parë për fillim është i lehtë. Çdo mëngjes, posa të zgjohesh, dhe, çdo mbrëmje, posa të rashë në shtrat për të fjetur, duheh të koncentrohesh dhe, pandërprerë, dyzet herë, ta përsërisësh fjalinë: "***Unë jam njeriu më i lumtur në botë***". Këtë ritual, në vete, duhet ta bësh një javë dhe, pastaj, të pres tek unë, ku do të bisedojmë edhe për gjëra të tjera të rëndësishme. Dakord?

- Dakord, mixha Dilë.

Pranova, por kurrsesi nuk më hynte në kokë se çka nënkuptonte kjo lojë sugjestionesh, nga dy herë në ditë. Nuk desha t'i kundërvihesha mixhës Dilë. Ai sikur edhe m'i lexoi mendimet:

- Kupto, bir! Jeta është harmoni e përsosur dhe në të ka rregull dhe disiplinë. Për t'i patur të qarta këto gjëra të filozofisë së jetës dhe ekzistencës, shumë veprime për fillim na duken qesharake, sepse bindjet tona të vjetra për jetën dhe realitetin objektiv na pengojnë në këtë drejtim. Por, mos ta kapërcejmë rendin. Ka kohë kur do ta kuptosh edhe këtë. Tani, për ne do të jetë e rëndësishme që ti detyrën e pranuar ta kryesh me rregull dhe përpikëri. Shihemi, pra, pas një jave!

Pasi tha këto fjalë, sikur e kishte zakon, u ngrit me shpejtësi dhe u zhduk, duke lënë përshtypje se nuk ka qenë fare i pranishëm. Pas largimit të furishëm të tij, mua më mbeti dëshira e flaktë dhe ankthi për takimin tonë pas një jave, i cili, sinqerisht, më dukej tejet larg.

Çdo mëngjes, para zgjimit, dhe, çdo mbrëmje, para fjetjes, i shqiptoja vetes nga dyzet herë fjalët e mixhës Dilë: "*Unë jam njeriu më i lumtur në botë*." T'u them të drejtën, këtë e bëja në mënyrë mekanike, pa kurrfarë ndjenjash dhe pa ndonjë analizë të efektit të saj. Vetëm e vetëm me një dëshirë, që sa më shpejt të kalonte java dhe përsëri të takohesha me mixhën Dilë, por tanimë jo vetëm si shok, por edhe si nxënës i tij. Ndonjëherë, në momente, më vinte ta ndërpreja këtë ritual sugjestionesh, sepse më dukej si mahi e paskrupull dhe qesharake. Por, besimi i madh që unë kisha tanimë tek ai, e tejkalonte këtë dyshim. "Nuk e kërkon kot nga unë mixha Dilë këtë…"

Pasi isha shëruar në tërësi dhe kisha hequr gipsin nga këmba, gjithnjë e më shumë vëreja një ndryshim tek unë. Nuk ishte ky ndryshim vetëm shërimi i tërësishëm nga lëndimet, por edhe disponimi im i përgjithshëm më dukej më i mirë. Edhe më tej vazhdoja me ato përsëritje monotone të sugjestionit, nga dy herë në ditë. Ndonjëherë, e tërë kjo më dukej si mahi, por kisha vendosur t'u përmbahesha të gjitha sugjerimeve të mixhës Dilë. Kuptohet, edhe po të doja, nuk kisha rrugëdalje tjetër.

Unë kisha vendosur ta ndërroja mënyrën e tanishme të jetës sime, dhe nga ky qëllim nuk kishte kurrfarë lëkundjeje.

Tanimë, përveç disponimit paksa më të mirë, fillova t'i vëreja edhe disa gjëra të imta përreth, që më parë ato nuk më linin kurrfarë përshtypjeje të veçantë. E vrojtoja me kujdes dhomën time. Sa më shpesh e bëja këtë, për aq

më pengonte renditja e orendive të saj. Një ditë vendosa që të bëja një ndryshim sadopak estetik. Nëna ishte kundër kësaj ideje, por jo që i pengonte se unë doja ta ndryshoja renditjen e orendive në dhomë, por ajo kishte frikë mos po më pezmatohej varra e këmbës, posa e shëruar.

Nuk e dëgjova dhe veprova sipas mendjes sime.

Ishte një ditë e ngrohtë maji kur me përkushtim iu përvesha punës. Në kokë më vinin ide të reja dhe konstruktive për pamjen estetike të strofullës sime, ku tanimë e kaloja më së tepërmi kohën, kurse më parë aty isha vetëm kalimthi, deri në pritjen e esëllit të nesërm. Nuk më hynte assesi në kokë, si kisha mundur të lejoja që kjo "hallakamë" të ekzistonte pa më penguar fare gjer tani.

Diçka me të vërtetë ka fillur të ndodh me mua. Diçka ka lëvizur nga vendi. Unë sikur nuk isha më ai i përparmi. Vërtetë edhe nuk isha! Alkooli si mjet i zgjidhjes së problemeva, tanimë ishte larguar nga jeta ime, andaj edhe kisha kohë më tepër që në mënyrë kreative ta përqëndroja vëmendjen time.

Por, nuk ndodhte tjetërsimi im vetëm këtu… ishte dhe disponimi! Diponimi im tanimë ndryshonte. Unë ndjehesha më i kënaqur, më i hareshëm, më i gëzuar dhe përgjithësisht i lumtur. Natyrisht se këtë analogji e bëja vetëm duke marrë për bazë gjendjen time shpirtërore para aksidentit me këmbën, dhe para njohjes me mixhën Dilë.

Pranoj! Me të vërtetë diçka kishte ndodhur me mua… Kisha disponim më të mirë. Nuk di se nga më vinte kjo ndjejnë, por vëreja se ky përjetim në kohën e fundit

ishte shpeshtuar dukshëm. Dhe, kush di sa kisha të drejtë, por unë këtë e shpjegoja me padurimin tim që të kalonte java dhe sërish të takohesha me mixhën Dilë. Nëna shqetësohej nga pak, por edhe ajo vërente këtë ndryshim sado të vogël tek unë. Ndoshta shkaku i gëzimit të saj ishte kënaqësia që unë ende i qëndroja besnik fjalës së dhënë për abstenim nga alkooli.

Ditët kaluan shpejt dhe erdhi dita që unë të nesërmen duhej të shkoja tek mixha Dilë. Me padurim e prisja këtë moment. Gjatë tërë javës më silleshin vërdallë në mend të gjitha urtësitë e tij që unë i pranoja dhe i absorboja si të ishin të shenjta. Ato edhe ishin për mua të shenjta, edhe pse disa veprime që ai i kërkonte nga unë, ende më dukeshin të paqarta, besa edhe qesharake. Bie fjala ajo me sugjestionet dy herë në ditë nga dyzet herë. Përsëritja në mënyrë mekanike e fjalëve “ unë jam…” më ishte automatizuar, kështu që, sigurisht nga monotonia e këtij veprimi, më krijoheshin edhe disa parafytyrime, të cilat, më bëhej sikur më ndillnin të identifikohesha me situatën nga përmbajtja e sugjestionit.

Dhe dita kaherë e pritur erdhi…

KAPITULLI I II

Nuk di a ta quaj këtë ditë si dita e parë e shkollës së aftësimit për jetë, ose ditë e kursit shpirtëror të filozofisë praktike. Sido që të jetë, ishte një ditë e takimit miqësor me një dashuri të sinqertë që unë kisha për mentorin tim të ri të jetës. Ndjenjën e shfaqur të kësaj dite e krahasova me atë të ditës së parë të shkollës fillore. Krejtësisht mu duk ditë e njëjtë, me një ndryshim të vetëm: Atëbotë në shkollë unë shkoja së bashku me nënën e cila më pati përcjellë përdore deri në hyrje të klasës dhe më pati dorëzuar si "amanet" tek mësuesja ime e dashur, kjo krijesë për të cilën edhe sot e kësaj dite, unë kam një konsideratë të veçantë. Më kujtohet se isha tërësisht i hutuar me këtë realitet të ri dhe ndjeja njëfarë "marre", ose më mirë të them njëfarë treme specifike. Natyrën e këtij emocioni kurrë nuk kam qenë në gjendje ta shpjegoj.

Në krahasim me ditën e parë të shkollës fillore, sot te mixha Dilë unë shkova vetëm. Nuk e kisha atë tremë, dhe ndjeja një kënaqësi të përzier me padurimin e pritjes së gjatë. Doja që sa më parë ta takoja dhe të ishim së bashku. Nuk di pse e bëra këtë krahasim. Ndoshta pse vetë momendi ishte analog me fillimin e marrjes së një dijenije të re. Ndoshta edhe intuita më bënte me dije se të dyja këto ditë do të ishin të skalitura thellë në kujtesën time si një rifillim i ri jetësor!

Ashtu edhe ishte.

Sidoqoftë, që nga dita e njohjes me mixhën Dilë, në mua kishte ndodhur një renesansë e vërtetë.

U nisa menjëherë. Vërejta se dera e portës qe e hapur. Hyra i sigurt brenda, pa trokitur fare. Posa iu ofrova dhomës dhe hapa derën, vërejta mixhën Dilë se ishte ulur në karrigen pranë tavolinës së vet të punës dhe lexonte diçka, si broshurë apo fletushkë. Nuk e çoi as kokën të më shikonte, por vetëm më dha shenjë, me dorë, që të hyja brenda. Ky gjest i tij më shtyri të konstatoja se ai veç më priste dhe broshura, që e kishte në lexim, i dedikohej pikërisht qëllimit të sotëm, përmbajtjen e së cilës ndoshta do ta kishim si lekcion. U ula në një karrige afër tavolinës, përballë tij. Mbretëroi një qetësi, të cilën as unë nuk desha ta prishja, edhe pse, ashtu siç e do zakoni, e kisha ndërmend ta përshëndetja.

Pas disa minutash heshtjeje, duke fiksuar me shikim broshurën që kishte në dorë, mixha Dilë filloi të lexonte disa citate të vargjeve, që në atë moment, për mua ishin të pakuptimta:

Në fillim
nuk kishte as ekzistencë, as joekzistencë.
E gjithë kjo botë ishte energji e pashfaqur. . .
Një frymonte pa frymë, me forcën e vetes.
Dhe asgjë tjetër nuk kishte. . .

Këto vargje janë nga RIGA VEDA, një shkrim i vjetër i civilizimit të lashtë indian; vargjet titullohen: "*Himni për krijimin*"...

Duke sqaruar burimin e strofës së cituar, mixha Dilë hetoi se unë e shikoja me habi, ngase nuk e kisha kuptuar përmbajtjen e tyre. Më tej ai vazhdoi:

- Si praktikant i mësimit të realitetit tonë ekzistencial, në rend të parë duhet kuptuar burimin dhe rrjedhën e zhvillimit të procesit të vetëkrijimit. Kur ta kesh të qartë këtë, atëherë vetvetiu do t'i kesh më të kapshme edhe shumë parime tjera të ligjshmërive shpirtërore. Pas kësaj, ndalngadalë, do të fillosh që gjërat e tanishme t'i shikosh nga këndvështrimi më realist. Kuptoje këtë patjetër! Realitetin e tanishëm, ashtu sikurse është, e ke krijuar vetë, përmes eksperiencës tënde dhe mënyrës së gabuar të të menduarit. Ashtu sikurse shkruan në VEDAT e vjetra, për të sqaruar ekzistencën me logjikën e të kuptuarit racional, patjetër duhet pranuar se, në fillim çdo gjë ishte asgjë, energji e pashfaqur, dhe çdo gjë ishte diç që frymonte pa frymë, harmoni e përsosur e veprimit. Me parimet e rregullava tona logjike, këtë dukuri, do ta definonim si inteligjencë e paskajshme, frymë hujnore, ose, nëse dum më konkretisht, mund ta quanim: **ZOT.**

- A nuk janë këto shpjegime religjioze? Me këto shabllone jam ngopur tërë jetën, mxha Dilë; - nisa "të protestoja". - Ti e di se edukata ime familjare është patriarkale... - bëra këtë konstatim emocionues, pa dashur që të kuptohej si provokacion nga bashkëbiseduesi im

Ai as që e kishte marrë ashtu. Vetëm pohoi qetas me kokë dhe vazhdoi:

- Në njëfarë dore janë edhe kuptime përmes shablloneve religjoze. Këto “shabllone” fillet i kanë nga njerëzit e urtë që për momentin kohor kuar kanë jetuar, ata ishin shumë më inteligjentë dhe njohuria e tyre kapte nivelet hyjnore. Sikur ata, në komunikim me masën e gjerë të bashkëkohasve të vet, emetimin e kësaj urtie, do ta bënin në nivelin e inteligjencës së vet kuptimore, për at kohë dhe hapësirë të caktuar, do të ishte anakronike, e papranueshme dhe absurde. Ata tërësisht kanë qenë të vetëdijshëm se njerëzimi, si shoqëri, mësimet e tyre të realitetit objektiv ekzistencial, do t’i kuptojë shumë më vonë. Nëse shkrimet nga të gjithë librat ekzistuesë religjiozë merren ashtu sikurse janë, pra, bukvalisht, për nivelin e vetëdijes së sotme shoqërore, do të duken ngapak edhe naive. Imponimi i ruajtjes së përmbajtjes orgjinale burimore, nuk ka qenë i rastësishëm, sepse, vetëm ashtu, sigurohej tërësia e esencës së tyre kuptimore.

Jo vetëm kaq.

Përmes metodës së përgjithësimit të kuptimit të tyre, do të inponohet nevoja e qasjes më rrënjësore dhe më profesionale e një interpretimi të mirëfilltë. Pra, do t’i sfidojnë vetëm hulumtues të caktuar, që këtyre mësimeve u qasen me zemër të çiltër dhe plotësisht pa paragjykime. Andaj, të gjitha librat e besimeve fetare, përherë do të jenë aktuale në çdo kohë dhe hapësirë të caktuar.

- A mendon në ata njerëz, që kuptimin e vërtetë të domethënies në këto vepra religjioze, do ta lexojnë në mes të rreshtave?

Pyetja ime ishte thjesht metaforike.

- Ashtu disi; meqë, të gjitha veprat religjioze në përgjithësi janë dramatizime shpirtërore dhe psikologjike të realitetit tonë, andaj edhe domethënia e vërtetë e tyre zbulohet vetëm nëpërmjet një qasjeje psikologjike dhe shpirtërore të interpretimit. Fjalët e shkruara në librat e shenjtë përbëjnë frymën hyjnore të burimit të tyre, prandaj, vetëm atëherë kur të arrihet ky nivel, ato vetvetiu bëhen të kuptueshme dhe të qarta për çdo individ. Përmes sqarimit të tyre kuptimor, unë vetëm do të ngacmoj disponimin tënd që ti të preokupohesh me to. Kuptimi i vërtetë i domethënies së tyre do të shfaqet vetvetiu, duke u shprehur në formë të kurreshtjes sfiduese për kërkime të mëtejme.

- Po si është puna me masën e gjerë që me fanatizëm i ndjek këto, siç i quajtëm “shabllone”?

- Ashtu edhe duhet të jetë. Vepron sistemi i inponimit të krijimit të besimit që më vonë automatizohet dhe shndërrohet në shprehi, gjegjësisht në mënyrën e caktuar të të menduarit kolektiv. Pra, në një besim që patjetër diku duhet ta ketë mbështetjen kuptimore të esencës së vet. Kështu që, nga zanafilla e tij e parë, në mënyrë të njëjtë, gjithnjë vjen duke u përcjellë në breznitë e gjeneratave të ardhshme.

- Kur do të arrij gjer tek vetëdisimi kolektiv mbi domethënien e vërtetë të tyre?

- Pyetje paksa e vështirë. Ndoshta dikur, me kohë, por ndoshta edhe kurrë! Me këtë përgjigje, të parën herë vërejta se mixha Dilë nuk ishte decidiv. Të parën herë ishte në dyshim për diçka që konstatonte.

Lejova të vazhdojë.

- Në BIBËL, apo edhe në të gjithë librat tjerë religjiozë, krijimi i botës si realitet yni objektiv, parimisht shpjegohet kështu: Në fillim toka ishte tërësisht e zbrazur. Nuk kishte male të larta apo lumenj të rrëmbyeshëm, lugina të gjelbra me lule dhe as qiej. Nuk kishte re të bardha apo kaltërsi detërash të thellë.Toka ishte një lëmsh balte dhe uji, e mbuluar me një errësirë dhe pa asnjë lloj jete... Kështu përshkruhej toka para ekzistencës sonë në realitetin materialist. Pastaj, fuqia e madhe hyjnore e Perëndisë për **shtatë ditë** krijoi Universin:

DITA E PARË: Errësira mbuloi tokën dhe Shpirti i Perëndisë lëvizi mbi ujë. Pastaj Perëndia tha: "**U BËFT DRITA"!** Dhe Perëndia pa që drita ishte *e* mirë. Ashtu **AI** ndau dritën nga errësira. Dhe, dritën e quajti **DRITË** dhe errësirën **NATË**.

DITA E DYTË: Perëndia tha "**LE TË KETË NJË KUPË QIELLORE MES UJËRAVE, QË T'I NDAJË UJËRAT NGA UJËRAT"!** Ashtu Perëndia krijoi kupën qiellore dhe ndau ujërat që ishin poshtë saj, nga ujërat që ishin sipër saj. Dhe kështu u bë. Perëndia e quajti kupën *qiellor*e - **QIELL**.

DITA E TRETË: Pastaj Perëndia tha *:*"**UJËRAT QË JANË NË QIELL TË GRUMBULLOHEN NË NJË**

VEND TË VETËM DHE TË SHFAQET STEREA” Dhe kështu u bë. Perëndia e quajti sterenë **TOKË** dhe ujërat e grumbulluara **DETE**. Pastaj Perëndia tha*:* “**TË MBIJË TOKA GJELBËRIMIN, BARËRAT TË NXJERRIN FARA DHE DRURËT FRUTORË TË JAPIN NË TOKË NJË FRUT QË TË PËRMBAJË FARËN E TIJ, SECILI SIPAS LLOJIT TË VET”!** Dhe kështu u bë.Toka prodhoi gjelbërimin, barërat bënin farën sipas llojit të tyre dhe drunjtë mbanin fruta me farën e tyre brenda, secili sipas llojit të vet. Dhe Perëndia e pa se kjo ishte e mirë.

DITA E KATËRT: Pastaj Perëndia tha: “**LE TË KETË NDRIÇUES NË KUPËN QIELLORE PËR TË NDARË DITËN NGA NATA, DHE TË SHËRBEJNË SI SHENJA PËR TË DALLUAR STINËT, DITËT DHE VITET, DHE TË SHËRBEJNË SI NDRÇUES NË KUPËN QIELLORE PËR TË NDRIÇUAR TOKËN.”** Dhe kështu u bë. Perëndia krijoi dy ndriçues të mëdhenj: Ndriçuesin e madh për qeverisjen e ditës dhe ndriçuesin e vogël për qeverisjen e natës. Ai krijoi, gjithashtu, edhe yjtë dhe ata i vendosi në kupën qiellore për të ndriçuar tokën, për të qeverisur ditën dhe natën dhe për të ndarë dritën nga errësira. Dhe Perëndia e pa se kjo ishte e mirë .

DITA E PESTË: Në mëngjesin e ditës së pestë, Dielli u ngrit në lindje dhe ngrohu barin e gjelbër dhe lulet plot shkëlqim, por nuk kishte asnjë peshk që të notonte nëpër ujëra dhe asnjë zog që të këndonte në pemë. Perëndia tha*:* **“TË MBUSHEN UJËRAT NGA NJË NUMËR I**

MADH QENIESH TË LARTA DHE TË FLUTUROJNË ZOGJTË LART MBI TOKË NËPËR HAPËSIRËN E MADHE TË KUPËS QIELLORE”! Kështu Perëndia bëri çdo gjë që lëviz në ujë: peshqit, balenat, luanët e detit dhe të gjitha llojet e kafshëve. Perëndia krijoi gjithashtu çdo lloj zogu që fluturonte në qiell...

DITA E GJASHTË: Perëndia tha*:* **“TË PRODHOJË TOKA QENIE TË GJALLA SIPAS LLOJIT TË TYRE”**! Dhe kështu u bë. Por krijesa më e madhe e Perëndisë akoma nuk ishte krijuar. Pasi mbaroi së krijuari kafshët, Ai tha *:* **“TA BËJMË NJERIUN SIMBAS SHEMBËLLTYRËS SONË DHE NË GJASIM ME NE. LE TA USHTROJË SUNDIMIN E TIJ MBI PESHQIT E DETIT, MBI ZOGJTË E QIELLIT, MBI KAFSHËT E MBI GJITHË BOTËN**”! Kështu Perëndia i krijoi njerëzit sipas shembëlltyrës së vet.

DITA E SHTATË: Pasi përfundoi qiellin, tokën dhe tërësinë e gjallesave, ditën e shtat*ë* Perëndia mbaroi veprën e vet madhore, NJERIUN, dhe po atë ditë pushoi.

- Sa kam qenë i vogël, që të më edukonte si mysliman të mirë, nëna përherë ma mbushte kokën me këso ligjëratash mbi hazreti Ademin, hazreti Havën dhe si u “kurdis dynjaja”...

Edhe pse këtë vërejtje nuk e kisha me qëllim të keq, ngjau si ironike. Pas pyetjes sima, mixha Dilë menjëherë mori një pamje serioze duke bërë një pauzë paksa më të gjatë në krahasim me herat tjera. Kjo më bëri

të dyshoj: mos, vallë, ai ishte ngacmuar me një reagim të tillë?

Por, nuk ndodhi ashtu. Ai, ndërkaq, ishte krejtësisht i qetë dhe në njëfarë dore linte përshtypje lajkatuese.

- Natyrisht; të mbetemi edhe pak tek të ashtuquajtuarat “shabllone religjioze”- tha kështu me buzë në gaz, duke ma bërë me dije se edhe ai dinte të bënte ironi.

- Para Adamit, Zoti për shtatë ditë e kishte krijuar Universin...

Përsëri këtu bëri një pauzë dhe, si një interpretues i mirë, për ta ruajtur vëmendjen e publikut, ndryshoi tonin e zërit, duke vazhduar më tej:

- Sigurisht që tanimë e ke të qartë se shtatë ditët që përmenden në këto shkrime religjioze nuk janë kohëra të matjeve tona racionale, por perioda biblike, apo edhe kuranore. Një ditë, nuk duhet ta marrësh hëpërhë si 24 orë, por si një ETAPË shumë të gjatë kohore. Sa zgjasin realisht këto etapa zhvillimore, sot e kësaj dite ende nuk është definuar saktësisht, edhe pse ekzistojnë disa hipoteza të guximshme shkencore. Sa për orientim, mund t’i marrësh si miliona vite...

Edhe këtu ndaloi. Kjo mënyrë ndalimi, në formë të pauzave të vogla, me ndryshimin e tonin të zërit në vazhdim, më bënte që unë të isha edhe më i vëmendshëm dhe më i koncentruar në përmbajtjen e temës që shtjellohej. Me kohë, fitova përshtypjen se ai qëllimisht dhe me dashje vepronte kështu pikërisht për të arritur këtë efekt.

Nuk kisha dyshim në këtë vlerësim. Mixha Dilë ishte një orator i përkyer.

- Perëndia, pra, *pasi* mbaroi Universin dhe u dha jetë gjallesave në tokë - vazhdoi: Krijoi njeriun si qenie më të përsosur në botë. Ai urdhëroi: "**TANI DO TA BËJMË NJERIUN. DO TA BËJMË ATË NË SHEMBËLLTYRËN TONË. NJERIU DO TË JETË SI NE"!** Mbaje këtë mirë në mend**: " ATË E KRIJOI SIPAS SHEMBËLLTYRËS SË VET DHE AI DO TË JETË SI AI VETË**..."

Këtë herë foli në mënyrë urdhëruese: Mbaje mirë këtë në mend! Sërish uli tonin dhe vazhdoi:

- Të vazhdojmë edhe ca me mënyrën e krijimit të njeriut. Perëndia mori pluhurin nga toka dhe i dha formën e një trupi që kishte krahë, këmbë, duar, shputa dhe një zemër. Ky trup kishte gjithashtu një kokë me sy, veshë, një hundë, një gojë dhe një tru. Pastaj, Perëndia fryu jetën në hundët e njeriut dhe ai u bë një qenie e gjallë. Burri u ngrit dhe qëndroi drejt në këmbë përpara Perëndisë. Perëndia e *q*uaj*ti b*urri*n* ***"ADAM"*** që do të thotë ***"TOKË"*** *apo* ***"BALTË E KUQE"***. Pastaj, Perëndia mbolli një kopsht në një vend të quajtur *EDEM*. Fjala **"Edem"** do të thotë ***"kënaqësi".*** Kopshti i Edemit shtrihet me qindra kilometra në çdo drejtim. Aty kishte barë të gjelbër, lule shumëngjyrëshe, pemë hijelëshuese dhe çdo lloj peme tjetër frytdhënëse që ishte e mirë për t'u ngrënë. Një lumë rridhte përmes këtij kopshti që ujiste barin, lulet, pemët. Në mes të kopshtit Perëndia vendosi dy pemë të veçanta. Njëra ishte

“Pema e Jetës” dhe tjetra ishte “Pema që jep njohuri rreth të mirës dhe të keqes”. Askush nuk e di me saktësi se si dukeshin këto pemë. Ne dimë vetëm se ishin shumë të bukura. Kopshti i Edemit ishte një Parajsë e vërtetë, por në realitet ai nuk ishe Parajsa, ai vetëm mund t’i gjasonte Parajsës...

- Edhe Parajsa e vërtetë ka një përshkrim krejtësisht të njëjtë. A nuk është kështu mixha Dilë?

- Parajsa është vendqëndrim i përhershëm hyjnor i shpirtit. Shpirti këtu është pa trupin fizik; trupi i rikëthehet prejardhjes së vet strukturale të ndërtimit - tokës, dheut, baltës. E kupton? Trupi burimit të vet, shpirti atij të vetit. Trupi tokës, shprti frymës së Zotit dhe niveleve hyjnore. Sipas besimeve monoteiste, qoftë myslimane apo të krishtera, si religjionet tona më të përhapura, pas vdekjes, shpirti kthehet në përjetësi dhe në bazë të meritave të veta nga realteti objektiv, merr shpërblimin e duhur: Parajsën - për veprat e veta të mira, ose Ferrin - për vepra të këqija dhe mëkatet e bëra. Shpërblimi për veprat e mira, do të jetë lumturia e përhershme, pa vuajtje; kurse ferri, si diçka e kundërt. Ka disa religjione të tjera, që janë edhe më të vjetra sesa Islami dhe Krishterimi, dhe besojnë në reinkarnimin e shpirtit. Këtu paraprin Budizmi.

- Reinkarnimi... Çka do të thotë kjo?!

- Besimi se pas vdekjes dhe shkatërrimit të trupit fizik, shpirti vazhdon të ekzistojë si cikël, duke kaluar prej një trupi në trupin tjetër, gjersa nuk pastrohet, dhe si i evoluar përmbaron misionin e vet në botën materiale

dualistike (trup-shpirt). I pastruar tërësisht, në fund, i kthehet Perëndisë, pjesë e të cilit është në realitet. Ky besim ka mbështetje në njëfarë logjike, sepse nëse shpirti është fryma e Zotit, përmes ligjshmërisë së përsëritjes së vazhdueshme, duhet gjithsesi t'i kthehet burimit të vet. Pra, i rikthehet Perëndisë ashtu siç ka qenë në fillim: frymë e pastër dhe pa mëkate; e njëjtë si fryma kur Zoti i fryu Adamit, pasi e ndërtoi nga dheu. Sipas këtij besimi, disa kthehen shpejt, pas një apo dy jetërash, kurse disa të tjerë pas dënimit të gjatë që të transformohen edhe në shumë jetëra të tjera, gjersa të arrijnë evoluimin e tërësishëm shpirtëror.

Pasi mbaroi këtë mendim, u ndal për pak çaste. Mori frymë thellë dhe duke fiksuar shikimin kah unë m'u drejtua:

- E vëren këtu dallimin?

- Më duket se ka! - E bëra këtë konstatim më tepër sa për të thënë diçka sesa që isha i sigurt në të.

- Ashtu! Ka dallim. Krahasuar me religjionet tjera, më shumë të përhapura, ky dallim në esencë është i vogël, sepse edhe Budizmi e pranon në njëfarë mënyre logjikën e "Ferrit" dhe "Parajsës", "mëkatit" dhe "dënimit", "mirësisë" dhe "shpërblimit". Ferr duhet konsideruar jetën dualistike në realitetin objektiv, si obligim i arritjes së pastërtisë absolute të shpirtit, kurse Parajsë - përfundimin e "bredhjes" së shpirtit nga një trup fizik në tjetrin, për t'u kthyer përfundimisht tek burimi i tij i vërtetë. Edhe pse gjithnjë i përdorim termat: shpirt, mendje dhe trup fizik,

kurrë nuk duhet ta paramendosh këtë tërësi si diçka të ndarë...

Këtu mixha Dilë sërish bëri një pauzë të shkurtër; fërkoi me dy duart fytyrën dhe, duke drejtuar gishtin tregues kah unë, filloi sikur më qortonte:

- Unë e kuptoj kurreshtjen tënde, por nuk duhet ngutur! Patjetër, me kohë, do t'i kesh të qarta të gjitha ... Patjetër!... Të vazhdojmë ne ku mbetëm më parë...

Pasi e vendosi Adamin në Kopshtin e Edemit, Perëndia i dha një punë që të mbillte frytet e tij, duke i thënë: **"UNË TË KAM DHËNË TË GJITHA BIMËT QË KANË FARA DHE TË GJITHA PEMËT QË KANË FRUTA ME FARË NË TO. KËTO BIMË DO TË JENË USHQIMI YT"!**

Gjithnjë kur filiste për fjalët e thëna nga Perëndia ose nga Adami dhe Eva, mixha Dilë shikonte në librin që mbante në dorë dhe atë e bënte me një përkujdesje të madhe, duke lënë përshtypje se s'dëshironte të gabonte në asnjë falë gjatë citimit.

- Më pastaj Perëndia i tha burrit (Sërish, siç e kishte shikimin nga unë, e këtheu në librin që kishte në dorë): **"TI MUND TË HASH NGA ÇDO PEMË E KOPSHTIT, POR S'MUND TË HASH NGA PEMA QË JEP NJOHURI MBI TË MIRËN DHE TË KEQEN. TI DO TË VDESËSH NËSE HA NGA AJO PEMË"!** Pastaj Perëndia i dha Adamit një punë tjetër. I solli para tij çdo kafshë fushe dhe çdo zog qielli dhe i tha Adamit që t'i jepte secilit nga një emër. Adami nuk kishte frikë nga kafshët

dhe ato nuk i frikësoheshin atij. Kafshët erdhën tek Adami, një nga një, dhe ai u dha nga një emër të gjitha kafshëve të buta, të gjithë zogjve në qiell dhe të gjitha kafshëve të egra të pyllit. Megjithëse Adami ishte i rrethuar në Kopshtin e Edemit me kafshë dhe gjëra të tjera shumë të bukura, ai ndjehej i vetmuar. Asnjë kafshë në kopsht nuk ishte në gjendje të fliste me të. Më tej, Adami vuri re se të gjitha kafshët në kopsht ishin çift. Çdo kafsh kishte shokun e tij, kurse Ai nuk kishte shok. Më në fund, Perëndia tha: **"PO SHOH SE NUK QENKA MIRË PËR BURRIN TË JETË VETËM, UNË DO TË BËJË NJË NDIHMËSE QË DO TË JETË TAMAM PËR TY"!** Kështu Perëndia e vuri në gjumë Adamin dhe mori një brinjë nga trupi i tij. Nga kjo brinjë Zoti bëri gruan. Pasi Adami u zgjua, Perëndia ia solli atij gruan që të bëhej bashkëshortja e tij. Kur Adami hapi sytë dhe pa gruan që ia kishte sjellë pranë Perëndia, Ai tha: "**Kjo është një njeri si unë. Kockat e saj vijnë nga kockat e mia. Trupi i saj erdhi nga imi. Unë do ta quaj atë grua, sepse ajo erdhi nga një burrë".** Gruaja u quajt ***"EVA"*** që do të thotë ***"jetë".*** Eva u bë nëna e çdo qenie njerëzore në tokë. Kështu Perëndia i bëri Adamit edhe Evën sipas shembëlltyrës së tij. Ai i bëri ata mashkull dhe femër dhe u dha bekimin e tij. Pastaj, Perëndia u tha:" **BËNI SHUMË FËMIJË DHE PËRHAPUNI NË GJITHË TOKËN. MBUSHENI DHE SUNDOJENI ATË. SUNDONI MBI PESHQIT E DETEVE DHE ZOGJTË E QIELLIT. SUNDONI MBI ÇDO GJË QË LËVIZ NË TOKË!"** Është tejet e

rëndësishme se burri dhe gruaja në atë kohë ishin të zhveshur dhe nuk kishin turp nga njëri-tjetri. Një kohë, e cila nuk definohet se sa ka zgjatur, Adami dhe Eva jetuan së bashku në një harmoni të plotë. Kujdeseshin për kafshët, mbillnin tokën dhe vilnin frutat. Ata gjithnjë ishin të hapët dhe flisnin me Perëndinë pa ndonjë kufizim. Adami dhe Eva ishin shumë të lumtur në kopshtin e tyre, për aq kohë sa ndoqën udhëzimet e Perëndisë. Mbi të gjitha, kënaqësia më e madhe për ta ishte miqësia shumë e afërt me Zotin. Zoti vinte shpesh tek Adami dhe Eva dhe i shoqëronte ata. Perëndia, i padukshëm, fliste me ta dhe i këshillonte për çdo gjë që ata kishin nevoj...

Bëri edhe një pauzë këtu.

- Mbaje në mend këtë pozicion (ndërroi tonin e të folurit , duke i dhënë formën e vërejtjes): PERËNDIA, I PADUKSHËM, ISHTE I AFËRT... FLISTE DHE I KËSHILLONTE ATA ...

Sërish edhe një pauzë, por kësaj here diç më e gjatë.

- ... Por një ditë ndodhi diçka e tmerrshme. Eva qëndronte në mesin e Kopshtit, kur një gjarpër i foli asaj. Ajo, natyrisht, u habit sesi mund të fliste një qenie shtazore, kur diçka e këtillë nuk kishte ndodhur gjer më tani në Kopshtin e Edemit....

Sa më shumë thellohej në temë, fjalët e mixhës Dilë, edhe ashtu përnga efekti sugjestive, filluan të pasuroheshin edhe me një karakteristikë që nuk e kishin më parë: Gjestikulonte, shprehej edhe me mimikë e pantomimë, duke lënë përshtypjen se para vetes shihje një artist të madh

në interpretim të shkëlqyer të një monodrame. Ishte në trans të vërtetë, sakaq unë isha shtanguar si statuja duke dëgjuar fjalët hipnotizuese të tij.

- ...Në realitet, - vazhdoi më tej - gjarpri nuk kishte ndonjë forcë të jashtëzakonshme, por Satana, princi i djajve dhe armiku i Perëndisë, po fliste nëpërmjet tij . Satana tha: "Grua, me të vërtetë të ka thënë Perëndia se nuk duhet të hash nga asnjë pemë e Kopshtit?" Gruaja iu përgjigj: "Jo! Perëndia nuk ka thënë kështu. Ne mund të hamë të gjithë frutat që duam. Është vetëm një pemë nga e cila nuk duhet të hamë. Perëndia na ka thënë: "Nuk duhet të hani vetëm nga një pemë që gjendet në mes të kopshtit. Ju nuk duhet as ta prekni at pemë, përndryshe do të vdisni". Pastaj satana filloi ta bindë gruan: "Nuk do të vdesësh. Perëndia e di se nëse ha nga fruti i asaj peme, ti do të mësosh për të mirën dhe të keqen dhe do të bëhesh njësoj me Perëndinë". Kjo e ngacmoi dyshimin e Evës dhe ajo i besoi gënjeshtrës së Satanës. Ajo kundroi pemën që ishte shumë e bukur, dhe lakmia për të qenë e mençur si Zoti si dhe bukuria e vetë pemës dhe frutave të saj e joshën atë. Këputi frutin nga pema e ndaluar dhe e hëngri. E, meqë ishte afër saj edhe Adami, edhe ai hëngri një copë nga kjo pemë. Sapo Adami dhe Eva e gëlltitën pemën, ata ndryshuan menjëherë. Dukej sikur sytë e tyre u hapën dhe ata filluan t'i shihnin gjërat ndryshe. Filluan të kishin turp, sepse kuptuan se ishin plotësisht të zhveshur. Për herë të parë ata ndjenin turp se ishin lakuriq, andaj lidhën gjethe fiku së bashku dhe i veshën ato si të ishin rroba. Gjatë ditës Perëndia erdhi në

Kopsht për të vizituar Adamin dhe Evën. Kur dëgjuan hapat e Tij, ata u përpoqën të fshihen nëpër pemët e kopshtit. Nuk donin të shihnin Perëndinë, sepse ndiheshin fajtorë dhe të turpëruar. Por Ai e thiri njeriun: "**KU JE?".** Adami u përgjigj: "Dëgjova hapat tuaj në kopsht dhe u frikësova. Isha lakuriq dhe kështu u fsheha. Po Perëndia i tha: "**KUSH TË THA SE JE LAKURIQ? A MOS KE NGRËNË NGA FRUTAT E PEMËS SË NDALUAR? UNË TË KAM URDHËRUAR TË MOS HASH NGA AJO PEMË!".** Në vend se ta pranojë gabimin, Adami fajësoi gruan e tij dhe tha: "Ajo i ka fajet. Ajo më dha frutin e pemës dhe unë e hënga atë". Perëndia iu këthye gruas dhe i tha: **"ÇFARË KE BËRË?"** Në vend se ta pranonte gabimin, gruaja fajësoi gjarprin: "Gjarpëri më gënjeu. Ai më mashtroi dhe unë e hëngra frutin". Pastaj, Perëndia i tha gjarpërit: " **TI KE BËRË NJË GJË SHUMË TË KEQE, TANI GJËRAT E KËQIJA DO TË TË NDODHIN TY. QOFSH I MALLKUAR NË MESIN E GJITHË KAFSHËVE DHE GJITHË BISHAVE TË PLLIT! TI DO TË ECËSH MBI BARKUN TËND DHE DO TË HASH PLUHUR GJITHË DITËT E JETËS SATE..."** Dhe më pastaj i tha gruas: **" DËSHIRAT E TUA DO TË DREJTOHEN NDAJ BURRIT TËND DHE AI DO TË SUNDOJË ME TY". Pastaj i tha Adamit: "MEQENËSE DËGJOVE ZËRIN E GRUAS SATE DHE HËNGRE NGA PEMA PËR TË CILËN TË KISHA URDHËRUAR TË MOS HASH, TOKA DO TË JETË E MALLKUAR PËR SHKAKUN TËND. TI**

DO TË HASH FRUTAT E SAJ ME MUND TËRË DITËT E JETËS SATE. AJO DO TË PRODHOJË GJEMBA DHE BIMË GJEMBORE DHE TI DO TË HASH BARIN E FUSHAVE ...” e kështu me rradhë.

Duke i shqiptuar ndëshkimet e Perëndisë, mixha Dilë shtrëngoi fort, me të dy duart, librin që kishte pranë, duke më asocuar në gjyqtarin autoritativ që para tribunalit të drejtësisë i shqipton të akuzuarit dënimin e merituar.

- Kjo, përgjithësisht, ishte një përshkrim biblik, gjegjësisht religjioz i krijimit të Universit, i gjallesave të tij si dhe i qenies më të përsosur - njeriut.

Pasi mbaroi shpjegimin, mbylli librin që kishte pranë dhe largoi atë anash. Këtë gjest e kuptova sikur ky mjet nuk do të na nevojitej më.

Derisa mbyllte librin, para vetes, në qetësinë e kësaj pauze, e shikova vjedhurazi dhe vërejta se ai kishte një energji të madhe. Nuk jepte kurrfarë shenja të lodhjes. Unë, në anën tjetër ndjeja njëfarë plogështie; një rraskapitje që sigurisht vinte nga përqëndrimi këmbëngulës në të kuptuarit e ligjëratës tejet interesante.

Pasi mora frymë thellë, desha t’ia bëja me dije se tërë kohën e përcillja me vëmendje, andaj edhe bëra një konstatim që aty për aty më ra ndër mend vetvetiu:

- Derisa me vëmendje të dëgjoja sa ishe duke folur, m’u kujtuan fjalët që m’i the gjatë takimit tonë të parë. Ato në mua kanë lënë mbresë të thellë:

“Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëdija e zjarrit të madh të Perëndisë që digjet pandërprerë dhe quhet jetë…”

- Po, pra! - vazhdoi sërish mixha Dilë dhe linte përshtypjen se ende ishte i disponuar për bisedë. - Të gjithë ne jemi realiteti i kësaj bote dhe shkëndija të zjarrit të madh të Perëndisë që digjet pandërprerë dhe quhet jetë. Zoti është në ne dhe askund tjetër, edhe pse shpesh jemi mësuar që atë ta kërkojmë larg e më larg, diku në qiell e ku ta di se ku tjetër. Nëse ne jemi shkëndija të dritës hyjnore, atëherë jemi edhe pjesë e përsosshmërisë dhe inteiligjencës së paskajshme universale. A nuk mjafton kjo të besosh se je ai që je? Se ke lindur jorastësisht në këtë botë dhe se je pjesë e procesit të transformimit të pandërprerë shpirtëror, i cila quhet jetë? E beson tani se je pjesë e Zotit?

- PO.

- PO! Dhe s'ka dyshim. Po më thuaj, e urren Zoti pjesën e vet?

- Natyrisht se jo.

- Kurrsesi, - brohoriti; - Ti si qenie e përsosur ke privilegjin të mendosh dhe të zgjedhësh vetë realitetin tënd - në mes vuajtjes, që vetë e krijojn, dhe lumturisë e cila është qëllimi themelor i jetës dhe ekzistencës si proces në vazhdimësi. Andaj, gjithnjë duhet ta mbash në mend: *"Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndija e zjarrit të madh të Perëndisë që digjet pandërprerë dhe quhet jetë…"*

- Kur m'i thoje këto në fillim, unë mendoja se flet me shabllone religjioze, por tani…

- Plotësisht kishe të drejtë, sepse është ashtu. Unë edhe flisja me shabllone religjioze. Por, tani e tutje ti do

t'i kesh të qarta analogjitë e këtyre shablloneve dhe urtësinë e vërtetë hyjnore që ato kanë.

U bëra kurreshtar.

- Kur do të vjen ajo kohë që unë t'i kuptoj këto gjëra, sepse, edhe përpos porosisë së tyre metaforike, që e kam të qartë, si do të dukej ky shpjegim me kuptim më të nivelizuar të mendjes sonë bashkëkohore, ose shkencore racionale?

Edhe pse e kisha shumë seriozisht, e kuptova menjëherë, se duke dashur të tregohesha sa më elokuent në shprehitë e mia, pak e komplikova. Mixha Dilë e kishte kuptuar qëllimin tim dhe menjëherë ndërhyri:

- Mendon në sqarimin tonë më të vetëdijesur të të kuptuarit? - tha kështu, por mua m'u duk sikur ai në këtë pyetje deshi me qëllim t'i lagohej përdorimit të termit "nivel shkencor".

- Po; - konstatova.

- Tani; tani dhe shpejt; - tha duke bërë me dorë si shenjë që të tregoja pak durim. - Nëse merret cilado vepër religjioze, do të shohim një përgjithësueshmëri kuptimore me mjaft metafora, prandaj nga masat ato konsiderohen si të pranueshme për një periodë afatgjate. Në çdo kohë dhe hapësirë, për çfarëdo realiteti të krijuar, dhe atij që pritet të krijohet, nëpërmjet librave të shejta, përherë gjendet interpretimi i aplikueshëm. Mu për
këtë, në vetëdijen kolektive të një shoqërie, ato mbeten si të pavdekshme dhe madhore. Gjatë debateve tona të ardhshme, shpeshherë do t'u kthehemi sërish këtyre

pozicioneve, duke bërë krahasime përmbajtësore me realitetin e momentit konkret... Por, ne të vazhdojmë më tutje...

Sërish u kthy në citatin e fillimit:

- Çdo gjë në fillim ishte asgjë, energji e pashfaqur. Çdo gjë ishte diç që frymonte pa frymë, harmoni e përsosur e veprimit, që, me gjuhën tonë kuptimore, do ta definonim si inteligjencë e paskajshme, frymë hyjnore, ose, edhe më konkretisht: munda ta quajmë: **ZOT.** Kjo energji, vetë, në heshtje, do të ishte mosveprim. E çdo mosveprim ka të bëjë me palëvizshmëri, pra joekzistencë, prandaj, forca e lëvizjes së përhershme në vetë energjinë është skema programore e veprimit, ose informata e veprimit e cila ka të bëjë me nivele hyjnore. Aktualisht, kemi lëvizjen si ekzistencë, ndërsa vetë qëllimi i ekzistencës është transformimi i vazhdueshëm kah strukturat e reja. Këtu kemi të bëjmë me një ligjshmëri themelore të Universit e cila është baza e çdo evolucioni që quhet Ligji i të kundërtave.

Niveli i elokuencës dhe natyra e terminologjisë komunikuese që filloi të përdorte mixha Dilë, ishin paralajmërim se ishim duke hyrë në fazën më të lartë të abstraksionit tematik, andaj, mendova në vete: “Vëmendja dhe koncentrimi im duhet të jenë edhe më të shprehura se gjer tani”. Nuk do të kisha dashur asgjë të më kalojë pa u rrënjosur thellë në kokën time, prandaj e kurajova veten: “Duhet ta shfrytëzosh maksimalisht mësuesin tënd tejet të aftë që ke para vetes!”

Që nga ditët e shkollës, gjithnjë kuptimet boshe të filozofisë i kisha inat, por realisht në vete lakmoja që t'i kisha sa më të qarta, sepse përherë mendoja se prirja për manipulim me abstraksione krijon imazhin e vërtetë të një intelektuali të mirëfilltë. Moskuptimi i tyre fshehurazi e komplekson shumicën edhe nga radhët e intelektualëve. Tek unë s'kishte dyshim: Gjithnjë e pranoja se isha i "topitur" sa i përket kësaj shkathtësie. Megjithatë, ja, që tani edhe vetë fillova të hyja në këto ujëra, ndaj më duhet ta shfrytëzoj sa më racionalisht këtë shans.

- Si krijohen strukturat e reja?- pyeta.

- *Strukturat e reja krijohen me veprimin e* ***Ligjit të të kundërtave*** *në të cilin energjia në lëvizje tenton të jetë në qetësi, nga njëra anë, dhe forca nxitëse që të jetë përherë në lëvizje, nga ana tjetër. Nga këto dy të kundërta lirohet nxehtësia e cila shkaton gjendjen e re të* ***koncentrimit****, gjegjësisht të integrimit si proces në lëvizje të përhershme.* ***Koncentrimi*** *si produkt më i avancuar i integrimit, krijon edhe informatën më të avancuar e cila koordinon procesin tanimë më të përsosur të organizimit. E tërë kjo etapë vepron si një vazhdimësi e përhershme.*

- A mundesh këtë Ligj të ma sqarosh në një mënyrë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme?

- Ligji - bazë i themelimit të Universit dhe i tërë gjithësisë si realitet objektiv është Ligji i të kundërtave. Ky Ligj mbështetet në veprimin edhe të dy nënligjeve të tjera, të cilët ndikojnë në funksionimin e vetë Ligjit të të kundërtave. Këto dy nënligje janë:

1. Ligji i ruajtjes së formës ose i përhershmërisë dhe

2. Ligji i lëvizjes së përhershme.

Ligji i ruajtjes së formës si apsolute, tenton ta mbajë këtë gjendje gjithnjë ashtu sikurse është, kurse Ligji i lëvizjes së përhershme vepron në ndryshimin e kësaj gjendjeje që të jetë përherë në lëvizje. Çka kemi tani?

- Veprimin e Ligjit të të kundërtave? - u nguta ta them këtë konstatim.

- Ashtu. I tërë fillimi që dukej si tërësi absolute shndërrohet në relative, sepse nën ndikimin e Ligjit të përhershëm të lëvizjes nuk ka gjendje të përhershme të qetësisë dhe anasjelltas: pa ekzistimin e tendecës së ruajtjes së qetësisë së përhershme, nuk do të kishte as veprim për nxitjen në livizje të përhershme.

- A mund të ma konkretizosh këtë raport me ndonjë shembull më konkret? - pyeta nga mossiguria në të kuptuarit qartë dhe sa duhet.

Nuk u përgjigj menjëherë në këtë pyetje, por mori një fletore nga tufa e librave të vendosur në qoshen e tavolinës. E hapi me kujdes fletën dhe, me lapsin që nxori nga xhepi, u përgatit ta konkretizonte edhe me shkrim.

- T'ia nisim nga fillimi i fillimit të çdo gjëje. Nga asgjësia në diçësi. Këtu duhet të kesh kujdes dhe vëmendje më të përqëndruar: Në fillim ishte qetësia si gjendje abstrakte. Qetësia është heshtje, që do të thotë pajetësi. Kjo gjendje tenton ta rujë ekzistimin, ashtu sikurse është **.** Kemi veprimin e Ligjit të ruajtjes së formës ose Ligjin e

përherësisë. Nëse tani me Ligjin e lëvizjes së përhershme veprojmë në qetësi, atëherë nuk kemi asnjë gjendje të mëparshme, por nxehtësinë ose ndryshe energjinë. Nga dy veprime të kundërta krijohet energjia si gjendje e re…

Pasi sqaroi këtë ekuacion, të njëjtën e shënoi edhe në fletën e bardhë të fletores:

Qetsi (vdes) + Lëvizje (vdes) = energji. Gjatë shfaqjes së energjisë, gjendja e mëparshme e qetësisë dhe gjendja e lëvizjes së përhershme nuk ekzistojnë. Ato vdesin.

- Nuk kuptoj: Si vdesin? - pyeta.

- Vdesin, sepse qetësia ishte absolute dhe ashtu tentonte të mbetej. Kur veprohet me Ligjin e lëvizjes së përhershme, ajo më nuk ësht absolute, por: **ENERGJIA + INFORMATA (inteligjenca e veprimit të Ligjit të të kundërtave).**

- E më tej?

- Më tej është energjia, si produkt i avancuar, e cila në vete sërish ruan tendencën të jetë e pandryshueshme dhe ta ruajë atë gjendje sipa Ligjit të parë të trashëguar, **si plus,** dhe veprimi i Ligjit të dytë të trashëguar si lëvizje e përhershme, **minus.** Nga fërkimi i veprimit të trashëguar të informatës së Ligjit të të kundërtave, nga energjia ekzistuese krijohet sërish produkti ri, edhe më i avancuar…

Edhe këtë ekuacion e shënoi në fletore:

(ENERGJIA + INFORMATA, si Plus) + (ENERGJIA + INFORMATA, si minus) = PRODUKTI I RI I AVANCUAR që shkon kah tendenca e përsosjes së mëtejme me metodën e njëjtë, e cila quhet KONCENTRIMI, ku do të lirohet NXEHTËSIA.

Gjatë shkatërrimit të së vjetrës dhe krijimit të së resë, gjithmonë shfaqet nxehtësia. Koncentrimi është tërësia e fazave në zhvillim e sipër. Me koncentrimin si energji kemi edhe KONCENTRIMIN E INFORMATËS. Koncentrimi i informatës është mendje e avancuar e cila shkon kah e përsosura dhe quhet ORGANIZIM. E tërë etapa e këtij transformimi kalon nëpër katër faza themelore, të cilat ne, tash e tutje, do t'i quajmë katër fazat magjike të zhvillimit, për të shkuar sërish me katër faza në vashdimësi më e relative. Në anën tjetër, lëvizja nuk do të ishte si lëvizje, po qe se nuk do të ekzistonte palëvizshmëria. Andaj, të dy gjendjet e mëparshme nuk ekzistojnë më dhe vdesin duke krijuar energjinë si fërkim në mes të dy këtyre të kundërtave. Kur të vdesin gjendjet e mëparshme, produkti i ri i krijuar si energji tani ka kujtesën e dy ligjshmërive të veprimit të mëparshën: Pra, të ruajtjes së përhershme të formës së mëparshme dhe, në anën tjetër, të ruajtjes së lëvizjes së përhershme. Kjo kujtesë, e cila trashëgohet në produktin e ri, quhet mendje, inteligjencë ose INFORMATË…

Të gjitha këto i skicoi në fletore kështu:

<u>Qetësi (vdes) + Lëvizje (vdes) = energjia, si produt i ri dhe më i avancuar, e cila ka INFORMATËN e trashëguar nga dy të kundërtat.</u>

Pra, - vazdhoi, - si produkt të ri kemi **energjinë** dhe **informatën** si kujtesë për ta bartur procesin e mëtejmë të transformimit…

Sërish këto i skicoi në fletore:

përsosur …e kështu m erradhë… ja shembulli se si do të duken këto faza - Tani në fletoren që e kishte para vetes dhe para meje, hapi një faqe të pastër dhe shënoi:

1. AJRI - veprimi i Ligjit të të kundërtave
2. ZJARRI- reagimi i veprimit të Ligjit të të kundërtave
3. UJI - faza e koncentrimit ose e bymimit dhe
4. TOKA - produkti i ri i avancuar.

Këto themi se janë katër fazat sipas transformimit racional, gjegjësisht materialist, ndërsa transformimi në katër faza sipas kuptimi iracional, ose shpirtëror, do të dukej kësisoji:

1. INFORMATA - ideja, apo mendja statike e procedurës së veprimit të Ligjit të kundërtave
2. DRITA - projektimi i veprimit të Ligjit të të kundërtave
3. ORGANIZIMI - mendja më e lartë kolektive e cila më tej trasformohet …
4. INTELIGJENCA - produkti i ri i avancuar

- Nxehtësia sikur paraqitet si përcjellëse e kalimit nëpër të gjitha fazat e zhvillimit?

- Jo në të gjitha; më e saktë është vetëm në momentin e fërkimit, gjegjësisht të rezistencës ku ndryshohet gjendja e mëparshme përms lëvizjes. Nxehtësia gjithmonë është katalizator dhe nxitës i të gjitha transformimeve dhe shndërrimeve në natyrë. Merre p.sh. hekurin. Ai që të jetë në këtë gjendje të tanishme, ka kaluar fazat e zhvillimit të vet dhe është koncentruar si i ngurtë. Gjendja e tij agregate i ndyrshohet përms veprimit të nxehtësisë, gjegjësisht përmes shkrirjes. Hekuri i shkrirë, ta zëmë, tashmë ka ndërruar gjendjen dhe është i lëngët. Nxehtësia, e cila është në të gjitha proceset e transformimit, figurativisht mund të konsiderohet **si rezistencë gjatë vdekjes dhe rikrijimit të produktit të ri të avancuar**. Gjithnjë kur veprojmë sërish me nxehtësi, ajo transformon materien nga një gjendje në një gjendje tjetër, por në asnjë mënyrë nuk e humb atë. Masa, sipas ligjeve të fizikës, nuk humbet, por vetëm transformohet.

- Mirë, mixha Dilë, tani shumë mirë e kamë të qartë nxehtësinë, po ç'është drita? Edhe kjo a s'është pjesë e realitetit tonë objektiv?

- Saktë; edhe drita është realitet yni objektiv. Atë tani mund ta kuptosh shumë thesht. Sikur e vërejte edhe më lart, drita është projektim i vetë fazës së nxehtësisë në nivelin e kapshëm për shqisat tona. Është faza e dytë e informatës ose inteligjencës në transformim. Pra fazë e dytë e kuptimit shpirtëror. Drita, nëse zbërthehet në grimca, është valë elektromagnetike. Edhe mendimet tona, po ashtu, janë valë elektromagnetike; dhe ato shndrisin, gjegjësisht

reflektojnë. Normalisht, mendimet në planin material thuhen me gojë, shprehen me shkrim apo vizatim. Por, ato nëse nuk manifestohen në këtë formë, nuk zhduken dot; ato mbeten të regjistruara si valë elektromagnetike, duke iu nënshtruar fazave të tjera të materializimit të tyre. Njëjtë, sikurse trupi që është projektim i shpirtit tënd, ashtu edhe drita është projektim i nxehtësisë. Në natyrë përherë ndodh transformimi me veprim të Ligjit të të kundërtave dhe përherë gjatë transformimit shfaqet nxehtësia. Ajo nuk ndihet gjersa të arrijë në nivelin e kapshmërisë së shqisave tuaja. DRITËN duhet ta kuptosh si projektim të nxehtësisë e cila lirohet gjatë proceseve transformuese që ndodhin në realitetin objektiv. Ajo njëkohësisht ndihmon ta vëresh materien. DRITA nuk është vetëm projeksion, por ajo ndihmon edhe projeksionin e materies gjatë fazës së transformimit në shqisat tuaja si senzacion. Pa veprimin e dritës dhe reflektimin e saj nga objekti, nuk mund ta regjistrosh me shqisën e të pamurit se ekziston ai objekt. Kështu e ke edhe fotografinë. Projeksioni i objektit në shtresën e celuloidit të filmit është vetëm gjurmë e reflektuar e vetë dritës nga sendi.

- Mirë, mixha Dilë. Zbatoje tani koncentrimin e njohurisë, si fazë, edhe në mendjen time; ha, ha, ha, ha… - Bëra mahi me këtë çështje, por dhe qëllimisht veprova kështu, që t'i bëja me dije bashkëbiseduesit tim se jam duke e përcjellë me vëmendje dhe i kam të qarta shumë gjëra nga ligjërimi i tij. Vzhdova:

- Thjesht, një definicion: Nxehtësia dhe drita - ç'janë këto?

- Nxehtësia është energji që lirohet gjatë veprimit të Ligjit të të kundërtave, si reagim i fazave të veprimit të ligjshmërisë, ndërmjet tendencës për ruajtjen e përhershme të formës dhe lëvizjes së përhershme si vazhdimësi. Drita është projektim i kësaj **ndjenje** të caktuar në shkallën e kapshmërisë së shqisave tuaja. Më konkretisht, shqisës së të pamurit.

- Njëjtë është atëherë edhe me zërin?

- Ashtu, pra, gjeniu im! E njëjta është edhe me zërin. Zëri është niveli i zhurmës që shkaktohet gjatë veprimit të fazave përmes ndikimit të Ligjit të të kundërtave, e cila mundëson regjistrimin e kësaj **ndjenje** nga shqisa tjetër, pra, nga ajo e të dëgjuarit, në fazën e nivelit të kapshmërisë materiale. E kupton? Tani kemi nxehtësinë, e cila regjistrohet nga shqisa e të **prekurit**; projektimin e saj si dritë nga shqisa e të **pamurit**; zhurmës nga shqisa e të **dëgjuarit…** Të gjitha këto fenomene mundësojnë që gjatë vetëdisimit për realitetin objektiv, i cili regjistrohet përmes vrojtimit, të bëjmë dallimin e **vetive** të shumë substancave si materiet më të avacuara të realitetit tonë objektiv?

- Vetitë?... Sikur edhe diçka doli e re në të kuptuarit tim?

- Po, pra, vetitë e materies, gjegjësisht të substancave, që janë pesë: gjendja agregata, ngjyra, era dhe shija… ke pesë veti të materies. Ke meduar ndonjëherë pse pesë?

Nuk kisha përgjigje.

- Jo, nuk di.

- Sepse ne kemi pesë shqisat tona që mund të regjistrojnë këto veti. Në Univers ka edhe shumë e shumë veti të tjera, por ato nuk mund të regjistrohen me shqisat tona, veçse me mendje dhe inteligjencë.

- A nuk i regjistron inteligjenca, gjegjësisht mendja edhe rezultatet e arritura si ngacmime nga pesë shqisat tona?

- Po, i regjistron, por ne kemi dy mendje. Mendjen e vetëdijshme dhe të pavetëdijshmen. Ngacmimet në shqisat tona i regjistron vetëm mendja e vetëdijshme, kurse ajo e nënvetëdijshme kap edhe shumë veti tjera të materiies në të gjitha fazat e saj të transformimit. Nëse ndonjë veti nuk është regjistruar nga shqisat tona racionale, të vetëdijshme, nuk do të thotë se nuk ekziston. Ajo patjetër është regjistruar nga shqisat tona irracionale, gjegjësisht të ndërvetëdijshme.

- Mixha Dilë, desha të kem të qartë edhe diçka tek Ligji i të kundërtave: Ku është këtu hyjnorja? Ku është Zoti?

- Këtu edhe të prita. Tani jemi në fundin e një fillimi. Për të veprur gjithnjë një ligj atëherë ai duhet të ketë edhe mekanizmat e zbatimit të tij. Ky mekanizëm është **informata,** e cila gjithnë gjatë fazave të veprimt, bart njohurinë për vetë fazat në veprim. Më konkretisht, informata është mendja ose inteligjenca e vetë veprimit. Sikurse për fazat e veprimit që kemi koncentrimin si

integrim, po ashtu edhe për informatën kemi **organizimin** kah e përsosura në avancim**.**

- Fillova t'a kem të qartë: - konstatova plotësisht i sigurt në vete; - hyjnore është vetë informata apo mendja e veprimit të të gjitha këtyre fazave.

- Ashtu është. Të lumtë djalosh! Tani je në thelbin e proplemit… Informata është Zoti i cili është prezent që nga fillimi i krijimit të veprimit të të gjitha ligjshmërive të strukturave që përsosen gjithnjë si vazhdimësi e përhershme. Prandaj, me të drejtë themi se Zoti është kudo: në atom, materie, substancë, strukturë… kudo. **Gjithnjë si pikënisje e krijimit të realitetit tonë objektiv duhet ta marrësht energjinë dhe informatën e veprimit në të. Lulja, ylberi, shtazët dhe njeriu në këtë realitet objektiv, të zbërthyera në përbërësit e vet themelorë, në realitet, janë energji dhe informatë. Tër Universi në natyrën e vet esenciale, në realitet, është lëvizje e energjisë dhe e informatës.** I vetmi dallim në mes teje dhe drurit është përbërja dhe përmbajtja e energjisë dhe informatës në trupin tënd. Në nivel të materies, edhe ti, edhe druri, jeni të përbërë prej elementeve të njëjta, që më parë ishin të ndërtuara në diçka tjetër. Fjala është për karbonin, hidrogjenin, oksigjenin dhe azotin në masë të madhe, si dhe për elementet tjera, në sasira më të vogëla. Të gjitha këto elemente mund t'i blejmë me para në barnatore. **Pra, dallimi në mes teje dhe drurit nuk i referohet karbonit, hidrogjenit dhe oksigjenit. Ti me drurin, bile, vazhdimisht e këmbeni reciprokisht**

karbonin dhe oksigjenin. Dallimi qenësor i referohet energjisë dhe informatives. Tani qetësohu pak dhe analizoji edhe një herë, pa shikuar në vizatim, të gjitha këto faza, të cila duhet t'i rrënjosësh thellë në bindjet tuaja si një nga mënyrat e reja të të menduarit dhe vepruarit në çfarëdo segmenti të jetës sate.

Gjersa mixha Dilë u ngrit nga karrigia dhe doli jashtë, duke më lënë vetëm në qetësi, unë mbylla sytë dhe fillova të meditoj për rrejdhën e të gjitha këtyre fazave. Mosprezenca e tij bëri që edhe më tepër të koncendrohesha në thelbin e të kuptuarit të kësaj ligjshmërie. Sa më shumë e logjikoja këtë dukuri, aq më shumë ndjeja një kënaqësi.

Më në fund u binda se në shumicën e rasteve format abstrakte gabimisht mendohet se janë të pakapshme. Vetëm duhet të ekzistojë interesimi i cili angazhon vëmendjen, vëmendja intelektin dhe, së fundi, intelekti kap njohurinë. Ja pra: interesimi, vëmendja, intelekti dhe njohuria. Sërish ligjshmëria e të kundërtave dhe katër fazat e veprimit. Domethënë, kjo ligjshmëri është çdo kund, në çdo hap të jetës dhe ekzistencës.

Ndërkohë, mixha Dilë sërish hyri në dhomë dhe u ulë në karrigen e vet, pranë tavolinës së punës, duke prishur qetësinë që mbretëronte gjer në at kohë sa ishte jashtë, dhe sikur i kishte rënë ndërmend diçka:

- Të marrim shembull atomin, i cili ka bërthamën si pozitive dhe elektronet që sillen rreth saj, si negative. Informata statike e atomit është që bërthama të jetë në heshtje , kurse elektroni në lëvizje. Nga këto të kundërta, si

strukturë, kemi atomin. Duke ekzistuar gjithnjë, atomi gjatë lëvizjes së përhershme shkakton koncentrimin, i cili përmes organizimit krijon strukturën e re: molekulën. Në molekulë, tani, si strukturë më e avancuar, kemi edhe informatën unike më të avancur. Informata e një atomi me koncentrim ka organizuar informatën më të përsosur të molekulës, molekulat gjithnjë me procedurë të njëjtë vazhdojnë të koncentrohen duke organizuar kështu materijen në nivel edhe më të lartë... e kështu me rradhë. Nëse do ta kishim vetëm bërthamën, atëherë nuk do të kishte lëvizje, që do të thotë as jetë; nëse do ta kishim vetëm elektronin, nuk do të ekzistonte e kundërta e tij...

- Me sa kuptoj, atomi është vetëm një strukturë individuale në avancim, nga e cila krijohen strukturat e reja.

- Ashtu është; - pohoi me kokë mixha Dilë, duke qenë i kënaqur që unë e përcillja me koncentrim dhe vëmendje të lartë.

- Llojet e materieve janë vetëm nivelet e avancimeve në vazhdimësi. Përsosshmëri do të thotë të kesh në vete elementet e të gjitha strukturave dhe informatën gjenerale të strukturës në momentin e arritjes së asaj përsosshmërie. Informata gjenerale e strukturës së përsosur është koncentrim i informatave gjatë transformimit të përhershëm, i cili lidhet me informatën-bazë të tendencës fillestare për lëvizje. Këtë informatë, pra, e quajtëm si inteligjencë të paskajshme, hyjni, Zot etj. Transformimi është proces i cili mbështet ligjshmërinë e përherësisë kah

e avancuara. Pra, gjithnë kemi gjendjen e relativitetit si absolute dhe absoluten si gjithnjë relative. Edhe informata, e cila për fillim na duket absolute, në realitet është relative, sepse gjatë avancimit në strukturat e reja, edhe ajo i adaptohet rrjedhojës kah e përsosura.

- Tani e kam të qartë, plotësisht të qartë. Nëse materia zbërthehet vazhdimisht në grimca edhe më të imta, atëherë do të kemi si pikënisje energjinë e cila tenton përherë të jetë në lëvizje duke u përsosur gjithnjë në nivelin më të lartë të organizimit sikurse është materia.

- E saktë. Ashtu siç e ndjejmë me shqisat tona, materia është koncentrim që mund të zbërthehet në fazat e veta të krijimit të mëparshëm. Tek të gjitha strukturat e reja të transformuara, gjithmonë do të kemi katër faza karakteristike, të cilat e ndërtojnë Ligjin hyjnor të të kundërtave dhe veprojnë si vazhdimësi e përhershme.

- Përfundimi del se materia është një energji e kondensuar.

- Shumë bukur! - brohoriti nga gëzimi mixha Dilë. - Kjo njohuri i është prezentuar njerëzimit kaherë, mija vite më parë, por se materia është shkalla më e ulët e shpirtit e se shpirti është shkalla më e lartë e materies, zyrtarisht sot është pranuar edhe nga shkenca jonë bashkëkohore. Ajnshtajni në teorinë e tij të famshme të relativitetit, ka konstatuar se materia mund të kalojë në energji dhe energjia në materie, edhe pse materia nuk është gjë tjetër veçse energji e koncentruar dhe e kondensuar në një vend.

Realisht, shpirti dhe materia janë një. Andaj, çdo materie është shpirt i shprehur përmes formës. Ose trupi është projeksion i shpirtit njëjtë sikurse fotografia jote që është projeksion i pamjes sate.

- Nëse Ligji i të kundërtave zbatohet përmes katër fazave të tij, atëherë pse në Bibël e kemi metaforën e krijimit të botës për shtatë ditë dhe jo për katër, ose pesë.

- Pyetje e qëlluar dhe interesante. Në shtatë ditë të krijimit të botës ekzistojnë të gjitha këto faza, por janë shtuar edhe ditët e krijimit të niveleve më të larta strukturale. Pas katër fazave të krijimit të materies, si fazë e pestë, është krijimi i gjallesave si pëzierje strukturale me një informatë, si inteligjencë apo mendje më të pavarur të vetëkontrollit të veprimit. Pra, një botë e cila është e njëjtë si ajo materiale, por e cila ka shpirtin më të pavarur të vetëveprimit . Në këtë hierarki kemi: botën bimore, atë shtazore dhe njeriun si mbikrijesë e të gjitha krijesave me inteligjencë të pavarur funksionale - funksionim ky që quhet jetë. Andaj, pas katër fazave të krijimit të botës minerale, kemi ditën e pestë, krijimin e bimëve dhe të botës shtazore, si dhe ditën e gjashtë, krijimin e njeriut si rezultat i të gjitha krijimeve në tërësi gjatë pesë fazave të tjera. Pra, makrokozmosin në miniaturë.

- E dita e shtatë? - pyeta.

- Ditën e shtatë është pushimi. Zoti ditën e shtatë pushoi. Pra, atë ditë nuk krijoi asgjë, por u kënaq me të gjitha ato që krioi gjatë gjashtë ditëve të tjera.

- Tanimë, me sa shoh unë, fazat e ligjshërisë sipas kësaj procedure, mund të përdoren jo vetëm për sqarimin e krijimit të vetë materies, por edhe për të gjitha veprimet tjera nga realiteti ynë objektiv...

- Saktë. Për të vërtetuar këtë, mund të marrim shumë shembuj nga praktika jonë e përditshme. Gjithnjë ato do t'i nënshtrohen procedurës së kalimit të patjetërsueshëm përmes katër fazave të zhvillimit, si faza të veprimit të vazhdueshëm të Ligjit të kundërtave. Ja, për shembull, t'i marrim dëshirat tona që i kemi gjatë jetës: Çdo dëshirë në rend të parë lind si ide: **faza e parë;** pastaj, me prezencën e emocionit koncentrohet si dëshirë e flaktë: **faza e dytë;** koncentrimi dhe transformimi kah struktura e re: **faza e tretë**; dhe, në fund, realizimi i idesë si rezultat konkret - materia: **faza e katërt**. Kështu, pra, sipas veprimit të kësaj ligjshmërie në Univers, pas krijimit të strukturave gjithnjë e më të reja dhe nga më të ndryshmet, fillon krijimi i botës materiale, si niveli më i ultë i ekzistencializmit, që ne e quajmë **BOTA MINERALE** .

Sa i përket organizimit struktural të botës minerale, mençuria jonë bashkëkohore ka zhvilluar njohurinë e përgjithshme të quajtur **SHKENCË, e** cila shpjegon saktë ligjshmëritë e përbërjes dhe të funksionimit të këtyre strukturave vetëm si ekzistente, pra vetëm në fazën e katërt ekzistenciale të procesit të transformimit të tyre, e kurrsesi më tej, kah njohuria më e thellë irracionale e fazave tjera të funksionimit. Falë zhvillimit të teknikës dhe pajisjeve precize elektronike, kohën e fundit disa disiplina të kësaj

njohurie, arrijnë të hyjnë edhe më thellë në bërthamën e materies, duke dëshmuar vërtetësitë që urtësia e paraardhësve tanë i ka njohur qindra dhe mijëra vite më parë. Sidoqoftë, kurrë nuk është vonë**.**

U bëra kurreshtar.

- Po si është puna me botën shtazore? Edhe ato janë gjallesa dhe kanë shpirtin e tyre me një inteligjencë të pavarur të nivelit të konsiderueshëm?

- Edhe bota bimore, edhe ajo shtazore, së bashku me njeriun, si qëllim esencial e kanë ndryshimin *e eksterierit* në realitetin tonë objektiv, në drejtim të përsosshmërisë së pandërprerë. Të gjithë së bashku janë pjesë e një tërësie harmonike të procesit të quajtur EVOLUCION. Por, natyrisht se ndërmjet këtyre niveleve strukturale ka dallime. Në hierarkinë e realitetit objektiv, bota bimore në krahasim me atë minerale, është diçka më e përsosur. Është e ndërtuar nga shpirti, me një informatë më të pavarur dhe shumë më inteligjente se bota minerale, e cila kishte vetëm informatën fikse që rregullonte organizimin struktural të saj. Shpirti i strukturave bimore mund të regjistrojë disa ndryshime nga bota e jashtme duke i përjetuar ato si ndjenja në formë të kënaqësisë dhe vuajtjes.

- Bima të kënaqet ose të vuaj?! - u habita me këtë konstatim.

- Deri në kohën e fundit ka qenë e papranueshme ta shprehësh këtë fakt. Por, me zbulimin e instrumenteve precize elektronike, sot është dëshmuar edhe shkencëtarisht ndjeshmëria e bimëve në ngacmimet nga jashtë. Ke dëgjuar

për metodat të reja të kultivimit të agrokulturave të ndryshme bujqësore përmes muzikës. Rendimentet kanë qenë fascinante. Këto sot vetëm vërtetojnë këtë fakt, që shumë urti të civilizimeve të lashta, e kanë konstatuar para qindra e mijëra vjetve.

Desha ta mbaja të përqëndruar në pyetjen time, ku ende nuk e kisha përgjigjen e duhur.

- E patëm fjalën tek niveli i botës shtazore?- Këmbëngula.

- Aty edhe e kam qëllimt të dal. Bota shtazore, në krahasim me nivelet më të ulta strukturale, jo vetëm se ka një ndjeshmëri më të madhe të ngacmimeve nga realiteti i jashtëm objektiv, por ajo, në përmasa më të vogëla, ndikon edhe në evolucionin e këtij realiteti. Në regjistrimin e ngacmimeve, bota bimore është e kufizuar vetëm në rrethin e ngushtë, ku e ka të fiksuar ekzistencën e saj, kurse bota shtazore, mund të lëvizë dhe ta zgjerojë këtë ndikim edhe në hapësirat tjera më të gjera të realitetit objektiv. E tani, sipas një rendi logjik, duhet të sqarojmë kuptimin e dallimit të nivelit të botës shtazore dhe vetë njeriut si krijesë më e përsosur. Ky dallim është i thjeshtë. Bota shtazore dhe, në përgjithësi, të gjitha grupet tjera paralele, kanë vetëm shpirtin e përbashkët kolektiv, kurse njeriu përveç shpirtit kolektiv, ka edhe shpirtin individual. Ka UNIN që është potencial i pastër.

- Po pse Zoti e krijoi njeriun si individualitet? Pse atë e bëri të veprojë dhe të ekzistojë si i pavarur në realitetin objektiv?

- Jo vetëm njeriu, por të gjitha strukturat tjera organizative, si qëllimi të ekzistencës së tyre kanë lëvizjen e pandërprerë kah e përsosura. Pa lëvizje të përhershme nuk ka as ekzistencë. Ndryshimi global i përherësisë kah e përsosura nuk është vetëm ndryshim i brendshëm përmbajtësor, apo edhe struktural, por ndryshim i realitetit objektiv si tërësi edhe nga jashtë. Ndryshimi përmbajtësor apo struktural i realitetit objektiv është proces natyror, dhe kryhet përmes ligjeve precize hyjnore të instaluara në formë të informatës, ndërsa ndryshimi i saj i jashtëm, eksterier, bëhet përmes një qendre të koordinimit në formë të mikrokozmosit që quhet NJERI. Njeriu është, pra, komponenta e inteligjencës së paskajshme e cila ndryshon eksterierin e realitetit objektiv... E vëren tani se të gjitha nivelet e strukturave organizative i shërbejnë njëri-tjetrit, për t'i shërbyer të gjitha së bashku një qëllimi të catuar universal.

- Por njeriu në të shumtën e rasteve është dëmtues dhe shkatërrimtar i këtij eksterieri. Ai shpeshherë vepron larg ligjeve hyjnore?

- Njeriu si krijesë e vetë Zotit ka pavarësinë individuale të nivelit më të afërt me krijuesin e tij. Për të vepruar dhe lëvizur pandërprerë kah e përsosura, ai disponon edhe kurreshtejen dhe dëshirën që të ecën gjithnjë përpara dhe të jetë në ballë. Kurrë nuk kënaqet dhe gjithnjë lyp dhe lakmon diçka. Ai shpeshherë shkon aq larg, saqë dëshiron të krahasohet edhe me vetë krijuesin e vet. Kjo cytje që ne e quajmë instikt, është e natyrshme dhe përnga

liria e veprimit të vet, konsiderohet edhe si privilegj, por, si çdo gjë tjetër nga bota njerëzore, shpeshherë edhe kjo keqpërdorohet. Këtë keqpërdorim në terminologjinë religjioze do ta hasësh të definuar si “xhynah”, “haram” ose thjesht: mëkat. Mëkati në realitet është thyerja e ligjeve të përcaktuara natyrore. Me këtë veprim shprehet dominimi vetëm i një poli të të kundërtave, duke çrregulluar kështu veprimin e ligjshmërisë hyjnore të barazpeshës. Kjo shkakton disharmoni, prishje të rendit dhe çrregullim të rrejdhës normale të “simfonisë hyjnore”. Pra, forca e cila duhej të vepronte në ndryshimin eksterier të realitetit objektiv, dështon duke çrregulluar kështu kahjen e veprimit harmonik, andaj ajo edhe duhet dënuar. Mëkati zakonisht paralajmërohet përmes vërejtjes nga të urtit e një populli, profetët, nëpërmjet shenjave të vogla në formë të dënimeve idividuale si fate njerëzore, si dhe përmes atyre kolektive, siç janë: luftërat, përmbytjet, epidemitë, kataklizmat e ndryshme ... dhe kështu deri te zhdukja totale e cila parathuhet se do të realizohet si shkatërrim masiv i realitetit material. Këtë parathënie shpesh mund ta gjesh të definuar në formë të “apokalipsës” apo “kijametit”. Më konkretisht, nëse nga ana e të ngarkuarit për kryerjen e saj - njeriut, tërë ky proces i transformimit eksterier në realitetin objektiv rrezikohet seriozisht, atëherë edhe procesi i ligjeve tjera natyrore deformohet dhe vjen deri tek asgjësimi total i realitetit material.

- Çka nënkuptohet me asgjësimin total të realitetit material?

- Në fakt, asgjësohen gjallesat dhe njeriu si realitete dualistike shpirt-materie, ose, siç do ta hasësh shpesh në literaturën shpirtërore, si mikrokozmos .Kur të pasojë ky asgjësim, si rezultat i mosveprimit harmonik të ligjeve natyrore, atëherë nuk kemi as realitet objektiv-material.

- Nuk e kam të qartë; të lutem, a mund të ma sqarosh këtë me disa shembuj?

- Po, dhe është shumë e kuptueshme. Nga e di ti se ekziston realiteti objektiv-material? Më thuaj! Nga e di?

- Paj... e përjetoj, e shoh, e preki, e ndjej...

- Plotsisht e saktë! Ti realitetin objektiv e pranon dhe e njeh vetëm përmes pesë shqisave tuaja fizike. Mundohu ta marrësh me mend sikur ke lindur në këtë realitet objektiv pa shqisat tuaja fizike. Nuk sheh, nuk dëgjon, nuk e dallon shijen, nuk ke ndjenja të prekjes ...si mud ta dish se ekziston ky realitet?

- Më duhet të meditoj më gjatë për këtë.

- E nëse njeriu si mikrokozmos, së bashku edhe me gjallesat tjera, asgjësohet në tërësi, kush do ta përjetojë ekzistimin e realitetit objektiv?

- Dale, dale pak! Tani sikur m'i turbullove të tërat; - reagova kështu duke qenë i humbur thellë në mendime dhe me vëmendje të koncentruar që të absorboj sa më qartë çdo fjalë të mixhës Dilë?

- Askush, i dashuri im, askush! Jeta objektive është iluzion që ne e regjistrojmë vetëm përmes shqisave tona dhe atë e ndjejmë ashtu. Bota materiale është eksperienca e shpirtit në dualitetin e tij me trupin, e shprehur përmes

procesit të të menduarit. Prandaj, përherësia është shpirti dhe burimi i tij hyjnor. Ne atë do ta kemi si qëllim të të mësuarit. Atë do ta njohim si vrojtues që përmes mendjes e vrojton vetveten .Vetveten, të ndërtuar nga tre faktorë të realitetit: shpirti, trupi dhe mendja. Filozofinë e krijimit të botës materiale e trajtuam vetëm që ti t'i kuptosh ndikimet e ligjshmërive hyjnore në të dhe ta kesh të qartë se ajo është e kundërta e përjetësisë në shtegtimin e saj kah e përsosura... E tani besoj se do të jesh dakord që ta kryejmë me kaq për sot... - tha dhe filloi t'i mbledhë librat e hapur që i kishte para vetes, duke i paluar ato në skajin e qoshes së djathtë të tavolinës se punës. Nxori me të shpejtë një notes nga xhepi i prapëm i pantolloneve dhe filloi të shënojë diçka në të. Për pak çaste mbretëroi një heshtje. Pasi mbaroi shkrimin, mbylli furishëm faqet e hapura të notesit.

Më kishte lexuar mendimet.

- Si duket ke edhe diçka tjetër të thuash? - e kishte vërejtur qëllimin tim.

- Më fal, mixha Dilë - iu drejtova me lutje... Do ta marr kohën edhe pak, por jam i padurueshëm të di kuptimin e vërtetë të ritualit me qirinj në tyrbe... mallkimin e madh... Kjo sikur nuk më hyn në kokë... nuk përputhet me...

- Ha, ha, ha... - qeshi me zë; - ke filluar të mësosh shumë shpejt, djalosh. Shumë shpejt dhe para kohe, andaj edhe pse parashikoja që për këto të bisedonim dikur më vonë, do të tregoj që tani troç: E tëra me Tyrben

dhe qirinjtë e ndezur nuk do të thotë asgjë. E kupton? Asgjë! Vetëm ritual i kotë. Unë e kam ditur se ti je një person me edukatë patriarkale dhe religjioze, andaj isha i sigurt se niveli yt i besimit ka njëfarë frikërespekti latent ndaj tempujve religjiozë, e posaçërisht ndaj tyrbeve. Kjo bestytni është mjaft e përhapur në masë dhe nuk dyshova se e ke edhe te ti. Po ashtu e dija se ti ishe mërzitur nga pija dhe dëshiroje që të largoheshe nga konsumimi i saj. Këtë dëshirë e kishe të flaktë, por ndërvetëdija jote në formë të shprehisë së rrënjosur të përjetimit të caktuar euforik shpirëtror që arrihet përmes alkoolit, ishte shumë më prezente dhe më dominuese. Andaj, nevojitej ndonjë fuqi më e fortë mentale të të shkëputte nga kjo shprehi e rrënjosur. Çka mendon, cila do të ishte kjo?

- Nuk di, ndoshta besimi...apo...

Kishte vërejtur se nuk kisha ndonjë përgjigje adekuate rreth kësaj, andaj m'i ndërpreu fjalët.

- Besimi po, por së pari frika. Frika, miku im, i nderuar, ka lindur para njeriut, thotë populli, andaj, sa natyrale, ajo është edhe pengesë e madhe në realizimin e shumë qëllimeve jetësore.

- Mirë, pra...e ajo me qirinj dhe...

- Sërish nuk më le të vazhadoj më tej. Ha, ha, haaa... përsëri ajo qeshje e tij ironike. Edhe pse isha mësuar me këtë shprehi të shpeshtë, këtë herë ndjeva veten sikur jam vënë në lojë.

- R i t u a l! Vetëm ritual, o njeri i mirë. Rituali i caktuar, duke e parapërgatitur ndërvetëdijen për një

seriozitet të sugjestionit, gjithnjë e më tepër e sforcon dëshirën e orientuar. Vetë serioziteti i sugjestionit, si qëllim, krijon parafytyrimin e gjendjes së dëshiruar dhe kjo, gjithnjë nga frika e mallkimit të madh, mbetet prezente dhe përsëritet pandërprerë gjersa rrënjoset thellë në ndërdijen tënde si shprehi e re duke e zbehur atë të vjetrën.

- Po mallkimi i madh - edhe kjo ishte ndonjë grackë didaktike jotja me naivitetin tim?- e bëra këtë pyetje me një dozë patetizmi të maskuar.

- Jo, mallkimi i madh ekziston. Nëse betimi jepet sinqerisht dhe kjo kryhet përmes ritualit të caktuar në një ambient me atmosferë sugjestibile, me thyerjen e këtij betimi sigurisht do të ishe ballafaquar me mundimin e ndërgjegjes. Mundimi i ndërgjegjes gjithnjë shprehet si konflikt psikik, apo frustracion, dhe ne e përjetojmë atë në formë të pendimit. Për ta pasur më afër këtë ndjenjë, mund ta rikthesh në kujtesë atë gjendje me dehje alkoolike - dhe kur të zgjohesh në mëngjes, s'të kujdohet asgjë ç' ke bërë mbrëmë...

- Uh... lere, mos ma përkujto atë, të lutem!

- Pra , nuk ka mallkim më të madh në botë sesa kur të mundon ndërgjegjja jote. Ajo, pastaj, lind dyshimin, dyshimi frikën, frika mobilizimin e mekanizmave mbrojtës psikikë e kështu me radhë, gjersa trupi të shkaktojë tajimin fizik të hormoneve të caktuara në gjak... Reagimi i tërësishëm është tendeca që sa më shpejt të harrohet kjo gjendje. E vetë procesi i harresës, si zbrapsje, regjistrohet në ndërvetëdije. Më pastaj, çfarëdo sinjali i ngacmimit më

të vogël do të aktivizonte atë gjendje e cila do të shprehej në formë të vuajtjes shpirtërore. Kjo shpeshherë, kur përsëritet, arrin gjer tek sindromi i quajtur “kompleksi psikik”.

- Mirë, pasi tani e di se e tërë kjo është ndryshe nga si e kam kuptuar unë, a nuk ekziston rreziku që të mund të vazhdoj sërish me të vjetrën?

- Jo! Kurrsesi jo! Se, meqë gjërat, përmes mësimit, tanimë i sheh ndryshe, ti më nuk e ke frikën, por me këtë njohuri të re, ke fituar një armë edhe më të fortë se frika.

- Çfarë është kjo armë? - e bëra këtë pyetje me një kurreshtje edhe më të madhe.

- Kjo armë tani është arsyeja që ti e ke ngritur në nivelin e vetëdijësimit të kuptimit realist të vetë veprimit të procesit si tërësi. Ose, se ke filluar t’i ndërrosh rrobat e tua të vjetra.

- Ashtu është! - brohorita. Unë kurrë më nuk do të jem ai alkoolisti i vjetër kronik!

Me të vërtetë këtë e thashë nga zemra dhe kjo reflektonte vetëbesim që asnjë bashkëbiseduesi nuk do t’i ikte pa e vërejtur e lere më mixhës Dilë.

- E di, dhe kjo është tani e tutje edhe qëllimi i shumë mësimeve tona të ardhshme. Sa më qartë që do t’i kuptosh ligjshmëritë e veprimit në Univers, aq më shumë do të bëhesh pjesë e tërësisë harmonik të tyre. E synimi i tërë kësaj dihet: arritja e qëllimit themelor - L U M T U R I S Ë !

- Dale... dale pak! Tash e kam të qartë edhe atë lojën tënde me sugjestione nga dyzet herë në ditë.

"Unë jamë njeriu më i lumtur në botë"! - klitha nga kënaqësia e asociacionit që më lindi, sepse kaherë kisha dëshiruar të dija kuptimin e arsyeshmërisë së zbatimit të tij praktik.

- Saktë! Plotësisht e saktë! Edhe kjo është diçka e njëjtë me ritualin e tyrbes. Duhet të pranoj se ti, me të vërtetë je nxënësi më i mirë. Kupton shpejt dhe përparon dukshëm; - tha kështu, por këtë herë, në vend të buzëqeshjes së tij karakteristike, çuditërisht ishte serioz. Vërtet, nuk ishin këto komplimente, ose si i quaja unë, "gracka të zakonshme didaktike" të mixhës Dilë, që shpeshherë ai dinte të m'i servonte. Me të vërtetë ato shpalosnin një ndjenjë të sinqertë të kënaqësisë së tij. Por, ishte edhe diçka që nuk përputhej me tërësinë e logjikës sime, tanimë ta quaja evolutive, prandaj edhe u nguta ta pyesja sa ishte i disponuar:

- Diçka sikur nuk përputhet: Ku është këtu frika? Sikur me ritualin e tyrbes... Mallkimi i mall...

- Përdorimi i alkoolit nga ana e jote ishte rrënjosur aq thellë në ty, saqë kishte filluar të kalonte në shprehi kronike. Pra, nga një shprehi e thjeshtë psikologjike, alkooli kishte hyrë edhe fizikisht në përbërjen metabolike të qelizave tuaja trupore.U desh të veprohet më fort dhe në të gjitha drejtimet, si në planin e vetëdijshëm, përmes frikës që do të dominojë mbi ndjenjen tënde të nevojës fizike për alkool, ashtu paralelisht edhe në ndërvetëdijen tënde,

përmes sugjestionit si inponim të ngadalshëm, por të sigurt të gjendjes së re. Ndërsa, në rastin e dytë, duhej të të këthehej vetëbesimi, prandaj këtu nuk na është dashur frika. Ta rikthesh besimin në vete, nuk duhet të frikësohesh nga asgjë dhe prej askujt. Vetëm nevojitet të dëpërtosh ngadalë me këtë ide gjer tek ndërvetëdija jote, dhe problemi zgjidhet pa ndonjë pengesë. E dija se për ty, në fillim, përsëritjet e pandërprera të fjalëve të thata në formë sugjestioni, do të ishin monotone dhe të mërzitshme, por meqë isha i sigurt në dëshirën tënde të flaktë se me çdo kusht doje ta ndryshoje gjendjen ekzistuese, nuk kam dyshuar se do të jesh i disiplinuar.

- Ti je gjeni, mixha Dilë, plotësisht ia ke qëlluar!

- Duke përsëritur së paku dy herë në ditë nga dyzet herë sugjestionet afirmative të fjalëve të caktuara, psika njerëzore e cila përnga natyra e saj është gjithnjë “endacake”, vetvetiu do të kërkojë që t’i harmonizosh thëniet verbale me parafytyrimet e përmbajtjes së frazave, duke i shndërruar ato në figuracione psikike. Kështu, pas disa kohësh, përveç me fjalë, ti fillon paralelisht edhe ta parafytyrosh atë sugjestion. Tanimë sugjestioni shndërrohet në autosugjestion, kështuqë deklarimi verbal, nga njëra anë, dhe parafytyrimi mental i atij deklarimi, nga ana tjetër, ndikojnë ngadalë dhe sigurt në ndërvetëdije, duke krijuar gjendjen e re të disponimit të inponuar.

- Me të vërtetë jam i befasur. Nuk kam koment, mixha Dilë.

- Mendoj se për sot është mjaft dhe tepër, ne do të shihemi sërish javën e ardhshme në po këtë kohë... Pajtohesh?

- Po, po; plotësisht. Bile më duket shumë e largët java e ardhme.

- Mirë u pafshim, miku im. Do të takohemi sërish, o njeri i mirë... dhe, mos harro që edhe më tej të vazhdosh me sugjestionin e gjertanishëm. Javën tjetër ndoshta do ta ndërrojmë përmbajtjen e saj.

KAPITULLI I III

Vetëm për më tepër se një muaj, në mua kishte ndodhur një renesansë e vërtetë, dhe atë pikërisht duke iu falënderuar ditës kur jam njoftuar me mikun tim të dashur, mixhën Dilë. Ishte interesant, se këtë ndryshim në vete nuk e ndjeja vetëm unë, por vëreja se ajo reflektohej edhe në rrethin tim të përditshëm. Së pari, tek nëna, e cila një ditë, sa ishim së bashku, duke pirë çajin e mëngjesit, pasi më shikoi thellë në sy, tha:

- Biri im i dashur, ti je tani me të vërtetë një njeri tjetër. E sheh se në çfarë gjendje të kishte sjellë alkooli... - këto fjalë i foli si me keqardhje dhe me një përmbajtje të rezervuar, sepsa ajo gjithnjë kishte kujdes kur fliste për shprehinë time të keqe të përdorimit të shfrenuar të alkoolit. Edhe kur kthehesha dikur shpesh i dehur në shtëpi, ndodhte të mbyllej vetëm në dhomë dhe të qante, por kurë nuk më qortonte me emocione të papërmbajtura. Pasi nuk vërejti asnjë reagim nga unë, vazhdoi: - Ke filluar të shkëlqesh si "nuri". Tani fytyra jote ka një pamje tjetër dhe rrezaton shëndet. Shumë po frikësohem, mos, ndoshta, të shkon mendja përsëri...

- Jo nënë, mos ki frikë! - e inkurajova. - E tëra i takon së kaluarës. Unë tani e tutje me të vërtetë kam vendosur të jem një njeri tjetër. Beso! Nuk kam as fijen e dyshimit në këtë rrugë! - Ajo më shikoi me vëmendje dhe unë e shihja sa gëzohej me këtë qëndrim timin të vendosur.

E gjora nënë! Tek tani kam filluar ta kuptoj ngadalë sesa ka vuajtur tërë jetën për mua. Mendonte se i tërë ky ndryshim ishte vetëm si pasojë e abstenimit tim nga përdorimi i alkoolit. Por nuk e dinte ajo edhe një gjë: Nuk e dinte se përveç këtij fakti vërtetë relevant, kishte edhe diçka tjetër, e kjo diçka tjetër ishte qasja ime e ndryshuar në vrojtimin e të kuptuarit të realitetit objektiv.

Jo vetëm nëna, por edhe fqinjët, shokët dhe të afërmit tjerë e kishin regjistruar këtë ndryshim të madh në mua. Disa këtë e shprehnin me një dozë habie, që gjatë takimit të parë mund të vërehej nga sjelljet e tyre, por kishte edhe nga ata që ma thonin troç: “ka diçka në ty”, “je më i disponura”, “nuk di... por... shoh njëfarë ndryshimi ”, “t’u ka rregulluar teni i fytyrës” etj., etj. Të them të drejtën, këto reagime të rrethit, nuk kalonin pa lënë gjurmë në mua. Ato më jepnin siguri duke forcuar edhe më shumë vetëbesimin në rrugën që kisha filluar. Mua, deri dje një askushi i cili me padurim priste të largohej përgjithmonë nga kjo botë, vetëm për një kohë të shkurtër, pikërisht kjo “botë mëkatare”, më ishte shndërruar në kënaqësi, në qëndrim, në sfidë të të mbijetuarit, dhe në burim të pashterrshëm të dashurisë. J e t ë n, këtë nocion për të cilin më parë mendoja vetëm me anën e saj të kundërt, tani e shikoja si ekzistencë, si një realitet, ku gjithmonë mund të arrihet lumturia e pakufishme.

Si nxënës i shkollës fillore dikur, me ëndje bleja dhe lexoja libra interesante. Shumicën prej tyre i kisha ende të shkapërderdhura nëpër qoshet e vitrinave të shndërruara në

enteriere stolisjesh estetike të orendive. Me kohë, interesimi për librin ishte tretur në tërësi. Herën e fundit, me sa më kujtohet, kisha blerë ca komplete para shumë viteve. Kanë qenë vërtetë libra të bukura. Me qëllim them "të bukura", sepse e di se i kisha blerë, jo për ta lexuar temën interesate të shtjellimit të tyre, por vetëm pse kishin kopertina të bukura dhe hijeshonin vitrinën e dhomës në sallonin e shtëpisë. Ky pasion i dikurëshëm ndaj fjalës së shkruar dhe leximit, kohën e fundit më ishte rikthyer sërish. Një ditë, mblodha të gjitha librat që ishin të shpërndara nëpër raftet e vitrinave dhe i rendita ato me kujdes në dhomën time.

Më lindi ideja që ta krijoja një bibliotekë personale. Pas ligjëratës së parë të mixhës Dilë, gjithnë e më tepër më rritej kureshtja që ta zgjeroja dhe thelloja njohurinë time nga teologjia.

Nga literaturën disponuese, kisha ca tekste interasante të edukatës islame si dhe Kur'an-in me fletë të trasha të nënës sime, shkruar në gjuhën arabe. Kur'an-i, edhe para se të lindja, ishte libri më i vlefshëm, ishte si trofe në familjen tonë të trashëguar që nga gjyshja. Atë, nëna e kosinderonte si gjënë më të çmuar personale.E dija se këtë libër nuk do të mund ta përdorja për shumë shkaqe. Në rend të parë, nuk e njihja arabishten, dhe së dyti, edhe sikur ta njihja, nëna sigurisht nuk do të më lejonte që ta prekja fare pa "avdes". Libri i Kur'an-it, që nëna e quante "QITAP", si një send i shenjtë, zinte vendin e nderuar mbi polisën më të lartë të vitrinës së sallonit. Në këtë kontekst, edhe një gjë ishte

interesante: Kur'an-i kurrë nuk qëndronte i shpluar, por gjithnjë i mbështjellë me një copë të bukur dhe të pastër mëndafshi. Kur nëna atë e merrte në përdorim, gjithnjë e hapte duke shqiptuar, "bismil-lahir-rahmanir-rahim-in". Shpeshherë e shikoja kur e lexote. Me sa kënaqësi dhe pasion e bënte këtë. Tretej ajo me tërë qenien e vet në përmbajtjen e librit të shenjtë, dhe asnjë zhurmë, sado e fortë, nuk mund ta ndante nga koncentrimi i madh në çastin e leximit.

Me çdo kusht, unë doja t'i kisha Biblën dhe Kur'an-in në gjuhën shqipe. Duhej t'i gjeja gjithsesi këto dy libra... Sigurisht mixha Dilë në bibliotekën e vet të pasur duhej t'i kishte këto, por unë nuk doja ta bezdisja edhe me këso cikërrimash. Ndoshta ai librat i ka si gjëra intime dhe ka mundësi të më refuzonte. Nuk kisha shtegdalje tjetër. Më duhej të veproja dhe të gjindesha vetë. Në moment m'u kujtua se, menjëherë pas luftës në Kosovë, një shoqatë humanitare arabe, në mes të shumë ndihmave që kishte shpërdarë për popullatën e kësaj ane, jepte falas edhe librin të shenjtë, që ishte i përkthyer shumë bukur në gjuhën shqipe. Libri në vete nuk përmbante bukvalisht vetëm përkthimet e ajeteve kur'an-ore, por kishte edhe një koment të zgjeruar autorial, që e konkretizonte edhe më qartë domethënien kuptimore të lëndës. E kërkova këtë shoqatë dhe pa kurrfarë vështirësie u pajisa me Kur'an-in në gjuhën shqipe. Duke planifikuar për vete një renditje më metodike studimore, arrita në përfundim se, "ndoshta do të ishte më e preferueshme që të filloja sipas paraqitjes kronologjike të

burimit të tyre”. Po, pra! Do të ishte më didaktike që më së pari t’ia filloja prej Biblës, më tej të vazhdoja me Kur’an-in, duke bërë njëkohësisht, edhe komparacione të duhura me mësimet e mixhës Dilë”.

“Ashtu duhet të jetë. Ashtu është më e drejtë”- konstatova.- “ Më duhet t’ia nisi nga Bibla”! Por Biblën në gjuhën shqipe... Ku ta gjeja atë shqip? Gati kisha harruar tërësisht se shtëpia ime ishte në lagjen e ashtuquajtur “mahalla katolike”. Kjo lagje, pa marrë parasysh se pas lufte dukshëm ishte ndryshuar struktura e banorëve të saj, popullohej më së tepërmi nga familjet e konfesionit katolik. Nuk e dija pse ishte kështu, por supozoja se afërsia e kishës mund të ishte si shkas relevant. Kishën katolike e kisha njëqind metra larg nga shtëpia ime. Priftin e njihja mirë, dhe me të kaherë i kisha krijuar raportet e afërsisë. Shpesh për festat fetare, i vizitonte komshinjtë e mi katolikë dhe unë përmes tyre isha miqësuar më për së afërmi me të. Edhe këtë problem e zgjidha. Shkova menjëherë në Kishë. Aty përzemërsisht më priti zotriu i nderuar, Dom M.. Ia tregova qëllimin e shkuarjes dhe atij i erdhi shumë mirë për shfaqjen e papritur të interesimit tim në lëmin e shkencave teologjike. Jo vetëm se ma dha falas Biblën e përkthyer shqip, por edhe disa literatura teologjike shtesë, që po ashtu kanë qenë të shkruara në gjuhën shqipe. Tani kompletova materialin fillestar dhe me një pasion të madh fillova leximin studioz të tyre.

Lexoja çdo ditë me ëndje duke zgjeruar kështu dijeninë time në këtë fushë. Sa më shpesh e bëja

krahasimin e shkrimeve religjioze dhe ato që kisha mësuar nga mixha Dilë, gjithnjë e më tepër bindesha se, të gjitha religjionet në botë, parimisht i kanë tri karakteristika themelore: vlerat e veta esenciale të besimt, simbolet dhe ritualet.Vlerat e besimit janë të njëjta tek të gjithë, dhe ato kanë një porosi të përbashkët. Dallimi ekziston vetëm tek simbolet dhe ritualet vetanake specifike. Nëse është ashtu, atëherë urtësia e vërtetë do të ishte t'i çmojmë të gjitha vlerat e përbashkëta të çdo religjioni, sepse simbolet edhe pse ndryshojnë në mes veti, ato mbështeten në besimin e fortë tek sendi apo figura karakteristike në të cilën me kohë është derdhur energjia e madhe emocionale e masës së ithtarëve. Në mbështetje të kësaj hipoteze, simbolet duhet konsideruar si çelës efikas për fillimin e ritualit dhe hapjen e kanaleve të komunikimit të vetëdijes me shtresat e pakufishme të ndërvetëdijes njerëzore.

Në anën tjetër, kemi ritualet. Ato janë vetëm ceremoniale tradicionale të rregullave formale, që shërbejnë si metoda tejet efikase në drejtim të sforcimit të vetëbesimit në vlerat e përcaktuara esenciale.

Gjatë mësimit mbi religjionet, më sfidonte edhe një rrethanë, për të cilën kaherë mendoja se duhej të ishte ashtu, por tani kjo më vërtetohej edhe më bindshëm. Asnjëri besim i predikuar nga themeluesit e tyre nuk i është servuar njerëzimit si "mollë sherri" i ndarajs në fe të ndryshme. Qëllimi ka qenë që nga ana e individëve të caktuar, të cilët kishin prirje të komunikonin me nivelet më të larta shpirtërore, t'i bëhej vërejtje njerëzimit për pasojat e

mundshme pas thyerjve permanente të ligjeve hyjnore dhe pas largimit tonë nga rruga e drejtë. Sa më shumë janë përhapur këto mësime fetare në një kohë dhe hapësirë të caktuar, aq më tepër ato kanë evoluar duke u shndërruar në dogma. Këto dogma u konvenonin vetëm shtresave të caktuara shoqërore, që përmes tyre të arrinin një mbidominim ndaj masave të gjera të bashkëkohasëve të vet. Ata, pra, janë larguar qëllimisht nga bazat e parimeve themelore të vëna nga predikuesit e tyre të parë. Kështu, me kohë, edhe në brendinë e vetë religjioneve, u shfaqën shtresat e të privilegjuarve, të cilët përmes mënyrës së caktuar të predikimit të shtrembëruar, me çdo kusht tentonin t'i ruanin pozitat e tyre në hierarhinë shoqërore të klasës sunduese. Kjo dukuri shkonte aq lag, saqë nga ana e këtyre shtresave sunduese, filluan të ngjalleshin edhe apetite të natyrës së globalizimit politik, në formë të pan-krishterizmit, pan-islamizmit ose edhe të pan-budizmit... Pra, në emër të vëllazërisë së madhe fetare, tentohej që, me çdo kusht, të hiqej dorë nga civilizimi, kultura dhe tradida vetanake e popujve të vegjël.

Ideja globale përmes bindjeve të caktuara religjioze, maskonte edhe qëllimet e caktuara politike të shtresave sunduese. Sa e sa luftëra të përgjakshme, vrasje, masakra nga më barbaret, janë bërë gjatë historisë në emër të feve të ndryshme. Sa e sa përparime gjeniale medore dhe ngritje masive të mirëfillta shpirtërore, janë stagnuar me shekuj po ashtu në emër të këtyre religjioneve...

Jo vetëm kaq! Nën maskën dhe pretekstin e përhapjes së “fesë së vërtetë të Zotit”, me kohë ata fillojnë ta imponojnë edhe kulturën e popullit nga e kishte prejardhjen vetë predikuesi i asaj feje.

Askund në Bibël, Kur’an apo në shkrimet tjera fetare, nuk hasa se një njohuri hyjnore duhet të predikohet dhe të përhapet me shpatë dhe gjak.

Etika e vlerave themelore të një religjioni dhe kultura e imponuar e popullit nga vjen ky religjion janë krejtësisht çështje të papranueshme dhe ato duhet demaskuar. Prandaj, zotohem se unë gjithnjë gjatë orientimeve të mia në jetë, do të përqëndrohem me devotshmëri t’i mësoj dhe përvetësoj vetëm mësimet e pastra dhe të mirëfillta të vlerave të përbashkëta të tyre.

Dita e takimit tonë javor me mixhën Dilë erdhi.U bëra gati dhe me një disponim të shprehur, u drejtova kah shkolla ime e jetës. Hyra në dhomën e punës ku veç më priste mësuesi im i dashur. Menjëherë e vërejta se ishte në humor të mirë. Posa më pa në hyrje, i ngriti teatralisht dy duart në ajër dhe brohoriti me gëzim:

- Ku je, miku im i dashur, nxënësi më gjentil i kursit të fillozofisë së jetës ?

- Përsëri ti me ato truket e tua, mixha Dilë? - i thashë në formë të pyetjes, si në shaka, edhe pse realisht ky cilësim i tij më konvenonte dhe më flinte në zemër.

- Jo, nuk janë truke, por sinqerisht jam i kënaqur. Kam informata të sakta se ke filluar të interesohesh për teologjinë dhe këtë javë mjaft ke studiuar në këtë drejtim!

- Je i çuditshëm, mixha Dilë! Asgjë nuk t'i shpëton syrit tënd të mprehtë, asgjë!

Gjendja e humorit tim ishte shndërrar tani edhe në habi se "kah i mori ky kaq shpejt këto informata". Përsëri ajo qeshje e tij dhe...

- Të kamë thënë, unë gjithnjë vërej dhe di atë që sinqerisht dëshiroj të vërej dhe të di, e pastaj informatat ofrohen vetvetiu. Gjatë javës së kaluar, e takova nënën tënde dhe pash se ishte shumë e lumtur. E pyeta për ty. Më tregoi se këto ditë kishe filluar t'i grumbulloje librat në një biblotekë personale. Dje, po ashtu e takova priftin e kishës katolike. E kam mik të vjetër. "Isha i befasuar" - siç më tha - "me atë fqiunë tënde". Ke qenë tek ai dhe i ke kërkuar Biblën në gjuhë shqipe, a po?

- Po, po! Ashtu është. Kam gjetur Kur'an-in dhe Biblën në gjuhën shqipe dhe fillova të lexoj nga materiali burimor për religjionet. E dija unë se ti i ke këto libra, por sikur më erdhi keq t'i huazoja. Mendova se si t'ia bëja dhe e zgjidha vetë problemin.

- Shpejt mëson, biri im, shumë shpejt mëson. Vërtet unë i kam këto libra, por ti duhet të mësosh dhe ta kesh shprehi të përhershme që dëshirat dhe qëllimet e tua jetësore t'i realizosh vetë. Të kam thënë: "gjithnjë kur diçka e kërkon sinqerisht, ajo të ofrohet vetvetiu". Ti nga nevoja dhe dëshira e madhe që ke pasur për këto libra, nuk ke patur mundësi që vetes t'ia inponosh ndonjë kufizim. Gjithnjë ke qenë i preokupuar vetëm me qëllimin e fundit se duhet t'i gjesh ato. Ke vepruar drejt dhe i ke gjetur.

Kështu duhet bërë edhe me dëshirat tjera jetësore. Mos harro! “Ti je qenie hyjnore dhe krijesë e Zotit në këtë botë”. Zoti nuk i urren krijesat e veta, prandaj Ai plotëson të gjitha dëshirat tona. Kështu gjithnjë vepro dhe suksesi do të jetë i garantuar. Mos dysho! Mos i cakto vetes kufizime! Kufizimet në rrugën e realizimit të dëshirave ekzistojnë vetëm në kokën tënde si mendime të gabuara dhe rezualtat i frikës, agjë më tepër. I tërë realiteti ynë krijohet me mendime. Nëse ti dëshiron diçka, dhe atë dëshirë paralelisht e kushtëzon me dyshimin e realizimit të saj, gjithnjë fiton dyshimi, sepse ajo është rrënjosur në mënyrën tënde të të menduarit ... Ndërkohë, desha të tregoj edhe për diçka praktike: gjithnjë kur je duke mësuar një lëndë, kurrë mos u ngut! Qetësohu! Vetëm koncentrohu dhe mos ia impono vetes që t’i mbash mend të gjitha.Vetë interesimi dhe vëmendja e përqëndruar, automatikisht angazhojnë procesin e natyrshëm të të mbajturit mend.

Të mësosh, nuk do të thotë të mbash mend çdo fjalë, të mësosh përmendësh fjalët e mia, por t’i kesh të qarta paraimet që janë në esencën e çdo të mësuari. Nëse i njeh parimet, dija vjen vetvetiu. Kurrë mos e impono dhuntinë e të mbajturit mend të detryeshëm. Këtu gabojnë shumë nxënës dhe studentë, sepse ata, saherë që dëshirojnë të reprodukojnë diçka të mësuar, vërejnë se nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë. Pse? Sepse u mungon gjuha dhe stili i autorit, i atij që e ka shkruar apo thënë atë...

- Se është ashtu e kam vërejtur edhe vetë, dhe mund të premtoj se tani e tutje këtë mënyrë të të mësuarit do ta

kem si metodë të përhershme... Jam i padurueshëm të di se çka do të jetë tema e ditës së sotme të mësimit, mixha Dilë?

- Trupi, mendja dhe shpirti! Tre faktorë të realitetit tonë, ose edhe ndryshe: I vrojtuari-trupi, procesi i të vrojtuarit-mendja dhe vrojtuesi-shpirti. Shpirti, si krijesë hyjnore, për të vrojtuar realitetin material duhet edhe vetë të bie në atë gjendje, gjegjësisht edhe vetë të jetë si realiteti i njëjtë, pra materie ose trup. Nëse shpirti veç është në trup dhe fillon vrojtimin në realitetin objektiv, këtë e bën përmes procedurës së caktuar e cila quhet proces i të menduarit. Procesi i të menduarit ndërtohet nga dy të kundërtat e veta, si rezultat i veprimit të Ligjit të të kundërtave: Prej mendjes së vetëdijshme, racionale dhe asaj të ndërvetëdijshme, irracionale. Detyra e mendjes së vetëdijshme është që të jetë më afër materiales dhe të koordinojë të dhënat që vijnë përmes instrumenteve të veta materiale. Instrumentet tona materiale janë shqisat. Rezultatet e arritura nga shqisat gjithnjë përpunohen si ngacmime të vetëdijshme gjer në momentin kur ato në formë të kujtesës ekzistojnë në mendjen tonë të vetëdijshme. Ndërsa, ana tjetër e të menduarit është mendja e ndërvetëdijshme e cila është më afër shpirtit dhe më hyjnore. Ajo ka funksion që tërësisht të jetë në shërbim të mendjes së vetëdijshme dhe gjithnjë t'i ofrojë asaj shëbimet e duhura. Për t'i shërbyer me besnikëri, mendja e ndërvetëdijshme ka kompetenca të pakufishme. Në fakt,

është inteligjencë e paskajshme. Si trupi dhe shqisat janë të afërta me materien, ndërvetëdija është e afërt me hyjnoren.

- Edhe këtu vepron Ligji i të kundërtave, por ku është produkti i ri si reagim i kësaj?

- Komunikimi i mendjes racionale me mendjen irracionale është proces i tërësishëm, i pandashëm dhe i përhershëm. Produkti i ri nga ky komunikim do të jetë realizimi i qëllimit apo i synimit të caktuar.

- Siç po e kuptoj, tek synimet dhe dëshirat emocioni është i fundit si rezultat dhe jo nxehtësi gjatë LIGJIT TË TË KUNDËRTAVE.

- Ashtu është, dhe duhet pranuar se e ke kuptuar në thelb parimin e veprimit të këtij Ligji. Çdo dëshirë dhe synin, edhe pse e ka si kërkesë një nevojë të caktuar materiale ose psikike, caku i saj i fundit është kënaqësia dhe lumturia.

- Më duket se diçka nuk përputhet në kokën time; - e thashë me nguti këtë, sepse vërejta se renditja ime logjike e të kuptuarit u prish.

- Edhe këtë shumë lehtë do ta kesh të qartë; - ndrhyri menjëherë mixha Dilë. - Gjithnjë duhet ta kesh parasysh se qëllimi i fundit tek çdo synim dhe dëshirë nuk është ralizimi i saj konkret por ndjenja e rezultatit që buron nga ky realizim. Ja sërish një shembull, të them ashtu materialistik...ha, ha, ha ... - Mixha Dilë gjithnjë e përdorte me ironi termin materialistik, sepse edhe mua ashtu më konsideronte, për shkak të qëndrimeve të mia të edukatës së shprehur materiale. - Ta zëmë se dëshiron të kesh një

automjet. Ligji i parë i të kundërtave që ka të bëjë me ruajtjen e formës së përhershme është bindja se NUK KE AUTOMOBIL. Ligji tjetër i të kundërtave do të ishte ligji i lëvizjes, gjegjësisht DËSHIRON QË TË KESH AUTOMOBIL. Me fërkimin e këtyre dy të kundërtave paraqitet ndjenja e BESIMIT si një emocion, gjegjësisht si nxehtësi. Mund të kesh, ose nuk mund të kesh?! Nëse dominon e para si produk i ri do të jetë:

NUK KAM AUTOMOBIL + KAM DËSHIRË TË KEM AUTOMOBIL... vepron emocioni i BESIMIT dhe në bazë të këtij besimi, si produkti i ri, do të ishte:

- Dëshiroj të kem automobil, por nuk mund ta kem, SEPSE NUK KAM PARA ...ose: E KAM AUTOMOBILIN DHE S'KA DYSHIM! Te e para shfaqet ndjenja e DYSHIMIT apo efekti NDOSHTA, kure te rasti i dytë ndjenja e gëzimit. Çka mendon, pse nuk është realizuar qëllimi ynë në rastin e parë?

- Sepse ashtu ka vendosur besimi; - konstatova.

- Po pra, ashtu ka vendos besimi dhe i tërë ky mësim i aftësimit tonë të përbashkët gjatë tërë kësaj kohe mbështetet në të mësuarit e orientimit të besimit vetëm kah pozitivja dhe realizueshmëria e plotë. Qëllimi i ralizimit të synimeve tona është LUMTURIA e përhershme. Nëse e ke kërkuar automjetin dhe e ke realizuar atë, patjetër do të pason kënaqësia ose lumturia për qëllimin e arritur. Vetë dëshirat dhe synimet tona ekzistojnë që të përjetohet caku i fundit, pra l u m t u r i a. Tani besoj se e ke të qartë dallimin e këtyre dy emocioneve.

- Pse, atëherë, disa dëshira realizohen e disa jo?

- Ato në të cilat besojmë realizohen, kurse ato në të cilat nuk besojmë, nuk realizohen.

- Sërisht nuk e kam të qartë...

- Thamë më parë se tek ti si qenie njerëzore ose makrokozmos me trup, mendje dhe shpirt, si jomateriale vepron mendja racionale dhe e vetëdijshme, së bashku me të kundërtën e saj, mendjen irracionale dhe të nënvetëdijshme. Po ashtu, konstatuam se këto dy mendje komunikojnë pandërprerë së bashku. E para është mendje që duhet të dëshirojë dhe e dyta është mendje që duhet të realizojë. Me fërkimin e ndërrimit të informatave të ndërsjellta, krijohet emocioni i besimit ose mosbesimit, i cili lejon angazhimin e ndërdijes të ekzekutojë këtë synim ose të mos e ekzekutoj atë. Nëse besimi është negativ, produkti mbetet në mendjen e vetëdijshme si bindje, si besim i kundërt që nuk ralizohet. Nëse besimi është pozitiv, atëherë ajo shkon në ndërvetëdije dhe patjetër realizohet. Procesi në të dy rastet funksionon njëjtë, por dallimi është te ndjenja e dëshprimit si VUAJTJE, apo e kënaqësisë si LUMTURI.

- Mirë...Tani vetvetiu më inponohet pyetja kurioze sesi krijohet gjithnjë besimi pozitiv?

- Besimi pozitiv krijohet duke ndryshuar bindjet e gjertanishme që janë akumuluar, si: nuk mundem, është e pamundur, nuk ka para, jamë i dobët, nuk kam unë fuqi, nuk jamë i mençur...

- Po si ndryshohen ato... o mixha Dil? - Këtë pyetje e bëra edhe me një ngjyrë dhe ton lutës.

- Duke mësuar veprimin e ligjshmërive shpirtërore, biri im. Këtë pikërisht që jemi duke e bërë edhe ne.

- Mirë, mixha Dilë, - desha të bëj këtu një digresion; - shpirti thua është hyjnor dhe i lidhur me Perëndinë, duke ekzistuar në botën materiali si trijadë: Shpirt, mendje dhe trup?

- Sakt!

- Ma dëshmo, të lutem, më për së afërmi këtë lidhje.

- Para se të përgjigjem në këtë, do ta tregoj një metaforë të urtisë së lashtë indiane: "Zoti pasi e krijoi njeriun si qenien më të përsosur në univers, me kohë vërejti se krijesa e tij, me shprehitë e veta të jashtëzakonshme që i kishte, gjithnjë e më tepër bëhej e padurueshme. Pa ndërprerë kërkeonte diçka, ankohej në dikë, nuk ishte i kënaqur me atë, kërkon këtë… Andaj, një ditë, Zoti kishte vendosor të fshihej që të ikte nga njeriu. Por, ku të shkonte? Ku të fshihej? E dinte Zoti se, kudo që të fshihej, njeriu përsëri do ta gjente. Kështu duke bredhur i zhytur në mendime, rrugës takon një të urtë dhe ia rëfen problemin e vet. I urti pasi e dëgjon me vëmendje, i përgjigjet: "Zoti im i madh, nëse dëshiron të fshihesh përgjithmonë nga njeriu, hyr në zemrën e tij dhe ai kurrë nuk do të kërkojë aty"… E shikon se ai është në zemrën tonë…e ti, dhe shumë të tjerë, atë e kërkoni larg , në qiell e ku ta di se ku tjetër…

“Me të vërtetë ishte një shembull shumë i qëlluar i realitetit tonë praktik”- mendova në vete. “Zoti është në brendësinë tonë e ne e kërkojmë krejtësisht diku tjetër”.

- Kjo metaforë na e mundëson që të kuptojmë se Zoti është në vetë ne dhe kurrsesi diku tjetër; - e vërtetoi me zë këtë mendim timin edhe mixha Dilë; - edhe pse gjithmonë atë e kërkojmë larg e më larg… diku në qiell e ku ta di se ku tjetër.

Pas këtij digresioni të bërë në përgjigjen direkete të pyetjes sime, vazhdoi:

- Me këtë desha të vërtetoj edhe një herë se, përveç si trup i ndërtuar nga materia, si shpirt ne jemi hyjnorë dhe pjesë e Zotit. Kemi, pra, trupin dhe shpirtin. Si qenie shpirtërore, ndërtohemi në dy nivele: Kemi mendjen e vetëdijshme - racionalen dhe të ndërvetëdijshmen - irracionalen. Duhet patjetër ta kesh të qartë se këto nuk janë dy mendje të ndryshme, por dy fusha të aktivitetit në brendi të një mendjeje.Vetëdija është pjesë e mendjes që mendon. Asaj i takon aktiviteti i të përcaktuarit, të zgjedhurit. Siç, p.sh., e patëm më parë në rastin tënd: I zgjedh librat, i seleksionon ato që do t’i lexosh, i vendos në dhomën tënde, duke krijuar kështu bibliotekën personale… Ti zgjedh personin me të cilin do të jetosh, me të cilin do të mësosh. Me një fjalë, vetëdija jote i bie vendimet. Nga ana tjetër, zemra dhe shumë organe tuajat funksionojnë në mënyrë automatike, pa ndërhyrjen e vetëdijes. Ato, pram janë procese të ndërvetëdijshme. Ndërvetëdija pranon çdo gjë në çka sinqerisht beson vetëdija. Ndërvetëdija nuk mendon,

nuk dyshon dhe nuk hyn në diskutime. I ngjan shumë arës që pranon çdo lloj fare, qoftë ajo e mirë apo e keqe. Mendimet negative, shkatërruese, e kanë të njëjtin efekt me mendimet e mira dhe pozitive, dhe pas një kohe të caktuar, gjithnjë lajmërohen si përjetim përkatës. Vetëdija ndonjëherë quhet mendje objektive, sepse merret me pamjen e jashtme. Mendja objektive ka për detyrë njohjen e botës objektive. Mu për këtë qëllim të saj i shërbejnë pesë ndjenjat, apo shqisat fizike. Ajo është udhërrëfyese dhe drejtuese e të gjitha kontakteve tona me rrethin. Të gjitha njohuritë që ti i posedon, i ke fituar me ndihmën e pesë shqisave. Mendja objektive mëson me anën e vështrimit, të përvojës dhe të arsimimit. Ndërvetëdija shpeshherë quhet mendje subjektive. Detyra e mendjes subjektive është që ta njohë rrethin e vet, por duke mos i shfrytëzuar të pesë shqisat ekzistuese. Me fjalë tjera, mendja subjektive sheh me ndihmën e intuitës dhe paraqet selinë e të gjitha ndjenjave dhe deponë e kujtimeve. *Mendja subjektive vjen në shprehje kur shqisat objektive janë pasive . Shkurt, fjala është për pjesën e mendjes tënde e cila shpërthen në plan të parë, në momentin kur mendja objektive kotet ose kur pushon.* Mendja subjektive gjithnjë sheh dhe dëgjon, por gjatë kësaj kohe nuk i shfrytëzon as organet e të pamurit dhe as ato të dëgjimit. Dhe, ta thjeshtësojmë: Ne mendojmë me pjesën tonë të vetëdijshme të mendjes. E tëra që mendojmë shkon në ndërvetëdije, e pastaj, si forcë krijuese, nga thellësia e vet, udhëheqë me veprimet e njeriut. Pra, ndërvetëdija është selia e të gjitha mendjeve, por edhe pjesë

krijuese e individit. Dhe, çka është me rendësi për ta mbajtur mirë në mend: ndërvetëdija nuk merret me të menduarit, me atë se a janë mendimet tuaja të mira apo të liga, të vërteta apo të pavërteta, por ajo reagon sipas natyrës së mendimeve që i ofrohen.

- A janë këto mësimet e urtisë së civilizimeve të lashta njerëzore, që thamë se kanë qenë të ruajtura si fshehtësi nga shtresat e caktuara?

- Në disa perioda kohore kanë qenë të ruajtura si fshehtësi, por tanimë jo. Dualitetin e qenies njerëzore në fizike dhe psikike, si dhe të qenies psikike në atë të ndërvetëdijshme dhe të vetëdijshme, e pranon edhe shkenca e sotme. OKULTIZMI, si një nga urtitë e vjetra, sa i përket ndërtimit të krijesës njeri, shkon edhe më larg. Ekzistimin dhe funksionimin e njeriut në botën e relitetit tonë objektiv e shpjegon përmes shtatë shtresave ose planeve të ekzistimit.

- A i di ti këto shtatë plane, mixha Dilë?

- Po, ato janë shtatë shtersa të veprimit të koordinuar të dualitetit tonë psiko-fizik. E para, njeriu si qenie FIZIKE me pesë shqisat e veta si instrumete të njohjes dhe kontaktit me realitetin tonë të jashtëm fizik; pastaj plani ASTRAL, ku është vendosur qendra e ndjenjave, emocioneve dhe dëshirave tona; më tej vjen plani MENTAL, ku është pjesa e vetëdijshme psikike dhe përbëhet nga mendimet, planifikimet, veprimet…; shkohet gjithnjë më lart dhe kah qendra e burimit hyjnor, dhe si plan i katërt ekzistencional është BUD-HI, pjesa intuitive gjer ku mund të shkohet me

përjetimet tona përmes vetëdijësimit të mundshëm; pastaj vjen shtresa e pestë, e gjashtë dhe - e shtata është plani ATMIK, ANUPADAKA dhe së fundi ADI. Sa më lart që shkon, aq më afër je krijuesit tënd.

- Si përjetohen këto gjendje shpirtërore, mendoj këto të niveleve më të larta?

- Përmes ndritjes, gjegjësisht përmes shenjtërimit. Shpirti ynë është në të gjitha këto nivele, por ne jemi të vetëdijshëm vetëm për katër të parat. Disa nga profetët kanë patur rastin të ngjiten edhe në nivele më të larta dhe të kthehen nga ato me informata të caktura, gjegjësisht me eksperienca të caktuara në botën e vetëdijshme.

- E pozita e EGO-s këtu?

- EGO-ja është Satana në ne! Ajo që e mashtroi Adamin dhe Evën që të lakmonin sa ishin në Kopshtin e Edenit. Është vetëvlerë ekzistenciale me qëllim të ruajtjes së identitetit të qenies. Pra, është vetëm një instikt i cytjes që të ecet sa më përpara në rrugën tonë të transformimit kah përsosja e përhershme. Nëse ky instikt nuk kontrollohet dhe nuk u nështrohet rregullave të caktuara hyjnore, atëherë bëhet pengesë më e madhe e lidhjes sonë me vetë amën. Kur Perëndia krioi Adamin dhe Evën, ata ishin të lumtur në Kopshtin e Edemit, dhe të afërt me të. Ky kontakt i drejtpërdrejtë prishet në momentin kur Perëndia vuri ndalesën e mosngrënies nga pema e caktuar. Të kujtohet, Satanai i shndërruar në gjarpër e mashtroi dhe kjo ndalesë u thye. Ndalesa e ngrënies nga pema ishte vetëm një sprovë e kontrollit nga njeriu të këtij instikti shumë të fortë. Ky

kontroll dështoi dhe njeriu u bë viktimë e një elementi që këtij instikti, siç është lakmia. Satanën duhet kuptuar si Ego, e kundërta e Un-it të pastër, e cila, edhe përpos të gjitha të mirave që kishin, lakmoi të ketë edhe urtinë e Perëndisë.

- Siç po mund ta kuptoj, edhe EGO-ja si instikt i fortë duket se është pjesë e qenies sonë?

- EGO-ja është pjesa jonë e pandashme, por nuk është ajo që jemi ne në esencë. EGO-ja është pasqyrë për veten, maska jonë shoqërore. Është roli që ne e luajmë. Maska jonë shoqërore jeton nga miratimet - mirënjohja. Ajo dëshiron të kontrollojë. Atë e mbështet forca, sepse ajo jeton me frikë. Pra Satana figurativisht është Ego-ja jonë, e cila gjithnjë ndjehet e pakënaqur, gjithnjë kërkon diçka, dhe përherë është e ndijshme. EGO-ja e kthen njeriun kah jashtë, kah materia, dhe e largon nga kontakti i vërtetë me hyjninë. Prandaj, pasoi edhe dënimi i dëbimit nga Kopshti i Edenit. I vetmuar dhe në realitet të ri, njeriu edhe më tej u mbështet në EGO-n, duke e mbyllur gjithnjë kontaktin me potencialin e pastër të UNI-t të tij. Ai, përpos mëkatit të parë, edhe më tej vazhdoi me mëkate të tjera; prandaj, në predikimet e tyre, misioni i shumë mesive gjatë tërë historisë njerëzore, nuk ka qenë krijimi i feve dhe religjioneve si ndarje në mes të njerëzve, por ishte ato vërejtje për këto gabime që na largojnë jashtë ligjeve hyjnore të Zotit, duke paralajmëruar dënimin e merituar që do të na pret.

- Po, mixha Dilë, dhe për këtë konstatim jam bindur edhe vetë gjatë marrjes me vepra religjioze... Por, do të më kishte interesuar për do gjëra më praktike, me të cilat ballafaqohemi në jetë, ta zëmë: Pse disa njerëz shumë gjëra i dëshirojnë në jetë dhe ato nuk i realizojnë kurrë?

- Pajtohem! Ashtu është shkaku se në mënyrën e realizimit të këtyre dëshirave bëhen shumë gabime. E para, dëshirat kërkohet të realizohen në kohën e ardhshme. Çka ndodh këtu? Nëse i thua vetes se do t'i gjej librat, mendja jote dëshirën e shndërron në fantazi. Pra, në diçka joreale. Aktivizohet alarmi dhe menjëherë angazhohet dyshimi! Ajo, mendja, regjistron se kemi të bëjmë me një proces të gjatë, kështu që krijohet vakumi me mundësinë e parashtrimit të pengesave të ndryshme nga ana e Ego-s. Dyshimi është në natyrën tonë dhe Ego-ja disponon me mekanizma të fortë të kontradëshirës për ta bindur ndërvetëdijen se, nuk do të jetë lehtë të arrihet ky qëllim. Si gabim i dytë i shumicës prej nesh, është sindromi i NDËRMJETËSIMIT. Edhe pse në fillim duket se kemi të bëjmë me një instrument të dyshimit, ajo në realitet është fenomen në vete. Servohet në të njëjtën kohë me dëshirën dhe shfaqet kryesisht tek ato materiale - *dëshiroj sinqerisht të kem atomobil, por nuk kam para që ta blej* . Pra, shkon paralelisht, dëshira - automjeti dhe kontraefekti - mosekzistimi i parave. Gjatë dëshirimeve tona, duhet ta dijmë se - paratë kurrë nuk janë qëllimi, por mjeti në rrugën e realizimit të dëshirave. Ne, pra, duhet ta kërkojmë sendin, e jo mjetin e arritjes gjer tek sendi. Sesi dhe me çfarë

mjetesh do të plotësohet dëshira, është punë tërsisht e ndërvetëdijes. Paratë janë sende të përgjithsuara dhe ato mund të përdoren si ndërmjetësues në shumë dëshira tonat. Ndërvetëdija gjatë "elaborimit" të komandës së pranuar, e cila ndërtohet nga dëshira, në njërën anë, dhe ndërmjetësuesit - parasë, nga ana tjetër, vëren konfuzionin dhe kjo komandë, si e padefinuar qartë, mbetet anash. Tek dëshira: ta kesh automjetin, vizualizoje automjetin, e kurrsesi, "e dua automjetin, por më duhen edhe paratë."

- Si të eleminohen këto pengesë formale?

- Shumë lehtë. Dëshirat tona gjithnjë duhet kërkuar tani, Sot dhe vetëm SOT. Mbretëria, harmonia, paqja, dashuria, lumturia dhe mirëqenia materiale janë në ty. Ekzistojnë tani, dhe ato duhet ndjerë si të realizuara. Me këtë procedurë, me mjeshtri është eliminuar një element i rëndësishëm - koha. Pa kohë, nuk ka mundësi të veprojë dyshimi, sepse ajo ekziston vetëm nëse mendohet për diçka që ka kalur dhe për diçka që duhet të vijë. Të gjitha realitetet që ne i regjistrojmë në mendje përmes pesë shqisave tona, mendja jonë është mësuar t'i pranojë si të vërteta. Çdo ngacmim që na ka arritur nga jashtë, përmes shqisave tona, në formë të valëve elektromagnetike, deponohet në psikën tonë, duke krijuar kështu realitetin që kemi. Edhe parafytyrimi i qartë i diçkahi dhe përjetimi i tij emocional, është po ashtu valë elektromagnetike dhe, nëse eliminohet dyshimi, ai do të deponohet në psikën tonë duke krijuar po ashtu një realitet. Dallimi është i thjeshtë: Kur ne i regjistrojmë gjërat me shqisat tona si instrumente të

mendjes tonë racionale, kurrë nuk dyshojmë në to. Kështu duhet të ndodhi edhe me dëshirat që dëshirojmë të realizohen, duke i vizuelizuar në mendjen tonë si të vërteta. Ato edhe janë të vërteta, dhe do të konsiderohen ashtu me kusht që parafytyrimi, si përjetim, të jetë i qartë; i qartë sikurse ta shohim me sy, sikurse ta ndëgjosh me vesh, sikurse ta përjetosh me emocione... Nëse veprohet kështu, atëherë mendja jonë irracionale do t'i pranoj këto ngacmime njëjtë sikurse të kenë arritur nga shqisat .Pastaj, puna është e lehtë. Ndërvetëdija, si inteligjencë e paskajshme, e ka për detyrë saktësishta ta realizojë në realitetin tonë objektiv material...

- A ka ndonjë metodë të ushtrimit praktik që unë duhet ta zbatoj? - isha i padurueshëm.

- Po. Ka. Është metoda e vizuelizimit dhe ligjshmëritë e veprimit të saj. VIZUELIZIMI është veprimi më bazik i të gjitha komunikimeve shpirtërore. Ai është gjuha e vetme me të cilën kominokohet përmes vetëdijes, si pjesë racionale, me ndërvetëdijen, si pjesë irracionale e qenies sonë.

- Mendon në parafytyrimin psikik të figurës së qartë në mendje? Atë që e zbatoja gjithnjë në sugjestionet e mija?

- Pikërisht ashtu. Tani mendoj se është koha që ta konkretizojmë më për së afërmi pse është kështu. Që të mbërrijë një sugjestion sa më qartë në ndërvetëdijen tënde, ai duhet të kalojë përmes filtrit të fortë ndërmjetësues të EGO-s. Ego-ja, pra, është roja besnike e kontaktit të brendshëm me botën e jashtme objektive. Gjuha, si

komunikim verbal, është vetëm tingull zanor që artikulon një kuptim të caktuar.Gjuha dhe të folurit verbal në evoluimin e qenies njerëzore është zhvilluar shumë më vonë sesa parafytirimi psikik.Çdo gjë që thuhet, gjithnë së pari ekziston në mendjen tonë si parafytyrim i qartë. Prandaj, ndërvetëdija pranon vetëm sinjalet në formë të parafytyrimeve si domethënie reale. Kur sugjestioni thuhet me fjalë, automatikisht angazhohet edhe parafityrimi i domethënies së asaj fjale. Çdo gjë është në mendje dhe në kokë. Ke parë ndonjëherë njerëz që kanë prirje të theksuar për t'i bindur shumë lehtë të tjerët. Çka mendon, pse është kështu tek ata?

- Nuk di. Nuk di, por… sinqerisht kisha dashur ta kem edhe unë këtë aftësi në komunikimin tim të përditshëm me të tjerët.

- Është shumë lehtë. Vetëm duhet të ushtrosh që paralelisht: çdo thënie verbale, ta bësh përmes parafytyrimit të qartë. Gjithnjë mendimi i folur në këtë formë, është më dëpërtues dhe sundon vëmendjen e bashkëbiseduesit. Edhe këtu vlen ligji i të kundërtave. Fjala që thuhet, së pari është e krijuar në mendje, andaj është shpirtërore; pastaj, ajo thuhet me instrumentet e komunikimit fizik, zërave dhe gojës, andaj është edhe fizike. Me ekzistimin e ligjshmërisë së të kundërtave gjithnjë mund të shihet edhe rrjedhorja e katër fazave elementare të zvillimit: Ideja-fjala që duhet shprehur; nxehtësia-emocioni gjatë shprehjes; deklarimi verbal apo të folurit-uji; dhe pranimi i saj si sugjestion nga bashkëbiseduesi -materializimi, apo faza e tokëzimit. Gjatë

komunikimit të mirëfilltë tek shumica e oratorëve mungon faza e dytë. Pra, faza e nxehtësisë, ku nuk i jepet emocioni fjalëve që thuhen. Ato fliten si shablone pa ndjenja, andaj edhe nuk e kanë fuqinë e ndikimit të bindshëm tek bashkëbiseduesit tjerë. Në fund, sikur mund të vërehet, mosveprimi i fjalës së folur si sugjestion tek bashkëbiseduesit tjerë, ndikon edhe në mospërmbushjen e fazës së katërt. Andaj, mund të thuhet se nuk ekziston efekti, prandaj e kotë ka qenë çdo gjë.

- Artistët e mëdhenj të artit skenik e kanë këtë aftësi?

- Ashtu pra. Ata e kanë këtë aftësi dhe suksesi i interpretimit të një roli varet nga ajo, se si dhe sa e përjeton artisti me emocion. Ai gjithnjë e paramendon ose e parafytyron rolin dhe tekstin që duhet ta thotë. Këtu është fshehtësia e suksesit në interpretimin artistik të aktorit.

- Si të arrihet emicioni në çdo fjalë dhe mendim që flitet? Kjo gati është e pamundshme të bëhet përherë. Edhe nëse ndodh ndonjëherë, më ka ndodhur rrallë.

- Ka ndodhur rrallë dhe atëherë kur ka ndodhur ti ke qenë më bindës dhe më atraktiv. Shprehja jote e mendimit në atë moment ka qenë e frytshme, duke bërë përshtypje gjithnjë mbi bashkëbiseduesin apo mbi bashkëdëgjuesit tjerë. Duhet të analizosh pse atëherë ke pasur sukses. Çka ka ndikuar në suksesin tënd? A e ke bërë ndonjëherë këtë? Sigurisht se jo. Fshehtësia është në atë që gjatë të folurit, mendimet e shprehura t'i parafyturosh si figuracione psikike. Me parafytyrimin e tyre, rritet koncentrimi i vëmendjes dhe me këtë edhe derdhja emocionale.

- Sikur edhe ti e ke këtë aftësi?- thashë duke menduar ashtu, por desha që të tingullonte si në formë të mahisë.

- Heeee..! - buzëqeshi lehtë; - atë vlerësoje ti.

- Të kthehemi sërish aty ku e kishim bisedën - tek Ego-ja. Pse EGO-ja në këtë veprim paraqitet si pengesë kryesore e realizimit të shumë dëshirave tona jetësore?

- Sepse gjatë tërë kohës së evoluimit, EGO-ja është ndërtuar nga vetë inpulsi që të dominojë duke potencuar në strukturën e saj të ndërtimit karakteristikat prezente të vetëkënaqësisë, lakmisë, xhelozisë, edukatës dominante, të ligjeve në sferën materialiste të veprimit … etj. Me kohë, këto elemente rrënjosen dhe përmes përsëritjes së tyre shndërrohen në bindje. Duke u udhëhequr nga këto bindje, ajo edhe formon seleksionimin e përmbajtjes së sugjestioneve të dëshirave tona. Nëse këto sugjestione nuk përputhen me normat e bindjeve të saja të formuara kaherë, atëherë angazhon instrumentin e vet të sigurt dhe shumë të fortë të mbrojtjes - DYSHIMIN, dhe kështu, dëshira, permes sugjestionit të caktuar, nuk depërton në vendin e duhur të realizimit të saj.

- Dyshimi?! - pyeta me habi.

- Ti, si qenie e përsosur, ke privilegjin të mendosh dhe të zgjedhësh realitetin tënd në mes të vuajtjes, që vetë e krijon, dhe lumturisë, e cila është qëllimi themelor i jetës dhe ekzistencës si proces në vazhdimësi. Ti zgjedh vuajtjen. Pse? Ta zëmë, nëse do ta kishe marrë një lajm të gëzuar, sigurisht gjëja e parë që në atë moment do t'i thoje vetes, është: "nuk mund të besoj se është e vërtetë."

- Plotësisht ia ke qëlluar. Ashtu është! - konstatova, i habitur nga fjalët ë mixhës Dilë, i cili sikur kishte hyrë në qenien time dhe fliste nga brendia e saj.

- Mos u befaso. Kjo nuk është dukuri e shprehur vetëm tek ti, por te shumica që janë edukuar, që nga lindja, të mendojnë kështu. Pse nuk besojmë kur diçka është e mirë, duke dyshuar përherë në lumturinë dhe kënaqësinë që na siell ajo, ndërsa shumë lehtë i besojmë të keqes dhe vuajtjes?

- Shpeshherë edhe unë këtë pyetje ia kam bërë vetes; - konstatova.

- Ne zgjedhim vuajtjen, - vazhdoi më tej mixha Dilë; - sepse aty ndjehemi më të sigurt. Duke vepruar kështu permanent krijojmë realitetin tonë të gabuar. Në të vërtetë, ne e kërkojmë lumturinë, sepse ajo është pjesë e qenies sonë, por, kur ta arijmë atë gjendje shpirtërore, dyshojmë në të.

- Pse është kështu?

- Këtu nuk kemi të bëjmë me NE, gjegjësisht me Uni-n tonë, por me EGO-n, e cila filtron çdo informatë.

- Si e bën ajo këtë punë dhe si ushqehet për veprimet e veta? - pyeta

- Pyetje e qëlluar! Nga vetë mendimet tona që i kemi për veten dhe për rrethin ku jetojmë. Nëse EGO-ja jonë ushqehet dhe edukohet nga mendimet tona, atëherë s'ka dyshim se mund ta riedukojmë. Po përsëris: ta r-i-e-d-u-k-o-j-m-ë, e kurrsesi ta pengojmë në veprimet e saja, sepse, sikurse thamë më parë, edhe ajo është pjesë e qenies sonë, si një tërësi e përsosur.

- Si të arrihet një gjë e tillë?

- Përmes dijes dhe njohjes së veprimit të ligjeve shpitërore dhe duke formuar besimin e fortë në fuksionimin harmonik të tyre. Me ndryshimin e përmbajtjes së EGO-s, të gjitha veprimet tjera ndërlidhen vetvetiu. Realiteti i tanishëm përsoset vetëm nëse e përsosim veten. Me përsosjen e vetes, përsos edhe Ego-n tënde, sepse ti tanimë i shikon dhe i pranon gjërat me atë çka ke në shpirt.

- Mbetëm tek parimi i vizuelizimit?

- Për të vepruar pa pengesa gjatë funksionimit të vet, realizimi i dëshirave tona, përmes parimit të vizuelizimit, mbështetet në pesë principe themelore që e ndërtojnë atë.

- Cilat janë këto principe, mixha Dilë? Ndoshta nuk ka fshehtësi këtu?

- Ka për të tjerët, por jo më për ty; sepse ti tani dita-ditës formohesh dhe një pjesë të rrobave të vjetra i ke hedhur kaherë nga vetja, duke i zëvendësuar ato me të rejat.

- Më vjen shumë mirë për këtë konstatim?- pranova, duke mos qenë në gjendje ta fshihja lumturinë ndaj vlerësimit të sinqertë të mixhës Dilë.

- Pesë principet themelore për funksionimin sa më të suksesshëm të parimit të vizuelizimit janë: Formimi sa më i qartë i figurës së sendit apo i pamjes psikike të situatës, që kërkojmë të realizohet, mbushja e madhe e saj me energji emocionale, kapshmëria e dëshirës, njohja e metodave operative të teknikave shpirtërore, dhe, së fundmi, dhënia e mundit dhe angazhimit të caktuar në këtë drejtim. T'i elaburojmë shkurtimisht këto:

Principi i parë: Figura e dëshirës që vizuelizohet duhet të jetë sa më e qartë dhe konkrete. Njësoj, sikur flet ose shkruan. Nësë nuk je i kuptueshëm dhe i përzien fjalët në fjali, shumë vështirë do të të kuptojë bashkëbiseduesi.

Principi i dytë: Është mbushja me energji e figuracionit psikik të parafytyruar si dëshirë. Energjia do të jetë emocioni, gjegjësisht kënaqësia e cila do të delë si besim i fortë në suksesin e arritjes së saj.

Principi i tretë: Kapshmëria e vetë dëshirës. Gjithmonë dëshira që kërkojmë ta realizojmë duhet ta ketë një rend të arsyeshëm të mundësisë reale të realizimit. Nëse je, për shembull, student i mjekësisë, më së pari duhet vizuelizuar dhënien e provimit të parë, pastaj regjistrimin e semestrit, kalimin në vit të dytë... e kështu me radhë. Nuk bën kurrsesi që menjëherë të dëshirosh të jesh një kirurg i famshëm, me renome botërore, nga Kosova.

Principi i katërt: Është njohja e teknikave operative të ligjeve shpirtërore dhe këtë njohje ti e ke, dhe ne jemi duke e bërë kaherë.

Së fundmi, principi i pestë i parimit të vizuelizimit është dhënia e mundit të caktuar. Nuk ka rezultate pa dhënien e një mundi të caktuar, lodhjeje, gjegjësisht angazhimi. Nëse i shikon me vëmendje të gjitha këto principe ndërlidhen në mes veti.

- Sërish edhe këtu sikur na paraqiten katër fazat e zhvillimt, të cilat i kemi përpunuar në mësimin tonë të parë?

- B r a v o! Këtu jemi. Pra, katër fazat magjike të funksionimit të të gjitha veprimeve kah realizimi i tyre në strukturat më të avancuara: Ideja - **si ajër**, pa formë; **nxehtësia** - mbushja emocionale e dëshirës përmes besimit dhe ndikimit permanend të dhënies së mundit; faza **e ujit** - kapshmëria e dëshirës dhe tendeca kah formimi; dhe, së fundmi: **faza e tokës**, gjegjësisht materializimi i vetë dëshirës së kërkuar. Nëse sistemi i kësaj teknike ndërpritet në njërën prej fazave të saja të veprimit, atëherë nuk ka realizim në realitetin tonë objektiv. Prandaj, edhe shpesh dëgjon: «Unë dëshiroj, por nuk mundem». Kështu edhe ti medoje dikur, a po?

- Nuk kam koment. Fascinante?

- Dale pak! Dale, dale... Si the: fascinante? Domethënë tërësisht e pranuar nga qenia jote e përsosur?

- Po!

- E sheh, pra, se përmes dijenisë së mirëfilltë edukohet edhe Ego-ja, duke formuar parime të reja në sistemin e filtrit të tij seleksionues gjatë lejimit të sugjestioneve që duhet të depërtojnë në ndërvetëdijen tonë.

- Unë ende e zbatoj sugjestionin tuaj, nga dy herë në ditë, dhe tani plotësisht e kam të qartë veprimin e tij. Duhet të pranoj se edhe rezultatet janë të dukshme. A mund të formoj unë vetë afirmime të reja dhe ato t'i përdor edhe për dëshirat tjera jetësore?

- Po, dhe njësoj zbatoji, si për dëshirat materiale, ashtu edhe për revidimin e mangësive nga personaliteti yt. Unë më nuk do t'i jap këto afirmime, sepse ti e di

procedurën e veprimit të tyre. Koncetrohu! Analizoji me vëmendje bindjet e tua të gjertanishme dhe vendos vetë se çfarë afirmimi do të përdorësh për atë synim. Armiky yt më i madh i suksesit: DYSHIMI, nuk ekziston më. Atë e ke luftuar me bindjen e re të krijuar nga veprimi frytdhënës i afirmimit të parë...Vazhdo... le të bëhet shprehi e përhershme që të mendosh pozitivisht. Tani më ke kuptuar në esencë se realitetin tonë, ashtu siç është, e kemi krijuar vetë, përmes mendimeve tona pozitive ose negative. Nëse frika, ankthi, xhelozia, lakmia... janë ndjenja që krijohen përmes mendimeve në kokën tonë, atëherë të mendojmë ndryshe dhe pozitivisht. Suksesi... nuk ka alternativë tjetër dhe quhet: MENDIMI POZITIV.

- Shkenca jonë ka arritur rezultate të pakontestueshme në studimin fizik të anatomisë dhe fiziologjisë së trupit, kuse shpirti ende mbetet si diçka e errët dhe e pastudiuar sa duhet?

- Është më se e vërtetë! Nga njohuria jonë ekzakte e quajtur shkencë, shpirti, gjegjësisht psika, ende mbetet e pahulumtuar sa duhet. Në anën tjetër, historia na mëson se në kohërat shumë më të lashta, paraardhësit tanë i kanë kushtuar një rendësi të veçantë shpirtit dhe funksionimit të ligjshmërive të tij. Se sa ka qenë i madh ky përkushtim, dëshmon vetë fakti mbi ekzistimin e shumë shkencave të vjetra metodike të studimit. Përhapja e njohurive të emërtuara si: Magjia, Misticizmi, Hermetizmi, Astrologjia, Alkimia, Okultizmi, Kaballa, Joga; më vonë: Spiritizmi, Mesmerizmi dhe deri në ditët e sotme të shkencave të

njohura, si: Parapsikologjia, Psikologjia, Psikiatria etj., flasin vetvetiu për vetveten.

- Magjia… Misticizmi! - sikur u çudita për këto terme, të cila ma ngjallën edhe më tepër kureshtjen time intelektuale. - A nuk janë këto njohuri kontestuese dhe të dyshimta për ne? - E bëra këtë pyetje me bindje të plotë se do të marr përgjigjen e kundërt. Por, me këtë unë vetëm dëshiroja që mixha Dilë të më fliste diçka më tepër për këto njohuri të lashta.

- Aspak nuk është ashtu. Kjo është prezentuar kështu gabimisht nga mosdija totale për këto njohuri, në njerën anë, dhe nga realiteti i pamohueshëm se gjatë historiesë njerëzore këto shkenca janë keqpërdorur shumë nga individët e caktuar për qëllimet e tyre të errta, nga ana tjetër. Këto keqpërdorime kanë qenë të nxitura nga shpirtligësia e EGO-s së tyre të pangopur, veprimin negativ të së cilës do ta shohim më vonë, gjatë ligjëratave tona të ardhshme.

- A nuk kanë qenë këto shkenca të fshehta nga masat e gjera, dhe shpeshherë e ndaluar veprimtaria e tyre?

- Ashtu është. Ato kanë qenë të fshehta dhe privilegje vetëm të grupit të caktuar të njerëzve. Ishte kështu, pikërisht, me qëllim të ruajtjes së tyre nga individët dhe grupet e caktuara si keqëpërdorues eventualë. Fatkeqësisht, gjithnjë ka pasur të tillë që udhëhiqeshin nga instiktet e ulta dhe i keqpërdornin këto njohuri për realizimin e qëllimeve të veta të errta.

- A mund t'i numërosh dhe t'i sqarosh disa prej tyre?

- Ndër urtitë më të vjetra që merreshin me studimin e ligjeve natyrore të botës shpirtërore është MAGJIA. Përmes kësaj urtie shumë të vjetër njerëzore, tentohej që të arrihej kontrolli mbi forcat e fshehta natyrore dhe nënshtimi i tyre vullnetit të njeriut. Mësimet e lëndës së magjisë përbëhen nga rregullat precize të manipulimit përmes ritualeve të caktuara, me simbole të ndryshme magjike. Realiteti njerëzor, varësisht se cilat forca natyrore dëshironte t'i kontrollonte, ka krijuar dy drejtime kontradiktore të veprimit të saj: "Magjinë e zezë" - dominimi dhe kotrolli i forcave të errata me tentim që përherë të shkaktohet ndryshimi i dhunshëm tek personi i caktuar, dhe "Magjinë e bardhë"- e cila ka qëllime të mirëfillta dhe është e kundërta e asaj të zezë. Burimet e sakta materiale, historike mbi prejardhjen e kësaj urtie nuk dihen. Ekzistojnë të dhëna që na orientojnë kah Sumerët, pastaj Egjiptasit e vjetër, për t'u përhapur dhe zhvilluar gjithnjë e më tepër edhe tek popujt dhe civilizimet tjera njerëzore, sikurse në Babiloni, ku kanë ekzistuar edhe shkollat legale, në Mesopotami, Persi e deri në ditët e sotme me një përhapje të madhe edhe tek civilizimi bashkëkohor i Perëndimit. Ta marrim pastaj KABALLËN. Është një urti e vjetër dhe e fshehtë jevreje, dhe trashëgohej brez pas prezi nga njerzit e zgjedhur të fiseve të caktuara. Materia e kësaj urtie kryesisht ndërtohet nga komentimi i ligjeve të fshehta shpirtërore, por në to kishte edhe njohuri që u dedikohen ritualeve të flijimit, raportit të së mirës ndaj të keqes, si dhe disa predikime parimore që e ndërtojnë bazën e filozofisë së besimit

judeist. HERMETIZMI - urti e vjetër e shkencës shpirtërore e ndërtuar mbi themelet e njohurive të civilizimit të lashtë egjiptian. Themeluesi i kësaj urtie, mendohet të ketë qenë Hermes Trismengist, i urti i madh egjiptas që konsiderohet edhe si Zot i dijes, mençurisë, matematikës, shkrimit dhe shumë njohurive të tjera. Po ashtu, Hermesi konsiderohet themelues i bazave të alkimisë, urtisë së lashtë mbi ndikimin e vetëdijshëm në shpirtin e materies si informatë, për ta ndryshuar edhe strukturën e saj substancore. Dihet se kjo shkencë është keqpërdorur mjaft nga lakmia njerëzore për t'i shndërruar metalet e ndryshme në ar - simbol i pasurisë materiale. Këto, pra, ishin disa nga definimet e shkurtra të shkencave të ndryshme të lashta që meren me ligjshmëritë e shpirtit, dhe unë ato i parashtrova vetëm si ilustrim bazë, për formimin e bërthamës së njohurisë sate të gjithanshme intrelektuale.

- A mund të më mësosh për metodat e këtyre shkencave të vjetra, si veprojnë dhe fuksionojnë këto ligjshmëri që janë ruajtuar me shekuj si të fshehta?

- Po pra. Ne jemi edhe duke e bërë atë përmes mësimeve tona. Por, duhet të shkohet ngadalë dhe, në rend të parë, të luftohen impulset negative të Ego-s, në mënyrë që të mos tentohet keqpërdorimi i tyre?

- Sikur dyshon në mua, mixha Dilë?- I bëra këtë pyetje, sepse ndjeva veten të ngacmuar nga mundësia e frikës së tij për keqpërdorimet e mundshma nga ana ime.

- Nuk dyshoj unë në ty, i dashuri im, por duhet dyshuar në bindjet e tua që ende kanë nevoj të evulojnë. Nuk mjafton vetëm të mendosh se ke arritur ndryshimin, por duhet të jesh të sigurt se i ke xhveshur rrobat e vjetra në tërësi. Një fjalë jona e urtë popullore thot: "*Në rend të pare duhet të jesh e tek pastaj të kesh"* Ndërrimi i rrobave të vjetra nuk bëhet menjëherë, por ngadalë dhe parcialisht. Edhe transformimi i ngadalshëm, hap pas hapi, është një ndër ligjet esenciale të veprimit të shpirtit. Ndryshimi i shpejtë shkakton tendosje psikike dhe frustracion, prandaj duhet të shkohet ngadalë dhe plotësisht pa inponime e dhunti intelektuale. Kjo ma përkujton atë shembullin me këngën: E dëgjon me vëmendje një këngë të bukur disa herë dhe, një ditë, spontanish, fillon ta këndosh melodinë dhe tekstin e saj. Pra, ajo është pranuar nga qenia jote dhe vetvetui ka filluar të veprojë. Ti nuk i ke inponuar vetes dhuntinë e mësimit të këngës me çdo kusht, por e ke mësuar vetvetiu dhe, si të thuash - pa dashas. .

- Më duket se tani e kam të qartë në tërsi.

- Ne edhe jemi duke i ndërruar rrobat e tua të vjetra, por shumë ngadalë dhe sigurt. Shpirti është mendja e ndërvetëdijshme dhe kjo mendje e thellë përsëri duhet të jetë e tërësishme përmes këndvështrimit të ri dhe nga ndjenja e të menduarit të ndryshueshëm. Ne e dimë se bota jonë, si realitet fizik, është e përsosur, andaj nuk mund ta vështrosh këtë botë ashtu derisa nuk arrihet edhe përsosshmëria në veten tënde. Ti tani e ke të qartë plotësisht logjikën e krijimit që e analizuam gjer tani, ke

njohuri edhe për veprimin e disa ligjeve dhe sa më shumë i ke të qarta këto, aq më shumë je zotërues i aspektit të caktuar jetësor.

- E ndjej, mixha Dilë, se je i lodhur dhe për sot duhet të jetë mjaft. Por, gjersa ishe duke folur për urtinë e lashtë të magjisë, mua m'u kujtua një frikë e madhe që kishte nëna ime nga magjitë ose, si i quante ajo, "sehiret". Gjithmonë frikohej dhe kishte disa lutje me të cilat i largonte nga shtëpia këto ndikime të mundshme. E unë, gjithmonë i kam kundërshtuar këto bindje të saja për magjitë, duke i konsideruar si "dokra" dhe trillime të vetëdijes së ulët njerëzore. Tani pas disa mësimeve të tua, sikur filloj të kem një vështrim më të reviduar rreth ndikimit të mundshëm të tyre. Më thuaj, mixha Dilë, sa janë të vërteta këto dhe sa është i mundshëm ndikimi përmes maxhisë së zezë tek të tjerët?

- Tashi ti sikur ke hyrë pak thellë në këto çështje. Me çdo kusht kërkon të dish disa gjëra për të cilat të kam thënë se duhesh përgatitur edhe ca... edhe disa rroba të vjetra të kanë mbetur nga trupi dhe ... - U ndal këtu pak dhe nga buzëqeshja e tij e lehtë vërejta se do të ishte i disponuar të fliste edhe për këto "tema tabu".

- Mirë. Do të tregoj ligjshmërinë e veprimit të dukurisë së ndikimit tek të tjerët, me kusht që të më premtosh se nuk do të insistosh t'i dish teknikat që praktikohen gjatë këtyre ritualeve.

- Të premtoj, - thashë; - por, më brengos dyshimi që ti ende ke tek unë!

- Tanimë e di se magjia ka dy orientime të veta dedikuese. – vazhdo, pa e përfillë vërejtjen time që ia bëra - Ato, varësisht se nga cila forcë dominuese e të kundërtave shfrytëzohen, ndahet në: “magjinë e zezë” dhe “magjinë e bardhë”. Përmes magjisë së zezë bëhet ndikimi psikik i një personi në një person tjetër me qëllim që atij t’i shkaktohen ndryshime të pavullnetshme negative psikike që do të shprehen edhe në planin fizik. Ndërsa, magjia e bardhë nënkupton veprimin e caktuar, por në formë të kundërt. Bëhet ndikimi i vullnetshëm psikik tek një person tjetër për qëllime të përmirësimit të disa rrethanave të caktuara në planin fizik dhe të ndryshimit të disa vetive të personalitetit të tij në planin psikik. Magjia e zezë kryhet nga personi i caktuar që disponon me aftësi të jashtëzakonshme të ndikimit psikik nga larg dhe quhet magjistar. Këta persona aftësinë e e ritualit të magjisë së zezë e kanë të lindur ose të arritur përmes trashëgimisë , gjegjësisht përmes ushtrimit në shkollat e caktuara të edukimeve shpirtërore, të quajtura “vëllazëri”. Praktika ka treguar se shumica e këtyre njerzëve, aftësinë e tyre për magjistari e kanë vërejtur pas ndonjë sëmundjeje apo krize psikike.

Rituali i magjisë së zezë mund të kryhet në mënyra direkte, ku do të mjaftonte vetëm emri, emri i njërit prind nga viktima, dhe në mënyrë indirekte. Mënyra indirekte e ndikimit psikik bëhet përmes sendit fizik ndërmjetësues. Si send ndërmjetësues fizik zakonisht kërkohet fotografia, copa e thoit, qimja e flokut, copa e veshjes intime që është bartur një kohë nga viktima, gjaku - zakonisht nga femrat

kërkohet vata e mbeturinës menstruale etj. Njëra ndër metodat më të rëndësishme teknike të kryerjes së magjisë së zezë është vizuelizimi - u ndal këtu dhe, duke ma bërë me gisht, sërish vazhdoi - tani ti e ke të njohur teknikën e zbatimit të vizuelizimit tek realizimi i dëshirave jatësore.

- A është zbatueshmëria e procedurës së vizuelizimit, të cilën e mësuam ne, njëjtë edhe tek magjia e zezë? - pyeta, pa e fshehur interesimin tim të madh për këtë njohuri, një kohë të gjatë tejet kontestuese në bindjet e mia?

- Plotësisht e njëjtë, me kusht që gjatë zbatimit të saj, varësisht nga traditat e ndryshme, të praktikohet edhe rituali i caktuar. Shpeshherë merret dylli dhe nga ai formohet një kukull me të cilën personifikohet personi tek i cili kryhet ndikimi psikik përmes magjisë së zezë. Në kukull vihet sendi fizik i tij, që më parë i siguruar, siç ishte thoi, qimja e flokut etj.

- Pse bëhet ky ritual, mixha Dilë?

- Thjesht për të forcuar koncentrimin e magjistarit në një cak të caktuar nga njëra anë dhe për ta magnetizuar kukullën nga dylli me energjinë e mbështjellësit energjetik të trupit të personit të caktuar. Thamë më sipër se trupi i çdo gjallese është i mbshtjellë me mbështjellës energjetik i cili quhet AURË. Pasi sendi “i siguruar” është send intim i atij personi, atëherë ajo përbën elementin energjetik të aurës së tij ose të saj. Magjistari, më pastaj, fillon në mendje ta vizuelizojë ngjarjen e cila duhet t’i inponohet personit tek i cili kryhet ndikimi dhe me ritual të caktuar indukon, ose e projekton këtë figuracion psikik në kukullën

prej dylli. Të gjitha këto rituale që i zbaton magjistari nuk janë asgjë mistike dhe mbinatyrore, por i përdorin ligjshmëritë e njohura të vizuelizimit psikik, të përjetimit të fortë emocional dhe të ligjit të indukimit, gjegjësisht të projektimit të dëshirës kah sendi i caktuar fizik. Në realitetin tënd fizik këtë shembull mund ta krahasojmë me magnetin i cili kur të përkohet me një copë tjetër hekuri, edhe ajo merr vetitë magnetizuese të magnetit. Pasi të jetë kompletuar rituali i caktuar, shpeshherë, sendi i viktimës, tanimë i "magnetizuar" me porosinë e re, i jepet porositësit, i cili këtë send duhet ta vendosë diku në afërsi të atij personi. Çka ndodh këtu tani? Mbështjellësi energjetik i personit të caktuar, gjegjësisht i viktimës, e njeh materialin e vet energjetik nga sendi dhe atë e absorbon së bashku me elementet e reja të futura përmes magnetizimit të tij me vizuelizim. Kur e tëra kjo të futet në ndërdijen e tij, si "larvë energjetike" qëndron në aurën e tij gjersa të vie momenti i caktuar i realizimit në planin fizik. Sa do të zgjasë koha e realizimit të kësaj do të varet nga aftësia e magjistarit dhe fuqia e magnetizimit të dëshirës në sendin e caktuar ndërmjetësues.

- A ka metoda të zbulimit dhe të evitimit të këtij ndikimi të padëshirueshëm psikik që është kryer përmes magjisë së zezë?

- Ka, dhe janë tejet efikase, me kusht që të bëhet nga personi i caktur i cili i njeh ligjet e psiko-magjisë së bardhë dhe ka eksperiencë të caktuar praktike në këtë drejtim. Ai përmes zhytjes vetanake në gjendjen e caktuar

psikike, që ne zakonisht e quajmë “trans”, hyjnë në ndërdijen e atij personi dhe, në këtë gjendje, hulumton larvën e padëshiruar që ka depërtuar në atë vend pa dëshirën e tij. Zakonisht, në këto situata, zbatohet edhe metoda e Hipnozës, duke e hipnotizuar viktimën, dhe në këtë gjendje psikike kërkohet nga ai që vetë ta zbulojë ekzistimin e kësa larve.

- Shumë intereste, mixha Dilë! Shumë interesant! Tani sikur edhe ti më ke hipnotizuar. Shumë gjëra nuk i kam ditur dhe sikur mos të ishe ti kurrë nuk do t’i dija... - me të vërtetë pas këtyre sqarimeve mbi magjinë e zezë nga ana e mixhës Dilë, unë sikur isha i hipnotizuar. Isha “shndërruar i tëri në vesh” siç thotë populli.

- Mirë, mixha Dilë, a mund të ndikojmë tek të gjithë përmes ritualit të magjisë së zezë? A ka ajo efekt të njëjtë tek të gjithë dhe, nëse po, si janë gjasat që në mënyrë preventive të mbrohemi nga këto sulme të padëshirueshme psikike?

- Pyetje e qëlluar!- brohoriti mixha Dilë.

- Ndikimi psikik përmes magjisë së zezë mund të bëhet gati te të gjithë personat, me kusht që ata, në rend të parë, të mos njohin paraprakisht teknikat mbrojtëse nga ky ndikim.

- Egzistojnë edhe teknika të mbrojtjes? - pyeta i befasur. - M’i trego, të lutem. Patjetër që do të kisha dëshiruat t’i zbatoj edhe unë në praktikë.

- Format e mbrojtjes nga ky ndikim janë të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Së pari, të

pavetëdijshmet. Këtë formë mbrojtëse e ka çdo individ, i cili nuk beson sinqerisht në funksionimin e magjisë së zezë. Me këtë mosbesim ai formon barrierë të fortë energjetike të karakterit të tij, prandaj dëpërtimi i ndikimeve tjera nga jashtë është gati plotësisht i pamundur. Zakonisht, këta janë persona me vetëbesim të fortë të shprehur në vetvete. Nga ana tjetër, mbrojtja e vetëdijshme kryhet përmes ritualeve të caktuara të psiko-magjisë së bardhë.

- A do të ma tregosh së paku njërën prej këtyre, mixha Dilë? Ndoshta do të kem nevojë që edhe unë ta zbatoj atë gjatë jetës sime?- e pyeta.

- Patjetër; - konstatoi. - Mbrojtejen e vetëdijshme e bëjnë zakonisht personat që punojnë dhe i zbatojnë metodat praktike të psiko-magjisë; edhe ata shpeshherë janë të rrezikuar nga ndikimet negative dhe të qëllimshme të rivalëve të vet. Njëra ndër mbrojtjet më efikase është që shpesh përmes vizuelizimit ta parafytyroni një dritë mbështjellëse me ngjyrë të kaltër rreth trupit tuaj. Drita mund të jetë edhe në formë të thesit, ku ju hyni mbrenda dhe, në krye, e lidhni atë nyje. Gjatë zbatimit të këtij rituali, përmes parafytyrimit, gjithnjë mund ta përcillni edhe me lutje të caktuar. Ja, p.sh.: “ *Unë vendosem në këtë strofulënl time hyjnore dhe në të nuk mund të depërtojë asnjë ndikim nga jashtë. Asnjë ndikim, edhe pse nuk do të jem i vetëdjishëm për këtë.”*

- Duke e shtjelluar magjinë dhe ndikimin psikik, ndërkohë m’u kujtua fenomeni i mësyshit. A vepron

mësyshi? Dhe; nëse vepron, mendoj se do të duhej të kategorizohej në radhët e magjisë dhe të ndikimit psikik .

- Mësyshi vepron dhe është fenomen shumë i shprehur në jetë. Pleqtë tanë, edhe pse nuk e kanë njohur shpjegimin e vërtetë të këtij lloji të ndikimit psikik, ata gjithnjë janë friksuar nga ajo. Veçanërisht ndikimi i tij ka qenë i shprehur tek fëmijët dhe është përgaditur ruajtja e tyre nga veprimi i tij, pastaj tek martesat, te ndërtimi i shtëpsë së re...etj. Ke të drejtë! Është njëfarë forme e ndikimit psikik tek të tjerët, por nga magjia rituale ajo dallon, sepse veprimi kryhet në mënyrë të pavetëdijshme prej një personi të caktuar tek personi tjetër. Te mësyshi nuk ka parapërgaditje, por vetë energjia e madhe e akumuluar në formë të xhelozisë, urrejtjes, mënisë... etj, në kontakt të drejtpëredrejtë ose në mënyrë indirekte, përcillet tek personi i caktuar. Kur kemi të bëjmë me kontaktin e drejtpërdrejtë, ai gjithnjë bartet përmes syve që ndryshe në literaturën tradicionale quhet " shikimi fiksues".

- Shikimit fiksue?- pyeta i befasur dhe m'u kujta thënia e shpeshtë e nënës "ruaju, bir, nga mësyshi dhe sytë e këqij" - Edhe nëna gjithnjë ma tërhiqte vërejtjen që të ruhesha nga mësyshi dhe shikimi i keq. Mos është mu kjo, që ti e quan si "shikim fiksues"?

- Po, pra. Mu kjo është ajo që e quajtëm " shikim fiksues" ose mësysh dhe ajo përcillet përmes syve?

- Pse mu përmes syve?

- "Sytë janë pasqyra e shpirtit" thotë me të drejtë një fjalë e urtë popullore. Syri është një shqisë e

rëndësishme përmes së cilës shpirti në trupin tonë e njeh dhe kontakton me botën e jashtme materiale.Medicina bashkëkohore e shpjegon në detaje fiziologjinë dhe anatominë e këtij organi të rëndësishëm të njeriut, andaj, në këtë rast, ne nuk e kemi qëllim që ta bëjm këtë. Bebëza e syrit, përveç se reagojnë në signalet dritës dhe e modulonë atë, ato janë edhe regjistruese të gjendjes emocionale të njeriut. Andaj, përmes syve munt të regjistrohen edhe emocionet momentale të njeriut.

"Fytyra ka mundësi të gënjejë, por sytë kurrë", përsëri thotë një fjalë e urtë popullore. Ashtu edhe është. Nëse kemi ndonjë përjetim të fortë emocional, atëherë bebëzat e syve zgjerohen në mënyrë jonormale më shumë se normalisht. Këtë dukuri e njeh mirë medicina bashkëkohore, por para saj, e kanë njohur edhe shumë tregtar të urtë të cilët me vështrimin e bebzave të syrit të blerësit, kanë konstatuar se a e ka pëlqyer ai mallin që shite apo jo, andaj, në bazë të këtij vlerësimi aa kanë përcaktuar çmimin e ofertës. Këtë reagim të bebëzave të syrit nuk e kan ditur vetëm tregtarët shitës, por edhe ata që blenin, prandaj në situatat e vendosjes gjatë shitblerjes, këta të fundit qëllimisht mbanin syza me thjerrëza të errësuara, me qëllim që nga bebëzat e syve shitësi, të mos ketë mundësi ta regjistrojë disponimin e tyre.

- Dihet mirë se bebëza e syrit zgjerohet dhe zvogëlohet edhe nga reagimi i dritës. A nuk është kështu mixha Dil?

- Se bebëzat e syrit zgjerohen dhe ngushtohen me reagimin e dritës dhe të gjendjes emocionale të njeriut tanimë nuk është kurrëfarë zbulimi sensacional. Por, fjala është tek dukuria tjetër, ajo të cilën shkenca nuk dëshiron ta pranojë se është e mundshme, ndërsa, praktikantët e shkollave shpirtërore e njohin dhe e kanë të ushtruar. Fjala është për zgjerimin e vetëdijshëm të bebëzave të syrit pa ndikimin e të dy rrethanave të cekura si më lart. Kjo mbështetet në zgjerimin e bebëzave të syrit sipas vullnetit dhe dëshirës në momentin e nevojshëm.

- Çka do të thotë kjo? - u nguta ta bëj këtë pyetje.

- Pikërisht kjo do të thotë " shikimi fascinues" që e përmendëm më parë.

- Si mund të realizohet "shikimi fascinues"? A është ky vetëm talenti i disave apo shkathtësi që mund të ushtrohet nga çdo praktikant?

- Nuk është talent. Edhe pse shumica, në situata të ndryshme, përms mënyrave të caktuara, këtë lloj të shikimit e praktikojnë pa vetëdije, pa ditur fare se pikërisht vetë fuqia e këtij shikimi, ka ndikuar që në rastin konkret ta shkaktojë fascinimin e dikujt. Prandaj, nuk mund të thuhet se është një shkalltësi e lindur. Shumë lehtë mund të mësohet dhe ushtrohet nga çdokush..

- Thua nga çdokush ? - pyeta i gëzuar, sepse, sa here që mësoja nga mixha Dilë ndonjë teknikë praktike të ushtrimit shpirtëror, gjithmon i ushtroja me pasion atodhe arrija një përparim të dukshëm në këtë drejtim. Po ashtu, ushtrimet praktike të dukurive shpirtërore më bindnin në

vërtetësinë e të gjitha parimeve të shtjelluara gjatë mësimeve të gjertanishme.
Ai e kishte kuptuar mire qëllimin e pyetjes sime dhe m'u përgjigj:

- Po, po nga çdo kush. Edhe nga ti, ha ha ha …
- Atëherë, ma mëso si ta ushtroj edhe unë këtë shikim, mixha Dilë?
- Patjetër, me kusht që ta kesh gjithnë për bazë veprimin e Ligjit të KARMËS nga ndonjë keqpërdorim eventual. Posaçërisht do të ishte vërejtje serioze që ushtrimet e kësaj teknike kurrë mos t'i praktikosh me fëmijë.

Kësaj here u ndjeva pak i prekur nga një dyshim i tillë i mixhës Dilë

- Ehhhe…përsëri ke dyshim në mua?
- Jo aspak! Vërejtja e shprehur për diçka nuk do të thoja se është edhe dyshim, por vetëm një konstatim se duhet të kesh kujdes. Mënyra e ushtrimit dhe e zbatimit të teknikës së "shikimit fascinues", ka qenë e ruajtur me shekuj si fshehtësi e madhe. Unë personalisht atë e kam hasur vetëm në një literaturë të vjetër e cila fare nuk është në qarkullim të lirë.
- Të betohem mixha Dilë se unë…
- Mirë, mirë! Dakort!- më ndërpreu arsyetimin tim dhe vazhdoi - Ulu në një vend të qetë të dhomës tënde dhe fillo të shikosh diçka të afërt. Do të vëresh se bebëzat e syrit janë më të mbyllura. Menjëherë vështrimin përqëndroje në një objekt të largët. Do të vëresh se bebëzat

e syrit zgjërohen. Amatorët e fotografisë e dinë se blenda e objektivit të kamerës fotografike, gjegjësisht filmike, për objekte të largëta gjithmonë hapet, kurse për ato të afërta mbyllet. Nëse do ta kishim të kundërtën, atëherë, me blendën e hapur të objektivit, do të kishim rezolucion të turbullt të fotografisë, dhe e kundërta. Në këtë princip, në mënyrë natyrale funkcionojnë edhe sytë.

- Si ushtrohet ky lloj shikimi?

- Shumë lehtë dhe tejet thjesht.Vëreni gishtin tregues para syve, në një largësi prej 30 cm. Shikojeni ate qartë para vetes dhe për momentin drejtojeni shikimin kah një objekt paralel, por shumë më larg gishtit tuaj. E shikoni se si gishti që e keni para vetes turbullohet, kurse objekti tjetër paralel, larg përtej gishtit, doket më i qartë. Këtu, pra, është fshehtësia! Të shikosh në mënyrë të fiksuar në sytë e dikujt afër, por shikimin ta qartësosh shum më larg. Pra, me shikim dëpërtues përmes syve, por përtej, duke shikuar shumë më larg.

- Më parë the fshehtësia?! Nuk shoh këtu kurrfarë shkaku për ndonjë fshehtësie aq të madhe, saqë ajo të ruhet me gjelozi nga të tjerët?

- Zakonisht kur thua se diçka është e fshehtë, në mendjen e një kuriozi shkakton një paragjykim se ke të bësh me diçka të komplikuar, por, në praktikë gjithnjë është e kundërta. **Madhështia është përherë në thjeshtësi**. Të kujtohet zbulimi më i madh i cili ka bërë revolucion në zvillimin dhe përparimin e njeriut gjatë historisë? Ishte

rrota. Sa e thjeshtë është rrota, por, sa e sa mileniume është dashur që të zbulohet nga mendja e njeriut?

- Po, ashtu është mixha Dilë, ndër zbulimet më të mëdha në historinë e zhvillimit njerëzor ka qenë rrota?

- Edhe pak t'i kthehemi kuptimit të shikimit fiksues. Qëllimi i këtij ushtrimi është që ti me vetëdije të bësh hapjen e bebëzave të syrit. Kur në momentin e caktuar qëllimisht hapen ato, atëherë fillon qarkullimi më i madh dhe më I lirshëm i energjisë së mendimeve në formë të valeve elektromagnetike. Logjika është e thjeshtë: sytë kanë mbarime shumë të shprehura dhe të ndieshme nervore, andaj, ata, jo vetëm se i regjistrojnë vizuelisht objektin me konturat e tij, por, me bashkëbiseduesin ose bashkëbiseduesit tjerë, bëjnë shkëmbimin e mendimeve që janë forma elektromagnetike. Kështu është edhe me MËSYSHIN që ka të bëjë pikërisht me shikimin fascinues. Fëmija i shëndoshë dhe çdo gjë e bukur shikohet me emocion dhe ajo gjendje emocionale përmes bebëzave të hapura të syrit, bartet lehtë dhe shpejt tek bashkëbiseduesi. Merre shembullin e personit të dashuruar? Si e shikon ai një femër tek e cila është dashuruar? A nuk ke dëgjuar shpesh në popull kur thuhet se " Të dashuruarit merren vesh me sy!".

- E kam të qartë, por pse për mbrojtje nga mësyeshi vihen guraleca të ndryshëm të kaltër, hudra ose gjësende të tjera ?

- Po pra, vëhen gjësende të ndryshme dhe besohet se ato mbrojnë nga mësyshi. Është plotësisht e saktë se

këto simbole e kanë efektin e vet të mbrojtjes nga mësyshi, sepse e tëhekin shikimin e parë fascinues të bashkëbiseduesit, që si emocion i caktuar nga befasia e momentit, në fillim është i fortë. Thjesht, qëllimi është që emocioni i caktuar përms shikimit të parë, të mos orjentohet kah personi që mbrohet, por vëmendjen e tij duhet ta tërheqë ngjyra, era ose pamjea e sendit që ai person e bartë në vete.

- Domethënë, fare nuk është me rëndësi se çfarë sendi mbrojtës mban me veti . Kryesorja është që me atë simbol ta tëheqësh vetëm shikimin e parë fascinues të bashkëkontaktuesit që për momentin është i fortë?

- Jo, nuk është me rëndësi, por më e preferueshme është që të vehen gjithnjë simbolet që në poull, apo në rreth të caktuar, njihen dhe janë të popullarizuara si mbrojtje kundër mësyshit. Në to, brez pas brezi, me shekuj është koncentruar energjia e madhe e besimit, prandaj supozohet në efikasitetin më të madh mbrojtës të tyre .

- Shpeshherë për mësysh, dikur nëna më mbështillte pak kripë të kuzhinës në një letër ose në një leckë dhe kërkonte nga unë që atë ta mbaja në xhep. Bazuar në këtë logjikë, ende nuk më duket e qartë , se pse ajo e bënte këtë, kur lecka apo letra fare nuk shihej në xhep dhe nuk mund ta tërhiqte shikimin e pare të bashkëkontaktuesit…

- Ha ha ha… Nëna jote, edhe pse vepronte me të drejtë, nuk e dinte shpjegimin e vëretë të këtij veprimi. Kripa e kuzhinës në praktikë është treguar si substancë e cila tërheqë valët elektromaknetike që arrijnë në formë të

mendimeve, dhe ato nuk i len që të depërtojnë në deponë e madhe të ndërdijes tonë. Me shikim fascinues, në formë të valëve elektromagnetike, barten emocionet e forta negative dhe besohet se kripa ato i akumulon. Shumica e praktikatëve të ushtrimeve shpirtërore në vete mbajnë kristale natyrore të llojeve të ndryshme, të cilat konsiderohen si substanca mbrojtëse nga valet elektromagnetike negative që dërgohen me qëllime të këqija nga bashkëbiseduesit tjerë eventualë.

- Jo, jo këtë nuk e kam ditur dhe më befason. Më duket se është e kapshme nga një logjikë e shëndosh?

- Edhe disa shtazë e kanë shikimin fascinues tejet të zhvilluar. Këtu paraprin gjarpri. Ai në fillim me fiksimin e shiimit të vet në sytë e viktimës, e fascinon atë, dhe tek ateherë e sulmon prenë. T'i kthehemi edhe për pak çaste teknikës së shikimit fascinues. Që ta kesh në përdorim praktik, ushtroje disa ditë sikur me shembullin e sipërcekur me gishtin. Të njëjtën mund ta bësh edhe në pasqyre duke i fiksuar sytë kah portreti vetanak. Mos gabo kurrë të ushtrosh me të tjerët, posaëërisht me fëmijët, sepse nga pakujdesia mund t'iu shkaktohen pasoja të paparashikueshme. Gjithnjë ushtro në pasqyre me portretin vetanak. Nuk do ta kesh vështirë! Të kuptuarit e metodës është e thjeshtë: **" KE DIÇKA NË FOKUSIN E SHIKIMIT AFËR, POR, NË REALITET, PËRTEJ ATIJ OBJEKTI SHIKON DIÇKA SHUMË MË LARG. PRA, ME SHIKIM DËPERTON PËRTEJ OBJEKTIT QË E KE AFËR"**

- Sikur e kam të qartë...

- Jo aspak nu e ke të qartë! - ndërhyri me shpejtësi mixha Dilë. Ti tani i di si përdoret dhe vepron shikimi fascinues. Di sesi ta ushtrosh edhe përdorimin e saj, por nuk di edhe diçka tjetër?

- Ka edhe diçka tjetër thua në këtë teknikë?

- Patjetër. Si dhe kur duhet ta përdorësh atë si dhe efektet e saj në kontaktet me njerëzit.

- Hhhmmm...

- Shikimi fascinues ushtrohet gjatë bisedës me bashkëbiseduesin dhe gjatë të drejtuarit masës se gjerë, të kesh mundësi të inponimit të mendimeve tuaja dhe kontrollimin në veprime tek të tjerët. Nuk mjafton vetëm të shikosh dëpërtueshëm së syt e dikujt dhe e arrite qëllimin. Përveç teknikës së shiksimit të syve, duhet që të dish edhe çka bën me mendimet e tuaja. Pasi i fikson sytë e tu në sytë e bashkëbiseduesit ose me këtë shikim i drejtohesh masës së gjerë përballë, ti përveç fjalëve mbresëlënëse, duhet që mendimet e tua t'i parafytyrosh qartë, dhe tek atëherë t'i bartësh tek bashkëbiseduesi përmes fjalëve dhe shikimit fascinues. Mendimi i thënë, i formuar në kokën tënde, tanimë siç e di, është parafytyrim, vizuelizim i qartë i asaj që kërkohet dhe thuhet. Vetëm kështu si mendim i parafytyruar qartë bëhet valë e fortë elektromagnetike depërtuese.

- Të falemderit, mixha Dilë. Nuk do të lodhi më tepër për sot.Vetëm të njoftoj se që nga fillimi i njohjes sonë, unë përveç afirmimit që ma imponove me truket e

tua... vazhdova t'i bëj vetes edhe sugjestione e afirmime me përmbajtje tejra. Mos po e teproj me këtë?

- Nuk e tepron, dhe vetëm vazhdo. Vazhdo dhe jepi vetes pandërprerë afirmime pozitive. Sa më shumë, aq më mirë. Duke vepruar me sugjestione të afirmimeve pozitive, në mënyrë vijuese, ti fillon të mendosh pozitivish. Pra, ndërron mënyrën e të metuarit tënd të vejtër dhe të gabuar, që është edhe qëllimi ynë...

KAPITULLI IV
Mësimi i tretë te mixha Dilë

Sa më shumë thellohesha në mësimet që i mësoja nga ky palk i urtë, aq më tepër vija në gjendje kur kisha dyshim të plotë në vete: „Vërtetë unë nuk kuptoj asgjë!“

Andaj, me të takuar mixën Dilë në lekcionin tonë të sotëm, fjalia e parë që i thash ishte:

- Unë ende kam paqartësi për disa gjëra dhe ende më duhet ndihma jote.

Këtë konstatim e bëra si me dhemshuri.

- Dija nuk ka kufi, miku im, prandaj duhet ta kesh për bazë gjithnjë një urtësi të vjetër, e cila thotë: *“Mos i beso atij që thotë se e kam gjetur të vërtetën, por besoji atij që thotë se e kërkoj të vërtetën!”*

Për momentin, mbretëroi një qetësi, gjersa atë nuk u ndërpreu reagimi spontan i mixhës Dilë:

- Uaaa, gati harova! – bëri me gisht tregues kah koka dhe u ngrit me të shpejtë. Nga komodja, e vendosur përballë nesh, nxori një bllok në formë notesi. Fletorja kishte një dizajn të bukur me kopertina të lëkurës.

- Këte e ke dhuratë nga unë.

- Më ke ngushtuar mixha Dilë.

- Tani e tutje të këshilloj që të mbash shënime. Shumë gjëra do të kesh nevojë t'i përkujtosh më vonë.

- Shumë pjesë të vlerësuara si më të rëndësishme të ligjëratave tuaja të mëparshme, kur kthehesha në shtëpi, i regjistroja në një fletore.

- Ke vepruar drejt. Tani e tutje duhet të shënosh menjëherë, aty për aty. Do të ishte mirë që të mbash edhe një ditar personal.

Nuk fola asnjë fjalë. "Ide e shkëlqyeshme"- mendova. Menjëherë hapa me kujdes notesin e ri. Nxora lapsin nga xhepi i bredshëm i xhaketës dhe në fillimin e faqes së re shënova datën e ditës së sotme.

Mixha Dilë, pasi u kollit disa herë, m'u drejtua:

- Je gati? Mund t'ia nisim?

Me kokë dhashë shenjë pohimi.

- Tanimë e ke të qartë se njeriu, si qenie më e përsosur në makrokosmos, me konstruksionin e vetë të ndërlikuar është një mikrokosmos në minjaturë. Ai, si i tillë, është i ndërtuar nga të dy të kundërtat e veta strukturale. Është, pra, qenie fiziko-materiale dhe psikike jomateriale ose metafizike. Në mesin e këtyre dy të kundërtave, si produkt i veprimit të ndikimit të tërsësisë

unike, është mendja që vetëdijëson këtë proces të përhershëm të veprimit ekzistencial dhe ate do ta quajm si TRIADË.

- Triadë?

- Po, triada struktuarle trup-mendje-shpirt, por kjo do të jetë vetëm nga aspekti i ngushtë kuptimor. Në rrugën e mëtejmë të vetëdijësimit edhe më të madh për ndërtimin e qenies sonë, vetëm kjo ndarje, që ne e bëmë, është e përgjithësueme. Në tërësinë e qenies sonë ka edhe shtresa të tjera strukturale të ndërtimit. Edhe pse të papranuara nga shkenca zyrtare, ato janë të njohura për urtësinë e lashtë tradicionale.

- Ekzistenca, që ne e quajmë jetë, në manifestimin e saj të vërtetë e ka burimin nga bërthama qendrore e një niveli të lartë të përsosshmërisë hyjnore. Andaj, të gjitha forcat dhe kualitetet, që i përshkruhen kësa përsosshmërie, janë prezente vetëm atëherë kur jeta del në sipërfaqe nga kjo strofull hyjnore. Këto kualitete dhe forca janë zhvilluar shumë ngadalë. Ato, si trusni e pandërprerë e vullnetit hyjnor, më vonë fillojnë të funksionojnë përmes ndikimeve të forta që vijnë nga jashtë si fuqi evolutive - ekzoterite dhe nga brendësira si forca - ezoterike. I tërë Universi ose sistemi ynë solar është një hapësirë e madhe dhe e pakufijshme e evolucionit. Ky sistem në konstruksionin e vetë është i shtatëfishtë dhe përfshin botën materiale bashkë me gjashtë shtresat tjera si gradacione progresive të materies, që ne do t'i quajmë si plane ose nivele. Edhe pse i quajtëm si shtresa apo nivele, ato nuk duhet kuptuar

vërtetë si shtresa të paluara, por logjikisht duhet t'i nënkuptojmë si gjendje psikike, të cilat, mendja jonë, si tërësi ekzisteniciale, i përjeton përmes qenies së plotë. Natyrisht se planet apo nivelet nuk janë vende të caktuar ku mund të udhëtohet, por në fakt përjetimi i tyre është vetënjohje e thellë, ku arrihet përmes ndritjes. Ato ekzistojnë dhe veprojnë si tërësi unike dhe jo ashtu siç e përshkruajmë ne ndaras. Përmes ushtrimeve dhe formimit të bindjeve të caktuara për realitetin tonë, arrihet vetëdijësimi gradual për të gjitha këto nivele. Me arritjen e pranisë shpirtërore të vetëdijësimit mental të këtyre niveleve, paralelisht bëhet edhe aktivizimi i qendrave të caktuara fizike që i përgjigjen vetënjohjes sonë për to. Këto qendra janë të vendosura në bazën fizike të amës komanduse të gjendjes së ngurtë të trupit, e quajtur si tru apo sistem nervor. Pra, materie e fisnikëruar në atë nivel që të pranojë dhe që të dërgojë impulse elektromagnetike si nga bota e jashtme e realititit tonë fizik kah brendësia e shpirtit tonë si vrojtues, ashtu edhe nga jashtë, si trysni e brendësisë sonë hyjnore si inteligjencë e paskajshme. T'i cekim me rend: Niveli më i afërt i ndërtimit të ngurtë fizik është plani astral, në të cilin hyjmë gjatë gjumit dhe vdekjes fizike. Kjo është një shtresë substile e ndjenjave, e emocioneve dhe e dëshirave tona. Pas asaj astrale, plani tjetër më i lartë është niveli mental. Ne e kalojmë jetën më së shumti në këtë realitet dhe përmes tij jemi të vetëdijshëm për të gjitha realitetet tjera. Këtu bëjnë pjesë aftësitë dhe

shkathtësitë e shumta të procesit të të menduarit, të fantazisë, të planifikuarit etj…

Mu këtu, kur mixha Dilë fliste për këto dy plane, unë i ndërpreve shënimet që i kisha filluar dhe ktheva shikimin kah ai. Pasi me këtë veprim e kishte vërejtur tendencën time se doja ta pyesja diçka, duke më bërë si shenjë me dorë që të mos ndrhyja, vazhdoi më tej:

- Ky plan është i ndërtuar nga dy shtresa. Dy planet, që e ndërtojnë atë, janë: plani i ulët mental dhe plani i lartë mental. Për ty këto dy pjane janë të njohura me termine që kanë domethënie më të përgjithsuar: ai i ulët mental, si vtetëdije, kurse ai I lartë mental, si ndërvetëdije. Pas planit mental, vjen plani intuitiv që lartësohet në fishet shtresore të qenis sonë hyjnore. Në literaturën e urtësisë së okultizmit, ky plan quhet BUDDHI. Pas planit Buddhi ose intuitiv, vjen niveli më i lartë i planit ATMIK, ANUPADAKA dhe si nivel i shatëtë, gjegjësisht i pari nga burimi, është plani ADI. Kjo besoj se do të jet e mjaftueshe gjat kësaj faze të ngritjes tënde shpirtërore.

- Në të vërtetë, këto shtatë shtresa, gjegjësisht plane i pate cekur edhe në ligjërat e kaluara.- bëra këtë vërejtje

- Po, dhe i përsëris sërisht për të arritur aty ku dëshiroj të dal.- ishte decidiv në këtë qëndrim dhe vazhdoi - Për të hyrë më thellë në shtresimet konkrete, na duhej paranjohje dhe një kulturë më e gjerë e formimit të koncepteve të qarta logjike për mendime abstrakte të operimit. Disa shtegëtarë në rrugën e nisur të vetënjohjes, kënaqen me këtë njohuri, pa dashur të vazhdojnë edhe më

tej. Tek ti vërejta se nuk të mungonte jo vetëm interesimi për këtë ngritje, por kishe edhe bazë paraprake të një talenti të lindur. Duhet të shkojmë gjer në fund…

- Sikur nuk ka kthim nga kjo rrugë,- ishte konstatimi im i prerë si ndërhyrje.

- Vërtetë, nuk ka kthim prapa. Ti je duke ecur ngadalë por sigurt kah vetëdijësimi i plotë për shumë shteresa të planeve tona të ndërtimit qenësor. Pa më thuaj, çfarë shkrove në atë fletore? Cilat ishin shtatë fishet e planeve ose niveleve të ndërtimit të qenies sonë?

Mu duk si një pyetje e befasishme. Pasi i kisha të shënuara, fillova t'i lexoj:

- Hm, fizik, astral, mental, intuitiv ose buddhi, anupadaka, atmik dhe adi…

- Shkëlqyeshëm! Mjafton ti mbash mend me këtë renditje. Përveç njohurisë së përgjithshme (se qenia jonë përbëhet nga dy të kundërtat e saj qenësore: e para është fizike dhe tjetra psikike, ose shpesh kemi përdorur termin racionale-irraconale, fizike-metafizike etj) , si diçka e re, do të nihemi edhe me një ndarje tjetër gjenerale të ndërtimit të qenies sonë: planet që ndërtojnë personalitetin dhe ato që ndërtojnë pjesën tjetër, të quajtur si individualitet i qenies sonë. Personaliteti ynë ndërtohet nga trupi fizik, mental dhe nga ai astral, ndërsa individualiteti ndërtohet nga shtresa e planit intuitiv, ose buddhi, atmik, anupadaka… Mos u befaso me disa terme në emërtimin e këtyre planeve. Unë i përdora në orgjinale, nga burimet e njohurisë okultike. Nëse në ndonjë literaturë tjetër do t'i hasësh edhe me

emërtime tjera, ato sigurisht kanë domethënie të njëjtë dhe janë vetëm gjuha e kulturës së atij populli nga vjen kjo njohuri e lashtë.

- Pse dhe sa është e rëndësihme ndarja e ndërtimit të qenies sonë në atë të personalitetit dhe të individualitetit?

- Është shumë e rëndësishme! Sa për fillim duhet ta kesh në dijeni se tri plane që e ndërtojnë personalitetin e qenies sonë, me vdekjen, të themi fizike, shkatërrohen dhe zhduken, kurse ne si shpirt vazhdojmë të ekzistojmë vetëm si individualitet me katër shtresa të tjera të mbetura.

Derisa përfundoja me shënimet, mixha Dilë u largua nga dhoma. Sikur diçka kishte harruar.

Pas disa minutash u hap dera dhe miku im hyri brenda me një tabakiere në dorë dhe me dy filxhana të mbushura me kafe.

- Nuk ma zen për të madhe. Edhe pse ujin e kafesë e kisha të vluar, gati sa harrova ta përgatis atë,- filloi të arsyhetohej.

Nuk desha të reagoja në këtë mikëpritje, sepse ndjave vërtetë nevojën për një kafe relaksuese. Pasi e ofroi filxhanin para meje dhe pasi e vuri tjetrën në tavolinë afër vetes, propozoi:

- Ç'thua? Të pushojmë pak? – Ishte propozimi i qëlluar.Vërtetë kishim nevojë për një pushim. Këtë pauzë, që e dëshiruam që të dy, u shpreh në një heshtje totale. Asnjëri prej nesh nuk fliste dhe secili bluante në kokë diçka të veten. Pasi i pimë kafetë, heshtjen e krijuar e theu së pari mixha Dilë:

- Je gati? A mund t'ia fillojmë?

- Ëhë, – më doli ky pohim nga hunda dhe, duke hapur me të shpejtë faqen e re në notesin për shënime, shikimi im i drejtuar kah ai ishte shenjë se mund t'ja fillojmë menjëherë.

- Nga të gjitha planet e ndërtimimit të tërësisë së qenies sonë, niveli më i dendur është ai i planit fizik, të cilin ne më së miri e njohim dhe me te kemi më së shumti punë, gjersa jeta jonë si ekzistencë është e kufizuar në këtë nivel. Që nga lekcionet tona të hershme, ndoshta sipas një renditjeje didaktike, ligjëratat është dashur së pari t'i fillojmë nga trupi fizik dhe që është më i kapshëm nga ti dhe nga të gjithë ne, por këtë shtresë e lash me qëllim diku në mes, pasiqë, në rend të pare, duhej që në bindjet tua kaherë të rrënjosura, të ndryshohen disa botëkuptime kryekput materialiste. Mendova që fillimisht do të ishte më e preferueshme që të inponohet një edukatë bazë më irracionale dhe, tek pastaj, mund të kalohet edhe në shtjellimin e rëndësisë së vetë trupit fizik si përbërse materiale e qenies sonë.

- Edhe unë e kam vërejtur se ti, që nga fillimi, në ligjeratat tuaja, i ikje përherë që ta potencosh materializmin në planin e pare ekzistencial të qenies sonë. Bile, shpeshherë më akuzoje se kisha botëkuptime të tepruara materialiste në njohjen e realiteteve tona ekzistenciale.

- Patjetër është dashur të sillem ashtu, në mënyrë që matirializmi i imponuar me edukatën që nga lindja të mos dominojë kuptim të gjërave që kishin të bënin me

shpirtëroren. E kupton? Gjithnjë kur vlersojmë diçka të re, ne atë e krahasojmë me parime të njohura që kemi në atë moment. E dallojmë zhurmën vetëm pse ishte qetësi, e dallojmë lëvizjen vetëm pse krahasohemi me trupin që nuk lëviz ... e kështu me rradhë. Mendova se duhej luftuar në mënyrë indirekte bindja e shprehur e identifikimit tënd me trupin tënd. Kur do ta njohësh mirë edhe anën tjetër shpirtërore të qenies sate dhe parimet e funksionimit të saj, atëherë edhe trupi fizik, dhe roli i saj, do t'i shikohet nga ti, prej një këndvështrimi krejtësisht tjetër.

- Plotësisht ke pasur sukses në këtë qëllim.

- Rreth konstruksionit të ndërtimit tonë fizk, në shumë mësime dhe shkrime të autorëve të nryshëm, ka mendime se, në krahasim me shtresat tjera irracionale, trupi është niveli më i parëndësishëm, andaj, në njëfarë mënyre, duhej injoruar. Nëse në të ardhmen do të hasësh diku në këso vleërsimesh, ato kurrë mos i prano si të sakta. E vërteta duhet të jetë se trupi fizik gjatë veprimit të tij në planin material është instrument i shpirtit. Trupi është instrument i gjallë dhe jo makinë e pandjeshme. Si shembull nga përvoja, dihet mirë se poseduesi i një istrumenti që e përdor atë për çfarëdo pune, mjetin e vet duhet ruajtur në gjendje të mirë dhe me të duhet të sillet në atë mënyrë që, duke i lejuar atij që shlirshëm dhe pa kurrfar pengesa, t'i kryejë funksionet e veta të dedikuara specifike. Muzicienti, i cili e lë anash dhe nuk kujdeset fare për violinën e tij, është aq i çmendur sa ai që pasionohet pas tij, duke humbur energjinë e kotë në zbukurimet dhe stolisjet e panevjshme.

Në mënyrë që trupi të jetë sa më i ndjeshëm dhe instrument i fortë në vetëngritjen tonë shpirtërore, para se të fillojmë ta studiojmë metodën që duhet zbatuar në kontrollimin e saj, së pari duhet ta kemi të qartë natyrën dhe funksionin e këtij instrumenti. Trajneri i mirë, që e ushtron kalin për t'i shërbuer atij me besnikëri, së pari duhet ta njohë në thelb natyrën e vetë kalit. Gjëja kryesore në këtë drejtim është që të kemi një parafytyrim të qartë rreth konstruksionit dhe anatomisë e trupit tonë… Do të ishte e preferueshme që të kërkosh edhe ndonjë atlas anatomik me fotografitë e ndërtimit të trupit. – bëri këtu një degresion nga tema - Atlasi të nevojitet që ta sforcos parafytyimin për ndërtimin e jashtëm dhe të mrenshëm të konstruksionit tënd fizik. Fiksoje mirë një figurë të një pjese të trupit nga fotografia e atlasit dhe mundohu që atë ta kesh sa më të qartë në parafytyrimin tend mental. Do të ishte e preferuar që të fillosh me pamjen e kokës, duke vazhduar më tej gjer në gjymtyrët e poshtme të trupit. Analizoji me vëmendje të gjitha organet veç e veç dhe mundohu ta kesh njohurinë bazë edhe për fiziologjinë e tyre. Njohja sa më e afërt dhe në detaje e trupit ta forcon bindjen që ta duash dhe ta respektosh edhe më tepër atë.

- Patjetër se do ta gjej Atllasin – ndërhyra, më se i sigurt në vete se ashtu do të bëhet.

- Siç po e vëren,- vazhdoi më tej mixha Dilë, - trupi nuk jemi ne, por ai është një instrument me ndihmën e të cilit shpirti vjen në kontakt me botën e jashtme të realitetit tonë objektiv. Shpirti këtë kontakt e bën permes pesë

shqisave tona, të cilat, gjatë evolucionit, janë përsosur dhe kanë arritur nivelin e tyre të ndërtimit të tanishëm. Se sa jemi të varur nga këto pesë organe fizike, mund ta vëresh edhe nga një eksperiment i vogël. Fillo ngadalë dhe me radhë t'i çkyqësh funksionet e të gjitha shqisave tona dhe do të vëresh se kontakti me realitetin objektiv është ndërprerë në tërësi. Tani, e vetmja gjurmë që na mbetet është kujtesa në gjërat e mëparshme dhe parafytyrimi i eksperiencave të kaluara. Nëse shqisat tona nuk funksionojnë për ta regjistruar drejtëpërdrejt atë, realiteti i tashëm nuk mund të përjetohet si ekzistent. Nëse trupin e shikojmë nga ky kontest, atëherë vërejmë se ai nuk është asgjë tjetër veçse një instrument dhe shërbëtor besnik e shpirtit që në vete kombinon fuksionet e aparatit emitues dhe pranues të informatave të caktuara. Një pjesë e këtyre informatave merren përmes shqisave dhe dërgohen nga realiteti i jashtëm objektiv, kurse të tjerat merren dhe dërgohen nga shtresat tjera të realitetit jomaterial ose metafizik.

Një heshtje për disa sekonda dhe pastaj përsëri vazhdoi me temën e filluar.

- E tani të trajtojmë një kontribut të rëndësishëm që urtësitë e lashta i kanë dhënë njohurisë sonë të përgjithshme të ndërtimit të tërësisë konstruktive të qenies njerëzore. Fjala është për çiftin eterik, apo nëse të kujtohet nga ligjëratat e përparshme, për AURËN si mbështjellëse eterike e trupit me gjendje të ngurtë fizike.
- Po, më kujtohet !

- Ashtu pra. Shkencëtarët tanë modernë, të cilët i kanë kushtuar më tepër se dy shekuj hulumtimit të trupit si gjendje fizike, kanë arritur në të dhëna të thukta për këtë mekanizëm të përsosur. Ata kanë hulumtuar çdo muskuj, çdo asht dhe nerv, organet tona të përsosura funksionale, enët e gjakut, etj. dhe të gjitha të arriturat i kanë evidentuar në katalogët e tyre të prezentimeve shkencore, por edhe pëkundër punës së madhe të kryer, kanë anashkaluar pa e vërejtur edhe pjesën tjetë jomateriale të trupit tonë, që ne e quajtëm AURË. Tek dikur, kah mesi i shekullit XIX, shkencëtari rus, Kirilijani, zbulon kamerën e cila incizon aurën apo mbështjellësen eterike të trupit tonë. Mbështjellësja eterike e trupit shtrihet në një distance prej 7,5 cm nga pjesa e fortë e saj dhe e përbën tërësinë unike të trupit tonë. Funksioni specifik i mbështjellësit eterik është që t'i shërbejë si lidhëse energjisë vitale me trupin. Ajo ka rolin e akumulimit dhe ruajtjes së vazhdueshme të kësaj energjie të cilën e merr më së shumti nga dielli, pastaj nga ajri me frymëmarrje dhe më së paku me ushqim. AURA jonë është mbështjellëse komplekse dhe trup përmes qendrave energjetike të padukshme për shqisa fizike, që quhen qarka dhe janë të vendosura zakonisht afër gjëndrave të tajimit hormonal të organive fizike të trupit. Ekzistojnë gjithësej shtatë çakra dhe ato janë të vendosura afër trupit sipas kësaj renditjeje:

- E para është në maje të kokës, e dyta në ballë, në mes të fillimit të rrënjëzës së hundës, e treta në mes të gabzherit të fytit, e katërta në mes të gjoksit, e pesta në

pleksus, ku fillon pjesa muskulore e lukthit, e gjashta dy gishtërinj nën kërthizë dhe e shtata në fundin e mbarimit të organeve gjenitale. Qarkat, përmes meridianeve, që janë 12, shpërndajnë energjinë vitale në tërë konstruksionin e ndërtimit të trupit së bashku me të gjitha organet tjera funksionale. Vendet, ku përcillet kjo energji tek organi ose pjesa e caktuar e trupit, quhen pika akupukturale, që në trup janë mbi 3000.

- Mos ka të bëjë kjo me shërimin përmes akupunkturës, që kohën e fundit është përhapur shumë tek ne?

- Ka të bëjë pikërisht me akupukturën si terapi tradicionale kineze e cila mbështetet në filozofinë e veprimit të dy poleve të energjisë vitale në trup të quajtur si CHI. Njëri pol i kësaj energjie, si pozitive, quhet JIN, kurse poli tjetër, si negative - JANG. Çrregullimi harmonik i veprimit të këtyre dy energjive të kundërta vitale shkakton sëmundjen e organit ose pjesës së caktuar të trupit. Andaj, medicina tradicionale kineze, e mbështetur në këtë filozofi, përmes futjes së gjilpërave të caktuara në pikat enrgjetike akupukturale, balancon devijimin disharmonik të këtyre dy të kundërtave që kanë shkaktuar sëmundjen dhe kështu vjen deri tek shërimi.

- Përsëri veprimi i Ligit të të kundërtave?

- Po, ashtu është. Mos të largohem aq nga tema jonë konkrete. Trupi, sikurse mendja dhe shpirti, në fuksionimin e tyre si qenie janë të pandashme dhe përbëjnë unitetin e një procedure si tërësi të kontaktit të nivelit të

lartë shpirtëror me botën e realitetit objektiv material. Detyra jonë është që të konstatojmë natyrën dhe funksionimin e këtij instrumenti të shpirtit kah rruga e saj e kontaktit dhe njohjes me realitetin objektiv-material. Sepse, shumë disiplina ekzakte shkencore e kanë përsosur në mënyrë të perfeksionuar njohjen e përbërjes dhe funksionalitetin fizik të trupit tonë.

- Gjatë tërë veprimit të saj në realitetin fizik,- vazhdoi më tej mixha Dilë, - trupin gjithnjë duhet shikuar si instrument të shpirtit. Është istrument i gjallë e jo makinë e pandjeshme, prandaj edhe ai ka ligjshmëritë e veta të funksionimit dhe të veprimit. Nëse e trajtojmë trupin si instrument të shpirtit, atëherë, çfarëdoqoftë ky instrument, përherë duhet ta ruajmë në gjendje të përsosur për t'i kryer me sukses të madh funksionet e veta të komplikuara. Përmes këtij shtjellimi të përbashkët, qëllimi ynë do të jetë vetëm njohja e funksionalitetit të saj, me qëllim që kjo njohje, në mënyrë të vetëdijshme, të ndikojë në kontrollimin e këtyre funksioneve. Gjatë procesit të gjatë të evulimit, ky innstrument, paralelisht me UNI-n, u është zvilluar dhe adaptuar tendencave të procesit të vazhdueshëm të zhvillimit të përhershëm kah e përsosura. Pra, siç e vërejmë, trupi është një instrument bartës, i cili në vete kombinon funksionin e pranimit dhe transmetimit të informative si nga realiteti objektiv në drejtim të UNI-t, dhe anasjelltas. Është tërësisht si një radio-aparat që pranon dhe dërgon sinjale gjatë komunikimit të dyanshëm. Nga bota fizike ajo, përmes shqisave të veta, kap vibracionet e

dritës,zërit etj., duke i bartur ato kah UNI. Në anën tjetër, nga UNI, që është në ndërtimin e vetë trupit fizik, pranon mendime dhe impulse motorike dhe ato, përmes organeve të aksionit, i bart në botën e jashtme. Siç e sheh, edhe pse kemi prirje dhe bindje të rrënjosur për t'u identifikuar me trupin tonë, nuk jemi trup, por zotërues i tij. Mbaje në mend gjithnjë këtë thënie:

"TI NUK JE TI . TI JE TI NË TY!"

- Kontrolli i plotë dhe i vetëdijshëm i funksionimit të trupit si instrument i UN-it tonë? Tani e kam të qartë. Por, si ta arrijmë atë?

- Thjesht, përmes fisnikërimit të ndërtimit të tij që sipas veprimit të procesit të vdekjes dhe krijimit të qelizave të reja në trup është pandërprerë në përtërirje e sipër. Trupi me një përbërje të ndërtimit të fisnikëruar është përques shumë më i mirë gjatë kontaktit të vazhdueshëm ndërmjet UN-it dhe botës materiale.

- Simbas rezonimit tim, si në mësimet e vjetra orientale, ashtu edhe të atyre bashkëkohore, trupi dhe shpirti formojnë një tërësi të pandashme, ndaj edhe kërkojnë kujdes të njëjtë. Trupi është bartës i shpirtit dhe ana tjetër e tij. Çdo çrregullim organik patjetër reflektohet edhe në funksjonimin shpirtëror, dhe e kundërta. Fisnikërimi i saj sigurisht duhet bërë përmes ushqimit dhe zgjedhjes adekuate të përbërjes së saj.

- Për njeriun ushqimi nuk është i rëndësishëm vetëm për ripërtëritjen e qelizave, por është edhe si material energjetik për shumë funksione të tij. Kur trupi një kohë të

gjatë mbetet pa ushqim, ai shpenzon së pari dhjamin dhe shtresat yndyrore të organeve të brenshme, si dhe yndyrat e akumuluara në muret e enëve të gjakut, pastaj indin muskulor dhe në stadin e fundit palcën nga eshtrat dhe indet trupore. Shikuar nga komponentët, ushqimi, që ne zakonisht e përdorim, përbëhet nga proteinat, hidratet e karbonit, yndyrërat, vitaminat dher materiet minerale. Për të ekzistuar, njeriu gjatë jetës ka nevojë të konsumojë sasi të konsiderueshme të ushqimit, i cili patjetër duhet të jetë i përbërë nga pesë komponentet e lartëpërmendura. Përndryshe, mungesa e shpeshtë dhe e gjatë e njerës prej komponenteve ushqyese shkakton sëmundjen, vetasgjësimin dhe në fund vdekjen fizike të trupit.

- Andaj, edhe nevoja e marrjes së ushqimit përmes instiktit të urisë është e fortë tek të gjitha gjallesat në natyrë?

- Për ruajtjen e përhershme të nevojës së ororganizmit për ushqim kujdeset instikti më i forte, i quajtur instikti i urisë. Instiktet, përndryshe, janë nevojë e fortë vetekzistenciale, përmbushja ose mospërmbushja e të cilëve shkakton shkallën e lartë të kënaqësisë dhe, e kundërta, shqetësimin e fortë emocional. Instikti i urisë është instikt më i fortë i vetekzistimit.

- Sa mund ta mbajmë nën kontroll të vetëdijshëm këtë instikt? Si përmbushet kjo nevojë e të ushqyerit?

- Joga dhe traditat tjera të vetaftësimit psikik në Lindje, njohin dhe e zbatojnë vetëm një sistem të ushqyerit - VEGJETARIANITETIN. Në të kundërtën, mjekësia

bashkëkohore thekson se vegjetarianiteti është rruga më e sigurt kah sëmundja, sepse me këtë sistem të ushqimit futen sasi jo të mjaftueshme të proteinave në organizëm. Trupi, theksohet në literaturën medicinale, ka nevojë për sasira të konsiderueshme të proteinave, e një pjesë e madhe e saj duhet të jetë e natyrës shtazore. Pra, këtu mendohet për mishin. Edhe pse pa mish, popujt me traditë të ushqimit vegjetarian në organizëm fusin sasi të mjaftueshme të proteinave, duke u ushqyer me gjëra tjera të natyrës bimore. Ka mendime se shumë familje në Indi lëngojnë nga sëmundje të ndryshme dhe shkalla e vdekshmërisë tek ata është shumë më e madhe, sepse ushqehen me ushqim vegjetarian. Këto konstatime janë të sakta, por jo edhe të sqaruara sa duhet. Kjo dukuri nuk vërehet tek familjet e pasura indiane, por vetëm tek familjet e varfëra. Nëse shikohet statistika, edhe popujt, që si ushqim kryesor e përdorin mishin, nga varfëria u paraqiten këto shkaqe. Pra, duhet dalluar një realitet tjetër logjik se mungesa e mjaftueshme e ushqimit vegjetarian nga varfëria nuk është e njëjtë me konstatimin se vegjetarianiteti është shkaktar themelor i sëmundjeve dhe i përqindjes së madhe të vdekshmërisë.

- Pse nuk preferohet me këtë traditë ushqimi shtazor, por insistohet kryekput në ushqim bimor?

- Ushqimi bimor është transformimi i parë energjetik natyror. Mbillet farra dhe nga ajo mbin bima që përdorohet si ushqim. Prandaj, transformimi i parë energjetik natyror është ushqim shumë më kualitativ.

Mishi i takon transformimit të dytë energjetik natyror, sepse shtazët ushqehen me bimë, e njeriu me mishin e shtazëve që ushqehen me bimë. Gjithnjë, bazuar në këtë parim, kurrë nuk preferohet që ushqimi me mish të jetë i shtazës mishngrënëse, por vetëm bimëngrënëse. Përpos disa atraksioneneve shfrenuese gastronomike, fare nuk preferohet të përdoret si ushqim i rregullt mishi i maces, i ujkut, i arushës etj. Sepse, në këto raste do të kemi një ushqim të transformimit të tretë energjetik. Edhe pse ushqimi ynë është mishi i shtazëve bimëngrënës, nuk e di sa e ke të njohur se shtaza kur përgatitet për therrje, e parandjen rrezikun që i afrohet, andaj nga frika, në organizmin e tij bëhet tajimi më i madh i hormonit të andrenalinës. Andrenalina edhe pas therjes mbetet në përbërje të mishit, të cilën më pastaj ne e përdorim si ushqim. E andrenalina dihet – shkakton shqetësim dhe agresivitet.

- Jo rastësisht shumë koka gjeniale të botës kanë qenë vegjetarian të përbetuar, bie fjala, si: Leonardo da Vinçi, Bernard Shou, Edisoni, etj.

- Ashtu është dhe lista e këtyre kokave gjeniale të njerëzimit si vegjetarian duhet të jetë e madhe. Është vërtetuar edhe shkencërisht se vegjetarianët, fizikisht, kanë sistem imunobiologjik shumë të fortë, pastaj lëkura e tyre është gjithmonë e re. Nuk djersiten fare dhe rrezatojnë njomësi dhe hajthshmëri. Nuk vuajnë nga sëmundjet kardio - vaskulare, e ç'është më kryesorja, mplakja si proces natyror është tejet i ngadalsuar. Në krahasim me popujt,

sistemi i të cilëve parasheh për ushqim mish të mjaftueshëm në tryezë, statistikat e fundit gjithnjë e më tepër vërtetojnë se në Indi dhe në vendet me traditë vegjetariane të të ushqyerit, kanceri si sëmundje po thuaj nuk ekziston fare. Nga aspekti psikik, vegjetarianët tradicionalë janë gjithnjë të qetë dhe tepër komunikativë me rrethin. Nuk kanë strese.

- Përveç vegjetarianitetit, si mënyrë tradicionale e të ushqyerit, disa religjione, e posaçërisht këtu paraprin Islamizmi, aplikojnë edhe agjërimin, abstenimin njëmujor në vit nga të ushqyerit e rregullt ditor. A ka edhe kjo mbështetjen e vet në ndonjë logjikë të efektit tësaj racional ose irracional në qenien tonë?

- Patjetër se po! Të nisemi nga shtazët. Ata si qenie instiktive, kur ballafaqohen me sëmundjen, spontanisht abstenojnë nga ushqimi deri te shërimi i tërësishëm. Po ashtu është interesante tek terapeutët laikë alternativë të Lindjes. Ata pacientëve të tyre për terapi shëruese u preferojnë agjërimin parcial. Tek ne, përkundrazi, të sëmurit me dhunë i japim ushqim për ta ripërtërirë organizmin e rraskapitur nga sëmundja. Abstenimi nga ushqimi, gjegjësisht agjërimi, është metoda më e vjetër e shërimit të sëmundjeve në historinë njerëzore. Qysh në kohët e lashta konsiderohej se asgjë nuk është më e shëndoshë për njeriun se sa abstenimi i pjesërishëm nga ushqimi.

- Muhamedi, si predikues dhe themelues i fesë islame, 30 ditë të Ramazanit i konsideron si të obligueshme për besimtarët myslimanë.

- Jo vetëm islamizmi, por abstenimin nga ushqimi shumë më parë e kanë njohur civilizimet më të hershme. Agjërimin, si ruitual të vetin themelor, e obligon edhe fakirizmi, budizmi dhe mjaft shkolla të ndryshme të edukimit shpirtëror si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim. Të gjitha religjionet, me disa intervenime, agjërimin e kanë trajtuar si ritual themelor fetar. Shumë shenjtër, para se të kanë arritur ngritjen e tyre spirituale, kanë agjëruar një kohë të gjatë. Dihet mirë se Jezusi, Mojsiu e të tjerët, për ta pastruar dhe riedukuar shpirtin kanë agjëruar edhe deri dyzet e më tepër ditë. Kështu ishte edhe me Muhamedin, i cili, kur e pranoi kontaktin e parë me nivele më të larta hyjnore, i vetmuar tërsisht në shpellën "HIRA", ka qenë nën regjimin e agjerimit. Prandaj, edhe zbritja e KUR'AN-it bëhet gjatë muajit të Ramazanit, i cili edhe përcaktohet si obligim për tërë besimtarët islamë.

- Pse konsiderohet si terapi preventive dhe shëruese për trupin dhe shpirtin e njeriut agjërimi?

- Një pyetje tejet e qëlluar. Ashtu sikurse që thamë më parë, kur trupi nuk ka ushqim, ai fillon të shpenzojë veten. Në këtë proces, në trup bëhet djegia e rezervave yndyrore dhe ato që shtresohen nëpër muret e enëve të gjakut. Këtë lloj yndyre në gjak mjekësia e quan holesterol. Me shpenzimin e holesterolit të tepërt, paralelisht bëhet edhe shkatërrimi dhe tretja e shumë

toksinave tjera të dëmshme që janë futur në organizëm përmes ushqimit, ajrit dhe tretjeve të panevojshme hormonale nga streset e përditshme të njeriut. Stresi është sëmundje më e rrezikshme e njeriut bashkëkohor. Shkaktohet me procesin natyror të tretjes së hormoneve në gjak për ta mobilizuar organizmin për aksion. Me pranimin e sinjalit të rrejshëm të stresit, bëhet tajimi i hormoneve adekuate të cilat, pasi nuk janë të nevojshëm realisht për momentin, mbeten të shtresuara në muret e enëve të gjakut dhe kështu shkaktojnë një varg çrregullimesh organike, ku më i përhapur për njeriun e sotëm modern është inarkti i zemrës. Agjërimi, përveçse bën djegien e mbeturinave të hormoneve të tepërta dhe të shtresuara në enët e gjakut dhe toksinave të ndryshme në organizëm, ai edhe ngadalëson mplakjen fizike të trupit.

- Këte kurrë nuk e kamë ndëgjuar. Të kisha lutur Mixha Dilë të më sqarosh më për së afërmi këtë ndikmi të agjërimit në mosmplakjen e trupit. A ka kjo ndonjë shpjegim shkencor?

- Tek para disa vjetëve, në një shkrim revial të kurioziteteve nga zbulimet botërore, kam lexuar një artikull që shkonte në favor të kësaj që thashë. Në mes tjerash, këtu bëhej fjalë për zbulimin e shkencëtarit Rus, Vlladimir Nikitin, i cili, pas shumë hulumtimeve empirike, vërteton këtë parim, që për ne ka qenë i njohur kaherë nga të urtit e lashtë. Ky shkencëtar ka konstatuar se në procesin e mplakjes rol të rëndësishëm luajnë gjëndrat endokrine. Me kohë gjëndrat ndryshojnë rrënjësisht dhe fillojnë të tajojnë

gjithnjë e më pak hormonin e insulinës, i cili i ndihmon organizmit në përpunimin dhe tretjen e materieve ushqyese. Në anën tjetër, gjëndrat mbiveshkore prodhojnë homone që janë antagoniste me atë të pankreasit dhe me moshë kjo gjëndër fare nuk e dobëson funksionin e vet taitës. Kështu, me vjetërsimin tone, bëhet disharmonia e taitjes së këtyre dy hormoneve antagoniste të insulinës, e cila zvogëlohet me taitje dhe gjëndrave të pankreasit që mbeten të pandryshueshme. Kështu, me zvogëlimin e taitjes së insulinës, kemi dukurinë e mostretjes së shumë materieve të dëmshme që akumulohen në qeliza dhe shkaktojnë mplakjen e organizmit dhe të trupit në tërësi. Me agjërim ky çrregullim vjen gjer tek balansimi i baraspeshave ndërhormonale antagoniste.

- Unë mendoj se agjërimi, përveç të gjitha rëndësive që i ceke, luan një rol shumë të madh edhe në ushtrimin e vullnetit tonë të kontrollimit të instikteve natyrore, konkretisht në instiktin e urisë, që është tejet i forte.

- Ashtu. Ai, nga ana shpirtërore, ushtron edhe vullnetin në kontrollin e instikteve tona natyrore. Pra, na ushtron që ky instikt i urisë, që është tejet i fortë dhe i natyrshëm të jetë përherë në mbykqyrjen e UN-it tonë e jo të EGO-s, e cila nuk zgjedh mjete për ta imponuar atë përmes shfaqjes së nevojës së tepruar të dëshirës së flaktë për ushqim. Me këtë instikt të sforcuar edhe nga ndërmjetësimi i inponimit të EGO-s shkaktohet disharmoni të dy të kundërtave, duke krijuar frustracione si ndjenja emocionale të padëshirueshme. Shpesh ndodh që nëse

kënaqet ky instikt i sforcuar edhe me ndërmjetësimin e EGO-s, atëherë ai inponon oreksin edhe në momente kur trupi ynë nuk ka nevojë për gjëra ushqimore. Në këto raste, ai i shëndron ato në yndyra dhe i akumolon në të gjitha pjesët e trupit si rezerva të caktuara në formë të dhjamit.

- Prandaj kemi trashjen e tepruar dhe deformimin e trupit, - ndërhyra, por Mixha Dilë nuk më la të vazhdoj më tej me përfundimin e pyetjes sime.

- Kemi trashjen, por së pari, për t'iu larguar stresit dhe frustracionit të caktuar psikik, EGO-ja orienton vëmendjen kah kënaqësia përmes ushqimit, andaj në rezervat tona dhjamore, që krijohen në trup, nuk ruhet vetëm fizikisht dhjami si yndyrë, por edhe vetë stresi në kujtesën e qelizave të caktuara. Prandaj, nëse do t'i nënshtrohemi ndonjë diete të caktuar për humbjen e kilogramëve të tepërt, ne, patjetër, do të ballafaqohemi edhe me frustracione të caktuara psikike përmes emocioneve të akumuluara edhe në kujtesën shpirtërore të vetë qelizës yndyrore. Gjatë hymbjes së kilogramëve të tepërt, që realisht janë rezerva yndyrore, ne largojmë edhe klishet e streseve të caktuara që janë të regjistruara në kujtesën programore të vetë informatës së qelizës, indit, etj.

- Prandaj kemi dështimin e shumë tendencave të humbjes së kilogramëve përmes dietës?

- Shumica, nuk janë të përgatitur që t'u nënshtrohen dietës përmes urisë, duke mos njohur veprimin e saj, ose edhe nëse e di, atë e bën njëanshëm, si një eliminim fizik të kilogramëve tepricë, pa anën tjetër të veprimit të saj

shpirtëror. Për ta zbatuar dietën me sukses dhe pa tundje të caktuar emocionale, ne rend të parë duhet të parapërgatitemi psikikisht dhe tek pastaj të zbatojmë regjimin e caktuar të dietës.

- Si duhet të parapërgatitemi psikikisht dhe a ka ndonjë regjim adekuat për një dietë të suksesshme në mënjanimin e kilogramëve të tepërt?

- Parapërgatitja psikike është vetë dëshira e flaktë që të largohen nga trupi kilogramët e tepërt. Kjo nënkupton largimin e paragjykimeve të tepruara për pamundësinë e organizmit që të qëndrojë gjatë pa ushqim. Të thashë në fillim se organizmi ynë kur nuk arrin tek substancat e nevojshme përmes ushqimit, fillon të shpenzojë rezervat e akumuluara që më parë. Këto rezerva janë shtresa yndyrore të shtresuara nëpëj muskuj, për shkak të konsumimit të sasirave të tepërta të ushqimit. Trupi, nëse nuk ka pasur hë për hë nevojë për to, i ka akumuluar si rezerva. Kur ju kryeni një aktivitet të caktuar fizik dhe për momentin nuk ka matere energjetike të futura përmes ushqimit në organizëm, do të fillojë t'i tretë mu këto rezerva. Pra, fillon shpenzimi i yndyrës në trup si nevojë energjetike fizike.

- A ka edhe nevojë energjetike shpirtrore?

- Po pra, ka edhe nevojë energjetike shpirtërore dhe kjo është energjia vitale. Ti në organizëm përmes ushqimit merr një sasi të kësaj energjie, por pjesën më të madhe të saj e akumulon përmes frymëmarrjes nga ajri. Kjo energji vitale, jetike, ose, e quajtur në filozofinë kineze, "CHI", dhe PRANA në ate indiane, të nevojitet për pjesën e

funksionimit shpirtëror, kurse enirgjia tjetër fizike, që ne do ta quajmë si bioenergji trupore, është energjia që nevoijtet për funksionimin bio-fiziologjik të organizmit tënd. Puna fizike e muskujve, e organeve dhe e pjesëve tjera të trupit shpenzon bio-energjinë fiziologjike, kurse mendja dhe proceset e të menduarit si tërsi, shpenzon energjinë vitale. Me frymarrje furrnizohemi me ajër, ku ka oksigjen , nga njera anë, element ky që, në mes tjerash, konsiderohet si katalizator - ndërmjetësues themelor i shumë proceseve fiziologjike dhe biologjike të organizmit. Nga ana tjetër, me frymëmarrje, nga eteri, gjegjësisht universi i paskajshëm, në sasira shumë më të mëdha merr edhe energjinë vitale për nevojat e funksioneve tuaja shpirtërore. Si bio-energjia fiziologjike, ashtu edhe energjia vitale të nevojiten vetëm kur je në gjendje të treshes së pandashme:trup-mendje-shpirt. Vetëm si shpirt nuk ke nevoj për këtë energji, sepse të mungon trupi, dhe si mendje-qendër e zbatimit të inteligjencës së paskajshme, vetëm sërish si TRIPTIH, kurse trupi dhe vetë procesi bio-fiziologjik funksionon vetëm sa je gjallë, gjegjësisht sërish si TRIPTIH.

- TRIPTIH?

- Triptih ose triadë e tërësisë unike trup-mendje-shpirt. Në këtë gjendje, të gjitha nivelet mentale, fizike dhe shpirtërore kalojnë përmes lidhjes së fortë të kësaj treshe, andaj edhe nëse ato duhet eliminuar, atëherë sërish duhet vepruar me këtë proces integral. Kilogramët e tepërt shkatohen me veprimin e instiktit të ruajtjes së qenies fizike. Si instikt i lindur është në rend të parë instikti

shpirtëror, pastaj kemi kënaqësinë e përjetuar dhe të mbajturit mend të këtij përjetimi, duke e kërkuar përsëritjen e saj të shpeshtuar edhe kur nuk kemi nevojë për të dhe, së fundi, fizik, sepse organizmi ynë, edhe pse ka sasira të mjaftueshme energjetike, ato nuk i tretë, por i konservon si rezerva për t'i përdorur në momentin e duhur të mungesës eventuale të tyre. Nëse kërkohet mënjanimi i kilogramëve të tepruar, atëherë kemi procedurën e lehtë, por siç e thashë, ajo duhet të kalojë edhe aspektet e saja psikike dhe fizike.

- Më thuaj edhe diçka për energjinë vitale . Unë kam ditur për energjinë në tërësi, por nuk kam pasur njohuri se vetë bioenergjia jonë është krejtësisht tjetër nga energjia vitale?

- E thjeshtë, miku im, një anë e jotja e të kundërtave shfrytzon një energji, kurse ana tjetër, energjin tjetër. Trupi fizik - bio-energjinë, kurse shpirti - energjinë vitale. Ti si krijesë ke nevojë për të dyja këto energji. Një për shpirtin dhe tjetrën për trupin, kurse procesi i shpenzimit të këtyre energjive është mendja. E menda, thamë, ka sërish dy të kundërtat e veta, atë racionalen - të vetëdijshmen dhe irracionalen - të pavetëdijshmen. Funksuionimi i mendjes racionale përmes trurit dhe sistemit të tërsishëm nervor shpenzon bio-energjinë, kurse mendja irracionale, e cila është ndërvetëdija e jonë, shpenzon energji vitale… Pushimi që bëri këtu ishte për mua si shenjë se duhet përfunduar takimin tonë për sot.

KAPITULLI

LARGIMI I BEFASISHËM I MIXHËS DILË

Edhe pse ishte fundi i nëntorit koha bënte ende ngrohtë. Nëna disa herë më kishte ngarkuar me obligimin që të siguroja drutë për dimër. Sipas bindjes së saj kjo ishte punë e meshkujve. Sa herë që ma përkujtonte këtë obligim, dinte të thoshte:

- Nuk i besohet dimrit, biri im. Nikoqiri i mirë gjërat i siguron me kohë.

Në anën tjetër, ajo kaherë kishte filluar ekspeditën e vet me pergatitjen e zahireve. Edhe pse e shtyer në moshë, këtë punë e bënte gjithnjë vetë. Zgjedhja e pemëve për reçele të llojeve të ndryshme dhe perimeve për turshi, ishte pasioni i saj. Kurrë nuk më linte mua që ta bëja këtë punë. Shkonte çdo ditë në pazar dhe e bënte zgjidhjen sipas kriterit të vet.

- Ehhh, i dashuri im, edhe këtu duhet merak, "ustallëk" i veçantë! - thoshte e bindur ajo. - Jeni mësuar ju me këto reçelna dhe turshi të fabrikave që bahen shkel e shko. Ato duken si turshi ose reçel, por nuk kanë shpirt, sepse janë bërë pa merak - thoshte kështu nëna dhe kishte plotësisht të drejtë. Pa dyshim, prodhimet industriale bëheshin me teknologji të përsosur dhe standarde më bashkëkohore, por ishin të përpunuara në mënyrë serike. Ato vërtet nuk kishin shpirt, dhe këtë realitet shumë mirë e dinte edhe nëna nga eksperienca e vet shumëvjeçare e kultivimit tradicional të dimërishteve.

Kështu mësonte edhe mixha Dilë? Çdo punë e kryer, bile edhe mendim i thënë pa emocionin e dashuri, nuk e ka efektin e duhur dhe nuk është depërtues. Kështu ishte edhe me dimërishtet e nënës sime që ishin të përmendura dhe të lëvdëruara në mesin e farefisit të gjerë dhe të gjithë atyre që kanë patur rastin t'i kërkonin ndonjëherë.

Dita e sotit qe tejet e ngarkuar, dhe unë menzi pritja që të jem në shtëpi. Nesër është e shtune dhe menjëherë pas takimit me mixhën Dilë, kohën tjetër do t'ia kushtoja sigurimit të druve për dimër. Me këtë ide sigurisht do të gëzohej edhe nëna që me padurim e priste këtë vendim. Nuk ka faj e shkreta, sepse disiplina e saj jetësore dhe planifikimi i të gjitha gjërave me kohë, i kishin mundësuar që në mënyrë stoike t'i përballojë me sukses të gjitha sfidat e vrazhda dhe të papritura të jetës, nëpër të cilat kishte kaluar ajo.

Me padurim prisja të isha në shtëpi dhe të shtrihesha në shtrat. Ta relaksoja trupin dhe të filloja të meditoja në qetësi. Këtë metodë të qetësimit shpirtëror ma kishte mësuar mixha Dilë. Zakonisht e praktikoja të meditoja çdo ditë nga tri herë. Në mëgjes dhe në mbrëmje - patjetër, kurse, pasdide më së shpeshti kur kthehashe nga puna ose pas ndonjë mgarkese psikike intelektuale. Meditimet e mia zgjatnin më së tepërmi deri 30 minuta. Në pozitë të ulur këmbëkryq, ose i shtrirë në shtrat, merrja frymë thellë 3 herë me tërë kapacitetin e mushkërive dhe lëshoja frymën, pastaj, gjersa relaksohej tërë trupi duke u koncentruar veç e veç në të gjitha gjymtyrët dhe pjesët tjera, i liroja ato nga shtangimet. Këtë gjendje të trupit të relaksuar e krahasoja me trupin e macës në gjumë, kur ngrihet lart, zakonisht dimrit, afër "shporetit" të ndezur që lëshon nxehtësi. Pas relaksimit të tërësishëm, kaloja në fazën e meditimit. Pra, të arritjes së heshtjes së plotë e cila bazohej në qetësin totale të bredhjes së pandërprerë të mendimeve: Në gjendjen pskike pa kurrfarë mendimesh. Kjo gjendje e zbrazëtisë mentale, ditëve të para të meditimit, zgjaste shumë shkurt. Vetëm disa sekonda, por, më vonë, këtë gjendje arrija ta bëja më të gjatë. Pas heshtjes dhe qetësisë së plotë, tentoja që pa kurrëfarë vlerësimi ta fus filmin psikik të dëshirës, gjegjësisht të synimit të caktuar.

Nuk kishte dyshim. Kjo metodë funksiononte në mënyrë të perfeksionuar në drejtim të realizimit të të gjitha dëshirave dhe synimeve të mia jetësore. Veprimin e

funksionimit të ligjshmërive shpirtërore të mësuara nga mixha Dilë, tani i kisha mishëruar gati në tërësi si mënyrë e të menduarit, prandaj çdo dëshirë apo synim që tentoja ta realizoja, e bëja duke i ikur vlerësimit dhe me siguri të plotë se ajo do të realizohej. Edhe kur nuk meditoja, në kohën e lirë, i ushtroja mendimet e mia që të mos bredhin në të kaluarën dhe në të ardhmen, por gjithnjë të jenë në të tashmen. Vetëm në të tashmen si gjendje apsolute reale ku shpirti është përherë në kontakt me hyjnoren. Një urtësi të lashtë që ma kishte mësuar mixha Dilë, unë këtë si pllakatë e kisha shkruar dhe ngjitur në dhomën time dhe në zyrë përballë tavolinës së punës:

"E kaluara është histori, e ardhmja është fshehtësi, e tanishmja është realiteti që na prezentohet"

Duke menduar dhe përjetuar me tërë qenien time vetëm të tashmen, unë krijoja të ardhmen time e cila tek duhej të vinte. Ka edhe rreziqe në këtë metodë. Për këtë disa herë ma kishte tërhequr vërejtjen edhe mixha Dilë.

- Nëse duke menduar në të tashmen, dhe vetëm të tashmen, e ngarkojmë atë me ndonjë ndjenje apo mendim negativ, mu ajo do të jetë edhe e kaluara jonë. Këtu, pra, janë gabimet më të mëdha të **"FATIT TË ZI"** që ne e arsyetojmë me atë mosveprimin tonë në drejtim të ndryshimit të mundshëm të kësaj gjendjeje; - thoshte ai .

Tanimë isha mësuar edhe ta ndjeja intuitën. Pra, zërin e brendshëm, sikur e quante mixha Dilë. Ai më ishte bërë udhërrëfyesi më i sigurt dhe më sinqertë i jetës. Zëri i intuitës shpesh dinte të më shtyente të bëja ndonjë veprim

që ndoshta dukej për fillim si absurd, por gjithnjë fundi i tij ishte rezultati i favorshëm për mua. Nuk brengosesha fare për asnjë problem jetësor. Mjafton të koncentrohem dhe në qetsi të plotë mentale t'i thoja vetes: ***"vepro ashtu sikurse do të jet më së miri"***. Përgjigjja intuitive që pasonte më vonë ishte e pagabueshme.

Zakonisht ditëve të tjera, në këtë kohë me padurim e prisja drekën, por sot kjo nuk më shkonte as ndërmend. As vetë se di pse, por unë sot nuk ndjeja uri fare. Ishte ora 16,30 e pasditës së premte. E premtja gjithnë më sjillte kënaqësi mu pikërisht se ishte dita e fundit e punës gjatë javës. Si ditë e fundjavës që i paraprinte vikendit, më mundësonte që dy ditët e ardhshme të pushimit t'i planifikoja dhe t'i dedikoja për shumë aktivitete të tjera që unë zakonisht i quaja "autodidaktike" .

Nesër është termini tek mixha Dil. Kjo ishte preokupimi i parë i aktiviteteve vikendore që unë me padurim e prisja. Rrugës, në kthim, desha të ndalesha në ëmbëltoren time të preferuar për një kafe expreso që sigurisht do të më relaksonte , por intuita më thoshte të nisesha sa më parë në shtëpi. Intuita? Po, po, intuita! Ky instrument imi shpirtëror që mixha Dilë më kishite mësuar ta doja dhe gjithjë t'i përjetoja impulset e saja paralajmëruese. Ajo nuk gabonte kurrë! Duke ecur rrugës, ngadalësova hapin dhe u koncentrova më thellë në këtë ndjenjë që mu paraqit menjëherë si sinjal. Ishte një ndjenjë e zbrastësisë, e përzier me dhembje dhe dëshprim. Sikur më paralajmëronte diçka.? "Jo!... jo!... nuk është keq. Nuk

duhet të jetë diçka e keqe!" - i sygjeroja vetes. Menjëherë shpejtova hapin në drejtim të shtëpisë. Hapa derën furishëm dhe në korridor takova nënën. Menjëherë, që në shikim të parë, nga sytë e saj lexova se dëshironte të më thoshte diçka.

- Ke diçka të më thuash, nënë? - pyeta i frikësuar.
- Jo, bir, asgjë! Posa doli nga këtu mixha Dilë dhe...
- Ka ndodhur diçka me të... më thuaj shpejt, nënë. Mos fsheh asgjë nga unë.
- Asgë, asgjë, vetëm ishte këtu fqinji ynë dhe të përshëndeti duke më lënë një zarf me një letërë. Ngutej diku dhe iku shpejt e shpejt.

Morra plikon e mbyllyr, në sipërfaqen e së cilës nuk ishte shkruar asnjë emër dedikuese dhe asnjë adresë. E hapa shpejt e shpejt dhe vërejta se në të ishte një letër me disa faqe të shkruara lexueshëm me dorë:

I nderuari, miku im i dashur:

E dij se ti me padurim e pret takimin tonë të ardhshëm në terminin e caktuar. Por, jam i obliguar të të njoftoj se unë për një kohë nuk do të jem këtu. Duke tentuar ta gjesh shkakun e ndarjes, mos u mundo të preokupohesh me analiza pse ndodhi kështu.

Kjo duhej të ndodhte.

Patjetër duhej të ndodhte...

Duhet gjithnjë ta kesh në bindje se ne ende jemi së bashku dhe mësimet tona të filluar i vazhdojmë më tej .

Tanimë e di se ekzistojnë tre faktorë të realitetit tone: shpirti, mendja dhe trupi, ose edhe ndryshe, vështruesi, procesi i vështrimit dhe i vështruari. Në esencë, këta faktor janë një, veprojnë përherë së bashku dhe pandërprerë. Burimi i gjithë asaj që krijohet është hujnia. Vetë procesi i krijimit është hyjni në lëvizje, kurse objekti i krijimit është e tërë bota fizike, pra Universi, i cili e përfshin edhe trupin tonë fizik.

E gjithë ajo që është krijuar, e gjithë ajo që ekziston në botën fizike, është rezultati i asaj që nuk është shfaqur, i asaj që nuk është vërejtur, e cila shndërohet në ate që shfaqet, që vërehet. Gjithë ajo që shofim e ka burimin e vet në të panjohurën. Qenia jonë fizike, gjithësia fizike, çfardoqoftë, së bashku me gjithë atë që te ne arrin përmes shqisave tona, është shndërrim i asaj që ishte e pashfaqur, e panjohur dhe e padukshme - në të shfaqur, të njohur dhe në të dukshme

Çdo gjë është në veprim dhe në vazhdimësi të përhrshme miku im. Nëse krahasohemi me funkcionimin e pandërprerë të Ligjt të të kundërtavei, në përputhje me të duhet të rrjedhin të gjitha takimet dhe mësimet tona të përbashkëta. E kemi shtjelluar mirë dhe përsosur teorinë, kurse tani radhën e ka praktika.

Mos harro: "Një gram praktikë vlen sa një tonelatë libra ".

Në mënyrë që t'i forcosh dhe t'i mishërosh edhe më tepër mësimet e gjertanishme si mënyrë e re e të menduarit në përditshmërinë tënde, të duhet praktika miku im i

dashur. Me Ligjin e të kundërtave, pas njohjes së mirë të teorisë, zbatimi i praktikës si pol tjetër i kundërt në fërkim, do të shkaktonte krijimin e produktit të ri.

Çka do të jetë këtë produkti i ri?

Produkti i ri është rezultat i pashmangshëm i arritjes së qëllimeve dhe synimeve tuaja jetësore dhe ajo lind si vazhdimësi, si proces që nuk ndalet, duke qenë në veprim të përhershëm në tërësinë e quajtur Univers. Kjo nuk varet ma nga ti, por nga veprimi i informatës si inteligjencë e paskajshme në rrugën e transformimit të pandërprerë.

Gjithmonë në mendime përjetoje të tanishmen e kurrsesi të ardhmen, sepse e ardhmja krijohet në të tashmen. Vetëm e tanishmja duhet të pranohet, përqafohet, ashtu sikurse është. E ardhmja është diçka që mund ta kriosh përmes qëllimeve të papenguara, por kurrë nuk guxon ta luftosh të tanishmen.

Edhe e kaluara edhe e ardhmja i takojnë vetëdijes. E kaluara është ajo që mbahet në mend; e ardhmja është parashikim; e tanishmja është vetëdija. ***Sikurse e sheh, koha është vetëm lëvizje e mendimeve dhe asgjë tjetër****. Edhe e kaluara edhe e ardhmja krijohen nga fantazia, vetëm e tanishmja, e cila në realitet është vetëdija, është reale dhe e përjetshme, e amshueshme. Ajo është fushë e paskajshme e mendimeve që shprehen si forca abstrakte, si dritë, nxetësi, elektricitet, magnetizëm etj. Këto forca nuk janë as në të kaluarën dhe as në të ardhmen. Ato, thesht, janë.*

Mendimi, i cili themelet e veta i ka në lirinë e papenguar të së tashmes, shërben si katalizator për përzierjen e caktuar të materjes, energjisë dhe ngjarjeve në kohë dhe hapsirë, për t'u sendërtuar cilado dëshirë.

Medito rregullisht dhe së paku tri herë në ditë. Mos e ndërprej kurrë këtë praktikë. Meditimi dhe arritja e qetësisë absolute pa vlerësime, të ndihmon që të lidhesh me Unin tënd të vërtetë, potencialin e pastrër që është hyjnor dhe burim i inteligjencës së paskajshme. Aty është urtësia, aty është çdo e vërtetë që ti e kërkon dhe do ta kërkosh në të ardhmen. ***Aty është Zoti në ty dhe askun tjetër.*** *Ai është aty sepse edhe ti je pjasa vet. Duke medituar dhe duke arritur qetësinë absolute pa vlerësime, shpirti kontakton me nivele të larta hynore dhe këtë duhet ta shfrytëzosh si gjendje ku arrihen të gjitha synimet dhe dëshirat tuaja reale. Mjafton vetëm në heshtje të plot , ta fusësh dëshirën dhe synimin tënd si parafytyrim, duke mos bërë më tej kurrfarë velësime në lidhje me të.*

Lidhja jote e ngushtë gjatë aktiviteteve të vetëdijshme me potencialin e pastër është ***intuita****. Ndëgjoje mirë këtë zë që të vjen nga brendësia e qenies sate dhe vepro sipas tij. Mos vlerëso sa është ai vprim i drejtë, por vetëm vepro në këtë drejtim. Intuita është engjëlli yt mbrojtës në jetë dhe ajo të shërben me besnikëri. Duhet patjetër, ta ushtrosh edhe dallimin e zërave të tjerë që vijnë si signale të EGO-s dhe asaj intuitive. Subjektivizmi dhe dëshira e madhe që të realizohet diçka, shpeshherë e gabon këtë zë duke mbisunduar gjendja momentale.*

Nuk ka dëshirë dhe synim që nuk realizohet. Harmonia e përsosur e Univerzit është pikërisht ky qëllim. Vetëm duhet të di se si ta bësh këtë. E ti, tanimë, i dinë mirë rregullat. Përmbaju atyre me përpikëri dhe vjeli rezultatet e arritura.

Pengesa s'ka!

Pengesat i krijojmë ne vetë përmes mendimeve tona të gabuara.

Kur ta zbulosh natyrën tënde qenësore dhe ta kuptosh se kush je në realitet, do të zbulosh se në vetë atë botëkuptim fshihet aftësia për të sendërtuar cilindo ëndërr, sepse ti je mundësi e amshueshme, potencial i pamatshëm i gjithë asaj që ishte, që është dhe që do të jetë. Fusha e potencialit të pastër dhe inteligjencës së paskajshme është UN-i yt. Të përjetuarit e UN-it dhe kthyerja kah vetvetja do të thot të referohesh shpirtit tënd e jo gjësendeve të përjetimit.

Të jetosh nuk do të thot të kesh para, pasuri… por të jesh i lumtur. E lumturia është vetëm një ndjenjë që mund të arihet edhe pa pasuri materiale.

Pasuria të nevoitet vetëm ta kënaqësh nevojën shpirtërore e cila është synim dhe dëshir e caktuar që krijohet sërisht në mendje. Është pra vetëm mendim.

E tërë mësimi i aftësimit tëndë gjat takimeve tona të gjertanishme, ka qenë se si të jesh i vetëdishëm t'i krijosh dhe ti kontrollosh mendimet dhe ndjenjat e tuaja

Mos mendo pra në materializëm dhe në para, edhe pse ato janë realiteti i ekzistencës tonë jetësore. Suksesi

është udhëtim e jo cak. Begatia materiale, në të gjitha format është vetëm një ndërmjetsues që këtë udhtim mund ta bëjë të këndshëm. Por suksesi nuk është vetë ky. Ajo, nënkupton gjithashtu, edhe shëndet të mire, energjinë dhe vullnetin për jetë, raportet e mira me të tjerët, lirinë krijuese, stabilitetin emotive dhe psikologjik, dhe së fundi ndjenjën e kënaqësisë dhe qetësisë si produkt i fundit egsistencial që është edhe qëllim imediat i qenies sonë në kët realitet. Edhe nëse me qfardo forme tjetër arrihen për momentin të gjitha këto kënaqësi, atëherërë sërisht do të mbetesh i pakënaqur deri në fund, nëse nuk e kultivon në vete farën hyjnore.

Andaj, suksesi është shprehje e hyjnores ngado që nisemi, në çkado që shikojmë: " në sytë e fëmijës, në bukurinë e lules, në fluturimin e shpendit" sukur është shprehur një poet. Kur të fillosh ta përjetosh jetën në këtë shprehje të çudidshme të asj hyjnore, ti tek atëherë dhe jo vetëm kohë pas kohe, por vazhdimisht, do ta kupton domethënien e plotë të fjalës sukses. Kur do të vëren se gjithmon, dhe në çdo kohë mund t'i kesh të gjitha, ato as që do të jenë më preokupimi yt kryesor, por vetëm një nevoj kalimtare në rrugën tënde kah e përsosura hyjënore. Këte të gjitha nuk ta them unë, por e kanë thënë dhe përjetuar shumë të tjerë që kaher janë nisur kësaj rruge. Kjo është eksperienca e tyre e imja dhe tani e tutje edhe e jotja dhe shumë të tjerëve që duhet ta përcjellësh si mësim.

Mos ke frikë!

Frika është produkt i mendjes sate dhe armike më e madhe e njeriut. Është instik i lindur që e mobilizon trupin për akcion nga ndonjë atak real fizikë.

E shikon...? Është plotësisht e natyrshme, vetëm gjersa ajo nuk shëndrohet në shprehi dhe vepron edhe jashta qëllimit të vet natyror. Është emocion i fortë, shërbëtore besnike e EGOS, e cila pandërprer e ushqen ate. Nëse ti vepron drejt dhe në përputhje me ligjshmërit e mësuara, frika mënjanohet. Ajo është sikur xhaketa e trashë e dimrit: e ke diku në orenditë shtëpiake por nuk e përdor, sepse koha është e nxehtë. Pa frikë, për ty gjithnjë koha duhet të jetë e ngrohtë parandaj xhaketa e dimrit, edhe pse ekziston, nuk do të ket nevojë të përdoret.

Edhe pse do të jem larg me trup ne veq kemi vënë kontaktin tonë shpirtror. Unë jamë dhe do të jem përherë me ty. Dije! Nuk ka këtu kurfar mrekullie! Unë lexoj dhe i regjistroj dëshirat e tua të sinqerta.

Mjafton vetëm të mendosh sinqerisht në mua. Veq i përjetoj sukseset e tua në jetë dhe ato do të jenë edhe më të mëdha. Thash suksese, sepse ti ke pasur vetëm mosuksese në jetë. Dikur duhet ta largosh nga mendje termin "DU TË KEM SUKSES".Ajo ma nuk do të ekzistoj, sepse për ty çdo gjë do të jetë sukses..

E ke të qartë... po, po patjetër e ke të qartë!

Këtë letër do ta përmbydhja pa të thënë lamtumir por vetëm mirë u pafshim.

Mos harro:

" Ti je realiteti i kësaj bote. Ti je shkëndia e zjarrit të madh të Perendisë që ndizet pandërprer dhe quhet jetë…"

Të donë dhe gjithmonë do të jete me ty:
Mixha Dil

Personazhin e romanit tone, një të ri tridhjetëvjaçar, realiteti i pasluftës kosovare e gjen si një person të degradura dhe të degjenereuar shpirtërisht. I pakënaqur nga jeta dhe sfidat e saja, ai kurajën e gjen gjithnjë në alkool që tanimë i kishte kaluar në shprehi të përditshme dhe varshmëri kronike. Duke mos qenë më i aftë të qëndojë sfidave jetësore përplot batica dhe zbatica, në një depreion të rëndë psikik, që kishte arritur në pritje, prite të momentit më katastrofal të vetëflijimit-v e t ë v r a s j e n …Duke u kthyer çdo ditë i dehur, një ditë e gjen veten në shtratin e një dhome të panjohur, me dhembje të mëdha në gjymtyrë. Nuk di se ku është dhe çka i kishte ndodhur mbrëmë sa ishte i dehur. Duke u marrë me këto mendime, në dhomë hyn papritmas fqinji i

tyre i ri mixha Dilë, për të cilin në atë lagje thureshin thashethëme të ndryshme. Në realitet, mixha Dilë ishte një njeri i mençur dhe tejet i urtë…Ai pranon që mikun e tij ta shpije në lavirintet e njohjes së ligjshmërive shpirtërore, duke ia ndryshuar më vonë jetën në tërsi.
Përcjellja me vëmendje e lekcioneve të shkollës jetësore dedikuar personazhit tonë, do t'ju ndihmojë edhe juve që të arrini urtësinë mbi filozofinë e jetës dhe t'i ndihmoni vetes që më ndryshe ta shikoni realitetin tonë objektiv…Vlersoni vetë !
Shkolla e jetës së mixhës Dilë filloi…